

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 411 • SHKURT 2025



BESIMTARI I DENJË ËSHTË
ATDHEDASHËS

IDENTITETI, SFIDAT DHE VEPRIMI
I GRAVE MYSLIMANE NË EVROPË

SHTETI I SË DREJTËS NË DRITËN E
INTENCAVE TË LEGJISLACIONIT ISLAM

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi
në një pjesë të natës nga Mesxhidi Harami (Qabeja) gjer
në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës
Ne e kemi bekuar, (udhëtim ky) për t’ia treguar atij disa
nga argumentet Tona. Ai vërtet është Dëgjuesi, Parësi!”

(El Isra, 1)



EDITORIAL

- 4 Morali, si garantues qëndrueshmërie për shtetin tonë

FETARE

- 5 Dashuria ndaj atdheut – vepra më madhore
Resul ef. Rexhepi
- 7 Rëndësia e ruajtjes së racës njerëzore në kontekstin e ajeteve 5-7 të kaptinës El Muminun
Dr. Valmire Batatina-Krasniqi
- 10 Çfarë është Israja dhe Miraxhi?
Mr. Vedat Shabani
- 13 Përcjellësi i cili kujdeset që të mos gabosh
Blerim Musliu
- 15 Sigurimi i të varfërve dhe të pafuqishmëve është një nga shtyllat e fesë islame
Abdulvehab el Karash
- 17 Pse hanefitë nuk i ngrenë duart kur përkulen në ruku dhe kur ngrihen nga ajo?
Shejh Abdurrahman ibën Yusuf Mangera
- 20 Qëllimet, përbërësit dhe sfidat e ligjërimit të xhumasë
Mahmud Ukkam
- 22 Besimtari i denjë është atdhedashës
Mulaim Shehu
- 25 Perspektivat kuranore të dialogut ndërfaqetor
Anisa Hoti

FAMILJE & EDUKIM

- 28 Identiteti, sfidat dhe veprimi i grave myslimane në Evropë
Dr. Arlinda Amiti
- 32 Pasojat shëndetësore të imoralitetit
Dr. med. Lis Kusari
- 36 Korrupsioni dhe pikëpamjet e ndryshme për të
Mr. Esad Ejupi

KULTURË

- 39 Kompozitat në Kuran
Dr. Shkelqim Millaku
- 42 Shteti i së drejtës në dritën e intencave të legjislacionit islam
Dr. Bashkim Aliu
- 46 “Bardhësitë e atdheut” – kryepërmendore e përmendoreve të atdheut tonë
Akademik Mehmet Halimi
- 49 Qëndrimi i diplomacisë turke ndaj pavarësisë së Kosovës
Dr. Nuridin Ahmeti

HISTORI & CIVILIZIM

- 53 Dokumentimi i luftës në Kosovë – sfidat dhe ndërgjegjja kolektive
Blerim Halili, PhD (c)
- 57 Projekti “Bota Serbe” (“Srpski svet”) është një projekt destabilizues për Ballkanin
Adnan Qaka
- 60 Gjendja e shqiptarëve (muhaxhirëve) të shpërngulur me dhunë nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878
Msc. Drin Aliu

PERSONALITETE

- 64 Ramadan Gara
Mr. Eset Bajraktari

AKTIVITETE

- 65 Myftiu Tërnava u prit në takim nga ministri i Haxhit dhe Umres së Arabisë Saudite, dr. Tevfik Rabiah



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 411 • viti 38 • Shkurt 2025
• Shaban 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnava,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

“Dituria Islame”,
rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
“Printing Press”, Prishtinë.



“...Mos iu
frikësoni njerëzve,
por më frikësohuni
Mua...”

(Ali Imran 175)

Morali, si garantues qëndrueshmërie për shtetin tonë

Formimi i shtetit dhe mëvetësimi si projekt shekullor, mbeten aspiratat sublime që i përjetuam ne bijtë e këtij qindvjeçari, duke realizuar kështu mëkëmbësinë dhe lirinë e plotë në truallin tonë të trashëguar. Shteti, si strukturim i lartë dhe tregues i vetëdijes së ngritur shoqërore, as te ne, e as gjetiu, nuk është themeluar ndryshe vetëm se mbi supet e njerëzve zemërdëlirë, heronjve shpirtmëdhenjë, fisnikëve vetëflijes, intelektualëve mendjeurtë, dhe natyrisht të tjerëve që ndiqnin me plot zell gjurmët e tyre pa u hamendësuar. E pra, heroizmi, shpirtdëlirësia, fisnikëria, mendjeurtësia e vetëflijimi, janë një bontonë vlerash e virtytesh që s'bën t'i quash ndryshe veçse atribut të larta morale të cilat, në fakt mbesin të paqkapshme nga personaliteti i atyre heronjve shtetndërtues. Kushdo që tenton ta ndërtojë një shtet pa këto virtyte, ta konsolidojë e ta mbajë në këmbë pa këso vlerash, në versionin më të butë, klasifikon vetveten si një person naiv, e mbase tejmasë mediokër.

Kur ne përfytyrojmë portretin e heronjve e 'etërve' të mëvetësisë së shtetit të parë shqiptar, por edhe të atyre të shtetit tonë të dytë, këtu në Kosovë, medoemos do të bindemi se ata ishin 'ëndërrimtarë' të pathyeshëm dhe idealistë, që besuan fortë në ëndrrën për liri e mëvetësi. Ata mishëruan në shpirt, gjithë ato virtyte të larta morale e njerëzore, që sot marginalizohen ndoshta edhe me plan, nga shumë shtresa të shoqërisë sonë.

Ata ishin individë të virtytshëm, të cilët vinin nga familje me rrënjë e themel të kulluar moral, kombëtar e fetar. Pa trashëgimtarët e denjë, që ruajnë të njëjtat virtyte, shteti ynë i bërë, nuk i reziston dot furtunave historike, dhe ne, brezi fatlum, rrezikojmë të shembim gjithë atë që heronjtë me pietet u flijuan për të.

S'mund të jetë ndryshe, ngase është thënë nga lashtësia greke që "shteti është më i virtytshëm, kur qytetarët e tij janë më të virtytshëm", dhe si e tillë, kjo parullë, as sot, fare nuk është vjetruar.

S'drueshin asnjëherë moralistët puritanë, kur këmbëngulin se morali mundëson shndërrimin e njeriut nga karakteri i tij 'shtazor' në atë etik e human, dhe rrjedhimisht shteti i përbërë nga këta njerëz, kalon nga gjendja e tij e anarkisë në atë të rendit. Filluar nga Kanti, pastaj Hegeli e N. Hartmani, e shumë të tjerë, që të gjithë pajtoheshin për një gjë faktike se njeriu mbetet krijesa e vetme që mund të bartë e të adoptojë virtyte morale. Duke qenë i tillë, njeriu si krijesë e përsosur, vetëm i stolisur me virtyte morale, mund të jetë një shtyllë e fortë e një shteti të mirëkonsoliduar.

Edhe në përceptcionin islam, njeriu është krijesa e vetme që llogaritet mëkëmbës i Zotit në tokë, dhe ai mbetet i vetmi që mund ta mishërojë tërë atë korpus të gjerë vlerash morale, që me to e ka udhëzuar e ngarkuar Vetë Krijuesi i tij. Të mos harrojmë, Islami aspirojnë të ndërtojnë atë shoqëri, ku individët e saj do të jenë të stolisur me virtyte të larta morale, aq sa, edhe nëse nuk i sheh 'syri' i shtetit, ata gjithnjë kanë frikën nga Zoti i tyre. Preventivë e keqbërës për ta mbetet frika ndaj Zotit, e jo medoemos droja nga ligji apo tmerri nga ashpërsia e dënimit njerëzor. Silleni ndërmend porosinë e Allahut kur Ai tha: "...Mos iu frikësoni njerëzve, por më frikësohuni Mua...", (Ali Imran 175). Thënë ndryshe, nëse i ke shpëtuar ndëshkimit njerëzor, prej të cilit je frikësuar, mos u mashtro, ngase ti nuk i shpëton dot dënimit hyjnor për të cilin je paralajmëruar.

Kështu që, shtetit tonë, mëtonjës i lirisë dhe skajshmërisht qëndrestar, virtytet morale i duhen jo si luks, por si gurë themeli që ai s'mundet dot pa to. Edhe nëse këtij shteti ia kemi ruajtur mirëfilli baltën-truallin e tij, por kemi anashkalluar gjakun – pra njerëzit e tij, misionin e ruajtjes e mëkëmbies së tij e kemi kryer të përgjysmuar. Nga ne kjo gjë cilësohet si një mision i papërfunduar. Prandaj, nuk mjafton!

Mr. Driton Arifi

Dashuria ndaj atdheut – vepra më madhore

HYTBE ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Krijuesit të gjithësisë!

Përsëritet dhe selamet tona ia drejtojmë më të zgjedhurit të Allahut, Muhamedit a.s., familjes dhe shokëve të tij dhe të gjithë atyre që pasojnë rrugën e ndritshme islame deri në Ditën e Kiametit.

I Madhi Zot në Kuranin Famëllartë ka thënë: “Mos mendoni se janë të vdekur ata që kanë rënë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë te Zoti i tyre dhe furnizohen (me begati). Ata janë të gëzuar me të mirat e derdhura nga Zoti i tyre, e atyre që kanë mbetur akoma pa iu bashkuar radhëve të tyre, u marrin myzhde se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë se pse të brengosen!” (Ali Imran, 169-170).

Të nderuar vëllezër besimtarë!

Jemi në prag të festës së madhe, ditës së Pavarësisë së vendit tonë. Besoj se të gjithëve ju kujtohet dita e 17 shkurtit 2008, pikërisht në ora 15:39 minuta, kur anekënd Kosovës, deputetët tanë të Kuvendit të Kosovës në mënyrë unanime, me plot ndjenja krenarie dhe mes emocioneve të pafundme, po realizonin një ëndërr të kamotshme të shumë e shumë brezave, po përmbushnin një ideal dhe aspiratë të shumë e shumë burrave e grave që dhanë gjithçka nga vetja e tyre, po kurorëzonin një rrugëtim të gjatë e të vështirë për

Kosovën – po e shpallnin atë shtet të mëvetësishëm, sovran dhe demokratik.

Gëzimi dhe emocionet jehuan fuqishëm edhe jashtë Kuvendit, kudo ku janë shqiptarët. Kësaj jehone madhështore që shënonte fillimin e një epoke të re, iu bashkuan edhe ezanët muhamedije, që simbolizojnë përkrahjen dhe gëzimin e besimtarëve tanë për këtë ditë historike dhe që shprehnin falënderimin ndaj Allahut të Gjithëpushtetshëm, që na e mundësoi ta arrinim këtë ditë. Gjithnjë duke e kujtuar se për ta përjetuar këtë liri, këtë Pavarësi, është dashur të derdhet shumë mund dhe sakrificë deri në flajm e bijve dhe bijave më të mirë të kësaj toke, të këtij vendi.

Edhe sot, 17-vjet pas shpalljes së Pavarësisë dhe 26-vjet pas mbarimit të luftës, janë mbi 1600 shëhidë që nuk dimë gjë për fatin e tyre, por vetëm i llogarisim si të pagjetur, dhe nuk na është mundur as varrimi i tyre. Falë Allahut xh.sh. dhe sakrificës së pashoqe të popullit tonë, luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndihmës së miqve ndërkombëtarë ia kemi dalë me shumë sukses që t'i kundërvihemi kasaphanës, djegies, shkatërrimit e pastrimit etnik të ushtruar ndaj nesh nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serb. I Gjithëfuqishmi Allah, në Kuran, ka thënë: “Thuaj (o Muhamed): “Në të vërtetë,

Falë Allahut xh.sh. dhe sakrificës së pashoqe të popullit tonë, luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndihmës së miqve ndërkombëtarë ia kemi dalë me shumë sukses që t'i kundërvihemi kasaphanës, djegies, shkatërrimit e pastrimit etnik të ushtruar ndaj nesh nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serb.

Në atdheadashuri duhet të jemi në të njëjtin saf me të gjithë ata që i respektojnë institucionet e Kosovës, që angazhohen për mirëqenien e tyre, kurse syri jonë gjithmonë duhet të jetë i zgjuar duke vëzhguar çdo pëllëmbë të kësaj toke.



namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka ortak, kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij!” (El Enam,162-163).

Prandaj, vëllezër të dashur, me e dashtë dhe me e mbrojtë atdheun është detyrë e shenjtë, është detyrë mbi detyrat e çdo myslimani. Në atdheadashuri duhet të jemi në të njëjtin saf me të gjithë ata që i respektojnë institucionet e Kosovës, që angazhohen për mirëqenien e tyre, kurse syri jonë gjithmonë duhet të jetë i zgjuar duke vëzhguar çdo pëllëmbë të kësaj toke. Kjo edhe për faktin se Pavarësia historikisht është e arritura jonë më e madhe. Ju e dini se sot në botë jetojnë mbi 2000 popuj të ndryshëm por jetojnë vetëm rreth 200 shtete.

Gjatë këtyre 17 vjetëve nga shpallja e Pavarësisë, kemi bërë punë të mëdha, shtetndërtimi nuk ka qenë aspak i lehtë, përkundrazi ka kërkuar angazhim të mirëfilltë, prandaj të gjitha ato të mira që i kemi arritur me shumë mund e sakrificë, duhet t'i ruajmë me çdo kusht si dritën e syve. Në këtë drejtim, ndihma më e madhe konsiston në unitetin tonë, në muhabetin e singërtë në mes veti, duke e rritur dashurinë për njëri-tjetrin. Solidaritetin e mirëkuptimin që e kishim më herët e që ishte vlerë e jona, duhet ta kultivojmë edhe më shumë, dhe ato që i kemi përjetuar para Pavarësisë të mos i harrojmë kollaj. Populli jonë edhe në ditët më të vështira nuk është gjunjëzuar, por përplot krenari e me kokën lartë ka vazhduar të shtegtoj ashtu si duhet.

Të dashurit e Resulullahut!

Këtyre ditëve, teksa me plot meritë po festojmë Ditën e Pavarësisë, duhet ta sjellim në vëmendje se jemi në vigjilje të muajit të madhërishtëm Ramazan. Le të përfitojmë nga bereqeti i këtij muaji dhe t'i përkushtohemi më shumë vetes dhe familjeve tona. Është koha që farzeve t'u shtohen edhe veprat vullnetare të devotshmërisë (nafilet), të cilat i bëjmë vetëm nga dashuria për Mëshiruesin. Në një hadith Kudsî thuhet: “Gjërat më të dashura me të cilat mund të më afrohet robi Im janë detyrat obligative (farzet). Robi im më afrohet edhe me vepra vullnetare (nafile) derisa ta dua dhe kur e dua, bëhem dëgjimi i tij me të cilin dëgjon, shikimi i tij me të cilin sheh, dora e tij e fortë me të cilën vepron, këmba e tij me të cilën ecën. Nëse ai më kërkon diçka, Unë me siguri do t'ia jap, nëse ai kërkon mbrojtjen Time, Unë me siguri do ta mbroj atë.”

I Mëshirshmi Allah, na bëjë prej robërve Tu që Ty të duan pafundësisht! Zoti ynë, na e shtoj dashurinë për Atdheun tonë - Kosovën e dashur!

Bëhu me ne, O Zot, e jo kundër nesh!

Zoti ynë, mos na mundëso që të Të harrojmë Ty, që të largohemi nga mëshira dhe mbrojtja Jote!

Na mëso që të mos harrojmë se na ke dhënë Atdheun-Kosovën tonë të shtrenjtë, që ta duam atë dhe që të ruajmë paqen dhe lirinë në të! (Amin!)

Të gjithë shqiptarëve, urime 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës tonë të shtrenjtë!

Rëndësia e ruajtjes së racës njerëzore në kontekstin e ajeteve 5-7 të kaptinës El Muminun

Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

Njeriu është krijuar të veprojë si mëkëmbës i Zotit në tokë, andaj ai u dërgua në tokë ta kryejë këtë mision. Ky funksion paraqet madhështinë e njeriut në Shpalljen e Zotit, duke e paraqitur fatin e tij e kurrresi vuajtjen. Roli dhe pozita e mëkëmbësit është nder, që e ngrit njeriun nga fillimet e para, dhe ky rol i caktuar është me rëndësi si për burrin, ashtu edhe për gruan. Në këtë qëndron edhe rëndësia e barazisë së tyre si qenie njerëzore, si mëkëmbës të Zotit në tokë dhe çdonjëri prej tyre luan rolin e vet në shoqëri. Si rrjedhojë, familja është institucion i caktuar i frymëzimit hyjnor. Ajo nuk është zhvilluar nëpërmjet proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor, e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Ajo është ndërtuar si institucion i mënyrës së jetës, që t'i mundësojë njeriut ta përmbush misionin e tij. Shoqëritë njerëzore janë prodhim i këtij institucioni, e nuk është ky institucion prodhim i shoqërive njerëzore. Në Kuran, në lidhje me këtë thuhet: *“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin, se Allahu është Mbikëqyrës mbi ju.”* (En Nisa, 1).

Në këtë kaptinë përmendet rëndësia e ruajtjes së racës njerëzore përmes kujdesit ndaj moralit dhe parimeve etike që lidhen me të. Ajo thekson vlerat e besimit, moralin dhe përgjegjësinë që kanë njerëzit ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj shoqërisë.

Ruajtja e racës njerëzore, e civilizimit dhe e vazhdimësisë së saj në funksion të njeriut si mëkëmbës i Zotit, varet nga operativiteti i mekanizmit për lindje dhe shtim. Vazhdimësia e racës në procesin e vet kërkon strukturë të qëndrueshme, që vepron në mënyrë të organizuar. Pikërisht familja është institucion që mund ta plotësojë këtë proces që nga fillimi i zhvillimit e deri në përsosje. Mbi këtë koncept flitet edhe në kaptinën El Muminun, e cila zë vendin e 23-të në radhitjen kuranore e përbërë nga 118 ajete. Emri i saj El Muminun, nënkupton besimtarët, duke u fokusuar në cilësitë dhe karakteristikat e atyre që besojnë. Në këtë kaptinë përmendet rëndësia e ruajtjes së racës njerëzore përmes kujdesit ndaj moralit dhe parimeve etike që lidhen me të. Ajo thekson vlerat e besimit, moralin dhe përgjegjësinë që kanë njerëzit ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj shoqërisë. Besimtarët janë udhëzuar të veprojnë me drejtësi, të ndihmojnë të tjerët dhe të ruajnë harmoninë në shoqëri. Kjo nënkupton se ruajtja e racës njerëzore është e lidhur ngushtë me veprimet e tyre të mira dhe me respektimin e urdhrave hyjnorë. Në thelb, kaptina nxit për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të qëndrueshme, ku secili individ ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe zhvillimin e racës njerëzore.

KOHA E ZBRITJES DHE PËRMBAJTJA E KAPTINËS

E zbritur në Meke, pas kaptinës Enbija, kaptina Muminun përmes ajeteve të saj, ashtu si edhe në kaptinat e tjera që u shpallën gjatë kohës sa Pejgamberi a.s. dhe myslimanët ishin ende në Meke, i vë një theks të veçantë çështjeve bazë të besimit. Adresimi i ajeteve të kësaj kaptine vë në pah ritmin e përballjes së Pejgamberit a.s. me idhujtarët e Mekës. Pejgamberi a.s., prej momentit të parë të thirrjes në besim në një Zot, hasi në kundërshtime të ashpra, sidomos nga paria e Mekës. Tregohet nga historianët se Pejgamberi a.s. u ngjit në kodrën Safa dhe i ftoi kurejshitet që të mblidheshin dhe u tha: “O Benu Fihri dhe o Benu Nadir! Sikur t’ju thosha se prapa meje gjendet kalorësia e armikut, e cila do t’ju sulmojë, a do të më besonit?” Të gjithë u përgjigjën: “Po.” Atëherë Pejgamberi a.s. ua tërhoqi vërejtjen në ndëshkimin e ashpër që i pret për mosbesimin në një Zot. Atëherë reagoi Ebu Lehebi dhe tha: “A për këtë na ke ftuar! Qofsh i shkatërruar!”¹ Ky ishte ballafaqimi i parë direkt i Pejgamberit a.s. me politeistët. Pasi që Pejgamberi a.s. filloi t’i ftonte që të largoheshin nga idhujt e tyre dhe që të afroheshin te një Zot i vetëm, atëherë kurejshitet filluan që ta shprehin urrejtjen dhe hasmërinë e tyre për Pejgamberin a.s., sa që tentuan edhe ta largojnë nga Meka, mirëpo për shkak të pozitës së rëndësishme të familjes së tij, nuk arritën që ta largonin nga Meka. Në rrethana të kësaj zbriti edhe kaptina Muminun, ndër tematikat e së cilës përshkruhen gjashtë cilësitë e besimtarëve të drejtë, si dhe ruajtja e racës njerëzore duke u larguar nga imoraliteti, cilësi të cilat shpërblejnë me Xhenet. Në lidhje me kohën e zbritjes së kësaj kaptine, transmetohet nga Omeri r.a., të ketë thënë: “Kur iu zbrit shpallja Pejgamberit a.s., rreth tij dëgjohej një zë si ai i bletëve. Një ditë, kur shpallja filloi përsëri, ne pritëm për pak kohë. Pasi kaloi ajo gjendje, u drejtua nga kibla dhe ngriti duart duke u lutur: “O Zot, na jep shumë, mos na e pakëso; na ndero, mos na poshtëro; na jep, mos na lë pa; na mbroj, mos i prefero të tjerët ndaj nesh. Na bëj të kënaqur dhe bëhu i kënaqur me ne!” Pastaj tha: “Tani më zbritën dhjetë ajete. Kush i lexon këto ajete dhe i zbaton ato, do të hyjë në Xhenet.” Dhe lexoi dhjetë ajete e para të kësaj kaptine.”²



LIDHMËRIA E KAPTINËS MUMINUN ME KAPTINAT E TJERA

Kjo sure ka lidhmëri të ngushtë me atë paraprake El Haxh, duke u nisur nga fakti se në ajetet e fundit të kaptinës El Haxh u bëhet thirrje besimtarëve të praktikojnë ruku, sexhde dhe adhurim ndaj Zotit të Madhërishëm, të bëjnë vepra të mira dhe të angazhohen në rrugën e Tij. Inkurajon që ata të jenë shembuj të mirë për të tjerët, duke theksuar rëndësinë e faljes së namazit, dhënies së zekatit dhe mbajtjes së një lidhjeje të fortë me Allahun Fuqiplotë. Shikuar nga ky këndvështrim, kaptina Muminun, fillon me premtimin se besimtarët që i zbatojnë këto urdhra me përpikëri, do të arrijnë shpëtimin. Të arrish shpëtimin do të thotë të realizosh qëllimet tua, të fitosh të mira të pafundme, të ndihesh i sigurt dhe të gesh qetësi dhe begati në këtë botë dhe në të përjetshmen.

RUAJTJA DHE VAZHDIMËSIA E RACËS NJERËZORE NË KËNDVËSHTRIMIN E KAPTINËS MUMINUN

Islami e rekomandon martesën dhe ndalon çdo formë të marrëdhënieve jashtëmartesore. Rregullat islame kërkojnë që dëfrimi të bëhet në bashkëshortësi, sepse kështu të dy bashkëshortët marrin përgjegjësi të njëjtë për një dominim të qëndrueshëm në shoqëri. Kjo duhet të jetë forma elementare e lidhjes martesore dhe e stabilitetit të jetës familjare. Prandaj, duke shkuar në hap me jetën, urdhëron bashkësinë martesore, e cila u ofron burrave dhe grave mundësi që shtytjet e tyre natyrore t’i plotësojnë në të gjitha format e jetës, e cila përveç të tjerave përmban edhe përgjegjësi. Martesa gjithashtu është edhe një garanci për një jetë me vlera morale. Me anë të martesës kryhet dhe thellohet rruga e baraspeshës në marrëdhëniet ndërmjetëzore. Në këtë aspekt, në kaptinën Muminun thuhet: “Dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (për sa i përket jetës intime) me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave), që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar; e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që kanë shkelur normat e caktuara.” (El Muminun, 5-7).

Me këtë janë për qëllim ata që e ruajnë nderin e tyre duke mos rënë në imoralitet dhe homoseksualizëm dhe po ashtu duke iu larguar çdo mjeti i cili të çon deri në shthurje morale. Për të arritur këtë, ata iu larguan shikimit të ndaluar dhe e stolisën veten me petkun e devotshmërisë. Pastaj Allahu i Madhëruar e qartësoi se atij që nuk i mjafton ajo që ia lejoi Allahu nga kënaqësitë dhe i tejkalon kufijtë duke bërë mëkat, ai do të jetë meritë i ndëshkimit të Tij. Ruajtja e nderit, e përmendur në ajetin kuranor, është një strukturë morale që parandalon njerëzit të bien pre e dëshirave dhe kënaqësive të kësaj bote duke i kaluar kufijtë. Ajo është një nga elementet më të rëndësishme që duhet të mbahen parasysh dhe të ruhet forcërisht në mënyrë që personi të konsiderohet një mysliman i denjë. Ajo ndihmon njeriun që të pajiset me virtyte të larta si edukata dhe turpi. Për të qenë plotësisht një individ i ndershëm, kërkohet që duart, gjuha, sytë, veshët dhe në përgjithësi gjithë trupi të mbahet larg çdo sjelljeje që është në kundërshtim me moralin, e që pa dyshim, njeriu i ndershëm shpërblehet në mënyra të shumta, si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën e përtejme. Në lidhje me këtë, Pejgamberi a.s ka thënë: *“Kush më jep fjalën se do ta mbrojë gjuhën dhe nderin, unë i premtoj Xhenetin.”*³

Duke u nisur nga ky parim, është e rëndësishme të merren masa për ta mbrojtur brezin e ri dhe institucionin e familjes nga homoseksualiteti dhe strukturat që krijohen rreth tij, të cilat shkaktojnë krizë personale dhe dëme shoqërore. Në ditët e sotme, zhvillimi i teknologjisë dhe i platformave të ndryshme digjitale të komunikimit, të cilat ofrojnë një hapësirë të madhe me përmbajtje shpesh të papërshtatshme, duke kontribuar në normalizimin e sjelljeve devijuese si dhe anonimiteti që ofrojnë këto platforma duke inkurajuar individët të shprehin mendime dhe sjellje të papranueshme në jetën reale, po shkaktojnë një ndikim të konsiderueshëm në shthurjen e moralit dhe të vlerave sociale në mesin e të rinjve. Këta faktorë e bëjnë të rëndësishme mbikëqyrjen dhe edukimin e përdoruesve, veçanërisht të të rinjve, për t'i ndihmuar ata të navigojnë në këtë ambient digjital pa rënë pre e ndikimeve negative, e që rolin kryesor për këtë e luan familja e ndërtuar nga burri dhe gruaja.

Familja është instanca më besnike e vazhdimësisë së racës njerëzore. Ajo mbron moralin individual dhe krijon një ambient pozitiv me ndjenja shpirtërore duke përmbushur detyrimet martesore si dhe duke nxitur dashuri, ngrohtësi dhe mirëqenie në mes të anëtarëve të saj. Martesa luan një rol të rëndësishëm në avancimin e arsimimit, si dhe është

“Kush më jep fjalën se do ta mbrojë gjuhën dhe nderin, unë i premtoj Xhenetin.”

(Muhamedi, a.s.)

hallka e fundit që siguron stabilitetin e sistemit shoqëror dhe ekonomik. Ajo vazhdimisht motivon individët dhe forcon përpjekjet për zhvillim shoqëror, duke lehtësuar integrimin e brezave të rinj në shoqëri. Ajo shërben si lidhëse mes të kaluarës dhe të tashmes, duke hapur rrugë për të ardhmen dhe duke mundësuar ndërrimin e gjeneratave përmes proceseve të shëndosha. Kështu, martesa është një mjet që rregullon marrëdhëniet mes gjinive dhe përcakton mënyrën se si familja funksionon brenda komunitetit. Gjithashtu, ajo është themeli i bashkësisë, që integron anëtarët në një strukturë të unifikuar dhe që i ndihmon ata të realizojnë rolin e tyre kulturor dhe ideologjik në ambientin e tyre. Martesa si e tillë, është një institucion familjar gjithëpërfshirës. Nëse ky institucion dobësohet ose shkatërrohet, atëherë do të rrezikohet ardhmëria e tërë civilizimit dhe kulturës njerëzore. Për rolin e

familjes, si bartëse themelore e shoqërisë, na udhëzon edhe i Dërguari i Zotit në hadithet e shumta, mes të cilave ai thotë: *“Çdo foshnje e lindur, lind në Islam, por prindërit e saj mund ta transformojnë atë në besim tjetër ose në pabesim.”*⁴

Funksioni i shtimit të njerëzimit në botë, arsimimi dhe edukimi i fëmijëve, orientimi jetësor, formimi i karakterit, ndikimi gradual i kulturës dhe i besimit do të mbeteshin të mangët pa të dyja gjinitë. Kjo për shkak se kujdesi i prindërve është kyç deri në moshën madhore të fëmijës. Asnjë lloj institucioni tjetër, qofshin edhe disa institucione me rol të kujdestarit, çerdhe etj., nuk do të mund të jenë të barasvlershme me kujdesin që ofrojnë prindërit. Një nga qëllimet e martesës është të krijojë një lidhje psikike, emocionale dhe shpirtërore midis burrit, gruas dhe fëmijëve, që i përgjigjet natyrës njerëzore dhe dinamikave shoqërore. Asnjë detyrim, qoftë ai historik apo teknologjik, nuk duhet të vendosë për individin; ai vetë duhet të jetë ai që merr vendime për veten si mëkëmbës i Zotit në tokë. Përndryshe, arritjet tona në shkencë dhe teknologji (nëse nuk përdoren siç duhet) mund të na çojnë drejt një forme të re të robërisë, duke e detyruar individin të braktisë rolin e tij të vërtetë në këtë botë. Mbrojtja e identitetit tonë si njerëz dhe organizimi ynë drejt këtij qëllimi është i një rëndësie të veçantë. Kjo është edhe rruga në të cilën na thërret Kurani dhe Suneti i Pejgamberit a.s..

1 Taberiu, *Xhamiu'l Bejan*, VI/5.

2 Tirmidhiu, *Tefsir*, XXIII/1.

3 Buhariu, *Rikak*, 23.

4 Ibni Hanbeli, v. II, f. 315 -316.

Çfarë është Israja dhe Miraxhi?

Israja nënkupton udhëtimin e Pejgamberit Muhamed a.s., hipur mbi kafshën e quajtur (El Burak), nga Xhamia e Shenjtë – Meka deri në Xhaminë Al Aksa – Kuds, përgjatë një pjese të natës, e më pastaj rikthimi i tij (në Mekë) po atë natë.

Miraxhi nënkupton ngritjen apo lartësimin e Pejgamberit Muhamed a.s., në natën e Israsë, nga Mesxhidi Aksaja në qiejt e lartë, e më pastaj deri te Sidretu-l-Minteha, pastaj rikthimi i tij deri në Mesxhdi Aksa po atë natë.

VËRTETËSIA E NGJARJES SË ISRASË DHE MIRAXHIT

Ngjarja e Israsë është e vërtetuar përmes Kuranit famëlartë dhe haditheve autentike të Pejgamberit a.s. Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëme këtë

udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhamedit).” (El Isra, 1).

Nëse vështrojmë këtë ajet kuranor, prej tij përfitojmë dobi dhe kuptime madhështore, prej të cilave përmendim:

Fillimi i ajetit është me shprehje “Pa të meta është Lartmadhëria e Atij”, sepse Ai i Cili ka fuqinë për të bërë këtë veprim, sigurisht që është meritë dhe i denjë për ta lavdëruar dhe shenjtëruar.

Përmendja e termit “rob” në këtë kontekst është nder dhe privilegj. Mirëpo, në të njëjtën kohë, është edhe paralajmërim kundër përdorimit të udhëtimin të Israsë si mjet për ta ngritur të Dërguarin, Muhamedin a.s. nga pozita e robërisë në pozitën hyjnore.

Përmendja e termit “natën” kur e dimë se Israja ndodh vetëm natën, nënkupton se ky udhëtim ka ndodhur në një pjesë të natës, e jo në tërë natën.

Kjo tokë është vendqëndrim i pejgamberëve, është toka ku shumica e pejgamberëve janë shpërngulur në të, është kibla e tyre, është vendi ku zbresin melaqet, është vendndodhja e njërës prej tri xhamive më të njohura në botë.





Kuptimi i shprehjes së Zotit “rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar”, nënkupton bekimet nga aspekti fetar dhe nga aspekti i kësaj bote.

a). Sa i përket bekimeve fetare, ka për qëllim atë se kjo tokë është vendqëndrim i pejgamberëve, është toka ku shumica e pejgamberëve janë shpërngulur në të, është kibla e tyre, është vendi ku zbresin melaqet, është vendndodhja e njëres prej tri xhamive më të njohura në botë;

b). Ndërsa sa i përket bekimeve të kësaj bote, aludon në atë se ky vend rrethohet me lumenj, toka pjellore dhe shumë kopshte.

“për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona”, ka për qëllim ato krijesa madhështore, të cilat Allahu xh.sh. ia tregoi të Dërguarit të Tij në këtë natë. Gjithashtu edhe përdorimi i shprehjes “disa” është në kulmin e retorikës, sepse Allahu xh.sh. ka krijesa të shumta dhe të pa kufijshme, e të Dërguarit të Tij ia ka treguar vetëm disa prej tyre.

Ndërsa udhëtimi nga Mesxhidi Aksaj drejt qiejve (Miraxhi) është vërtetuar përmes haditheve autentike, të cilat i ka transmetuar Imam Buhariu, Muslimi dhe të tjerët.

Udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur me shpirt dhe me trup

Pjesa dërmuese e dijetarëve të gjeneratave të mëhershme dhe të atyre të mëvonshme janë të mendimit se Israja dhe Miraxhi janë ndodhi të cilat kanë ndodhur brenda të njëjtës natë. Ky udhëtim ka ndodhur me shpirtin dhe trupin e Pejgamberit a.s., e kjo argumentohet me shprehje kuranore ku Allahu xh.sh. ka thënë: “*robin e Vel*” e kjo ndodh vetëm me shpirt dhe trup.

Gjithashtu ka hadithe autentike, të cilat aludojnë në atë se udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit ka qenë me shpirt dhe me trup, prej tyre hadithi që tregon se gjoksi i Pejgamberit a.s. ishte çarë, pastaj hadithi që tregon se ai kishte hipur mbi Burak dhe ishte ngritur në qiell ku ishte takuar me pejgamberë, pastaj hadithi që tregon se aty i ishte bërë obligim namazi në

pesë kohë, pastaj hadithi që tregon se ai kishte folur me Allahun xh.sh., pastaj hadithi që tregon bisedën ndërmjet tij, Musait a.s. dhe Allahut xh.sh., e të tjera.

KUR KA NDODHUR NGJARJA E ISRASË DHE MIRAXHIT?

Shumica dërmuese e dijetarëve janë këmbëngulës se ngjarja e Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur pas shpalljes së relevatës të Pejgamberi a.s.

Mospajtimet ndërmjet dijetarëve shfaqen rreth vitit dhe muajit në të cilin ka ndodh.

Një pjesë e tyre ka thënë se kjo ngjarje ka ndodhur një vit përpara se Pejgamberi a.s. të shpërngulet në Medine.

Shumica e tyre mendojnë se ka ndodhur në muajin Rebiul evel, konkretisht më 12 Rebiul evel. Lidhur me këtë, Ibën Abasi ka thënë: “Pejgamberi a.s. ka lindur në vitin e elefantit, ditën e hënë më 12 Rebiul evel, në të njëjtën ditë dhe datë i është shpallur fjala e Zotit, po të njëjtën ditë dhe datë ka udhëtuar drejt qiellit dhe po të njëjtën ditë është shpërngulur.”

ISRAJA E MIRAXHI NË RAPORT ME SHKENCËN MODERNE

Israja dhe Miraxhi janë ngjarje të vërteta, të cilat janë vërtetuar përmes Kuranit dhe Sunetit, prandaj është e nevojshme të besohet në to. Ato janë dy mrekulli, janë dy gjëra që janë të mundshme për mendjen, dhe kushdo që pretendon se ato janë të pamundura, duhet të ofrojë prova.

Shkenca moderne tani po na paraqet zbulime të reja, siç është aeroplani reaktiv, i cili është më i shpejtë sesa shpejtësia e zërit, është bërë e mundur shkuarja në Hënë, por edhe shpikje të tjera. Prandaj, nëse njeriu, me gjithë dobësinë e tij, është në gjendje të bëjë shpikje të tilla, të cilat ndikuan që distancat e gjata të dukeshin të afërta brenda ligjeve precize, atëherë a nuk do të ishte në gjendje Krijuesi i këtij njeriu dhe gjithësisë ta barte të Dërguarin e Tij Muhamedin a.s., atje ku Ai donte me fuqi superiore dhe shpejtësi të mahnitshme? S’ka dyshim se Ai është i aftë për gjithçka.

NGJARJET TË CILAT I PARAPRINË ISRASË

Lexusi i jetëshkrimit të Pejgamberit a.s., vëren se ndodhisë së udhëtimit të Israsë dhe Miraxhit i kanë paraprirë kushte të rënda dhe ngjarje të dhimbshme, të cilat e rrethuan të Dërguarin a.s. nga çdo anë, e penguan rrugën e tij të thirrjes dhe i shkaktuan atij shumë probleme. Sikur këto ngjarje t’u kishin ndodhur predikuesve dhe reformatorëve të tjerë, ato do ta kishin dobësuar fuqinë e tyre dhe do t’i pengonin ata nga thirrja e tyre. Mirëpo, guximi, durimi dhe besimi i Pejgamberit a.s. në vërtetësinë e thirrjes së tij, e bëri atë të injoronte dhe të tejkalonte gjithçka që i doli dhe pengoi rrugëtimin e tij. Ndoshta në këtë ka një mësim praktik për predikuesit dhe reformatorët, të cilët bartin mesazhin e tij që

të ndjekin shembullin e tij dhe të injorojnë dhe tejkalojnë çdo vështirësi të që ju del para atyre.

TRI NGJARJET MË TË RËNDËSISHMET TË CILAT I PARAPRINË NGJARJES SË ISRASË

1. Vdekja e xhaxhait të tij Ebu Talibit

Nuk ka dyshim se xhaxhai i tij Ebu Talibi ishte përkrahës dhe mbrojtës i nipit të tij, Muhamedit a.s., pasi askush nuk guxonte t'i shkaktonte atij ndonjë dëm derisa ai vdiq. Me këtë rast jobesimtarët gjetën një rast dhe mundësi të mirë për ta nënçmuar dhe dëmtuar atë.

2. Udhëtimi i tij për në qytetin Taif

I Dërguari a.s., ishte lodhur nga mushrikët-politeistët në Mekë si rezultat i mohimit dhe dëmit që i kishin shkaktuar atij, kështu që iu desh të zhvendosej në një vend tjetër për të përhapur misionin e tij.

I Dërguari a.s., shkoi në Taif, qyteti më i afërt me Mekën. Qëllimi i tij ishte që të kërkonte ndihmë dhe përkrahje kundrejt politeistëve, nga të afërmit dhe farefisi, të cilët ndodheshin në atë qytet. Gjithashtu me shpresë se nga njerëzit e Taifit do të gjente mirëkuptim dhe simpati ndaj misionit të tij. Por ishte krejt e kundërta, sapo i Dërguari a.s., ua prezantoi mesazhin e tij, ata nxituan ta mohojnë atë dhe ta dëbojnë atë nga vendi i tyre, derisa dërguan skllëvërit dhe të çmendurit e tyre për të hedhur gurë mbi të, gjë që i shkaktuan gjakderdhjen nga këmbët e tij dhe si rezultat ai nuk mundi më të ecte mbi to, kështu që u ul pranë një kopshti, që i përkiste njërit prej armiqve të tij. Ai mbështeti shpinën pas një muri, duke fshirë gjakun me dorë pasi që ishte rraskapitur nga lodhja, uria dhe plagët. Më pas, melaqja e kodrave zbret nga qielli dhe i ofron t'i shtypë dy malet dhe t'i shkatërrojë ata, ndërsa përgjigjja e të Dërguarit a.s. ishte: "Përkundrazi, unë shpresoj se Allahu xh.sh. nga mesi i tyre do të nxjerrë pasardhës, të cilët do ta adhurojnë Allahun një të vetëm dhe nuk do t'i shoqërojnë Atij askënd."

3. Vdekja e bashkëshortes së tij, Hatixhes r.a.

Mërzinë e këtyre dy ngjarjeve (vdekjes së xhaxhait dhe udhëtimi i tij në Taif) e shtoi vdekja e bashkëshortes së tij besnike, Hatixhes r.a., e cila ia lehtësonte dhimbjen, e inkurajonte në thirrjen e tij dhe e përkrahte atë me pasurinë e saj.

Pas gjithë këtyre ngjarjeve të dhimbshme dhe tronditjeve psikologjike që ia shtuan shqetësimet dhe lodhjen të Dërguarit a.s., Zoti deshi ta nderojë atë me udhëtimin e Israsë dhe Miraxhit për t'i treguar disa nga shenjat e Tij, për t'u takuar me profetët, të cilët në thirrjen e tyre gjetën të njëjtat

Israja dhe Miraxhi janë një udhëtim për të demonstruar fuqinë hyjnore (asgjë nuk është e pamundur për Të).

vështirësi që ai gjeti në thirrjen e tij. Përmes këtij udhëtimi sikur Pejgamberit a.s. i thuhet: O Muhamed, nëse fyerjet e budallenjve në tokë do të të lëndonin, a nuk do të të kënaqte pritja e engjëjve dhe e dërguarve për ty në qiej? Nëse kriminelët injorantë rreshtohen rreth jush duke ju gjuajtur me gurë, këtu janë profetët të rreshtuar pas jush që t'i udhëhiqni ata në lutjet e tyre.

MËSIMET MË TË RËNDËSISHME QË DUHEN NXJERRË NGA UDHËTIMI I ISRASË DHE MIRAXHIT

Nga mësimet më të rëndësishme të udhëtimin të Israsë dhe Miraxhit është njohja e vlerës së statusit të Xhamisë Al Aksa që ka në entitetin e këtij ymeti. Gjithashtu nga mësimet e rëndësishme të udhëtimin të Israsë dhe Miraxhit është edhe njohja e pozitës dhe vlerës së namazit.

Kur flasim për mësimet më të rëndësishëm nga udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit, duhet të themi se këto dy udhëtime ishin një stacion i rëndësishëm në jetën e Pejgamberit a.s. dhe në rrugëtimin e thirrjes së tij në Mekë, pas gjithë atyre vuajtjeve që peripecive që pësoi nga kurejshët.

SI TA KUPTOJMË DOMETHËNIEN E ISRASË DHE MIRAXHIT NË JETËN TONË TË PËRDITSHME?

Kur Zoti xh.sh. e mori robin e Tij në një pjesë së natës, nga Xhamia e Shenjtë – Meka në Xhaminë Al Aksa, pastaj e ngriti atë në shtatë qiej ku takoi profetët dhe të dërguarit e Tij, udhëtimi nuk ishte vetëm një mrekulli hyjnore që tregoi fuqinë e Zotit, por ishte edhe një mësim për myslimanin nga i cili duhet të mësojnë mëshirën dhe devotshmërinë.

Ne mund të marrim frymëzim nga Israja dhe Miraxhi për të na ndihmuar t'i lehtësojmë punët tona të përditshme, nëse mund ta kuptojmë mesazhin që synonte Zoti, dhe ta konsiderojmë atë udhëtimin e myslimanit drejt Zotit të tij.

Israja dhe Miraxhi janë një udhëtim për të demonstruar fuqinë hyjnore (asgjë nuk është e pamundur për Të). Kjo mund të na bëjë të kuptojmë çështjet tona shumë thjesht, se Zoti është i Plotfuqishëm për gjithçka, për furnizimin tonë, shëndetin tonë, lumturinë tonë në këtë botë dhe të gjitha punët tona janë në duart e Zotit, kështu që nuk ka nevojë të shqetësohemi.

Përcjellësi i cili kujdeset që të mos gabosh

Kujdesi i Krijuesit ndaj krijesave të Tij është një kujdes i mahnitshëm. Ai është i tillë në veçanti ndaj njeriut si qenie, e cila ka përgjegjësi për veprimet e veta dhe se veprimet e tij nuk janë thjesht për veten e tij, por kanë efekt domino, ku ndikimi i këtyre veprimeve bartet edhe te të tjerët, të mira qofshin ato, apo të këqija.

Nëse ky fakt është i pamohueshëm, atëherë është e kuptueshme kujdesi i Krijuesit që ta rregullojë besimtarin në atë mënyrë që kur ai të dalë në fushëveprim me të tjerët, të jetë ai më i miri, ndërsa veprimet e tij të jenë të pranueshme, të lavdërueshme dhe të dobishme, e si rrjedhojë e kësaj, ai të jetë edhe i shpëtuar në botën tjetër.

Thënë më qartë, ky është edhe objektivi madhor i Islamit, që në secilin prej ajeteve kuranore dhe në secilin prej haditheve të Pejgamberit a.s., do të gjejmë të skalitur nga një fanar ndriçues, nga i cili do të marrë dritë secili besimtar, e me këtë dritë do të shndrisë në jetën e tij.

Por, si duket një besimtar i tillë, me një besim të pastër e të përkthyer në vepra të dobishme dhe moral të lartë, cili është ai mekanizmi fetar, i cili i instalohet këtij besimtari për të funksionuar si i tillë për të mbetur i njëjtë në secilën gjendje, edhe me Zotin, edhe me të tjerët, edhe në vetmi, edhe në publik, dhe i cili nuk ndryshon me

ndryshimet e mundshme, por mbetet i njëjtë gjithnjë.

Nëse kërkojmë të bëjmë një definicion për këtë besimtar, do ta përkufizojmë me emrin “*njeri i devotshëm*”, e nuk do shumë mund për ta kuptuar se në fillim të Kuranit, madje që në ajetet e para të sures El Bekare, Allahu na njofton se ky Kuran është udhëzues për ata që janë të tillë: “*Ky është Libri që nuk ka dyshim në te (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.*” (El Bekare, 2).

Kjo fjalë, me të gjitha shprehjet që aludojnë në këtë kuptim, është përmendur hiç më pak se në mbi 258 vende, që është një argument i fuqishëm për domosdoshmërinë e posedimit të kësaj cilësie, apo pajisjes me këtë formulë kuranore.

Në definicionet e shumta, të cilat e kalojnë numrin e më shumë se dhjetë të tillave, baza e të gjithave kthehet në atë se si njeriu duhet të jetojë siç do Krijuesi i tij, si dhe të jetë tek ai e përafërt nëse jo e njëjtë gjendja e brendshme e tij me atë të jashtme.

Nëse ky është kuptimi i devotshmërisë (takvallakut), atëherë për këtë gjë do të dalim në rezultatin e asaj që, nevoja e besimtarit për devotshmëri është domosdoshmëri jetike, e me këtë gjithashtu e kuptojmë se rezultatet e pajisjes me devotshmëri janë të mëdha.

Në secilin prej ajeteve kuranore dhe në secilin prej haditheve të Pejgamberit a.s., do të gjejmë të skalitur nga një fanar ndriçues, nga i cili do të marrë dritë secili besimtar, e me këtë dritë do të shndrisë në jetën e tij.

DOBITË E DEVOTSHMËRISË

Nëse ndalemi dhe bëjmë një përzgjedhje të dobive të devotshmërisë sipas Kuranit, do të jetë shumë e vështirë një gjë e tillë, pasi që nga mbi 250 ajete që flasin për këtë virtut, vështirë është të përzgjidhet diçka e të lihet diçka tjetër, por do të mundohemi që thjesht, sa për ilustrim të paraqesim një tablo të tyre:

Pajisja me qartësi në kuptime dhe veprime: *“O ju që keni besuar, nëse bëheni të devotshëm, Allahu do t’ju japë kthjelltësinë në ndarjen e gjërave dhe kuptimin real të tyre.”* (El Enfal, 29);

Rrugëdalje dhe rrugëzgjdhje: *“Kush bëhet i devotshëm, do t’i bëjmë rrugëzgjdhje edhe atëherë kur njeriu do të mendojë se i janë mbyllur të gjitha dyert, e s’ka rrugëdalje.”* (Et Talak, 2);

Furnizim me rrësk: *“I jep rrësk atij, madje edhe nga se kujton fare.”* (Et Talak, 3). Ky është një shpërblim dhe një përkrahje hyjnore për ata që i frikësohen harameve dhe kërkojnë rrëskun në gjërat hallall. Të tillëve do t’ju vije rrësku nga Pronari i depove të qiejve dhe të Tokës.

Falja e gjynaheve është një brengë, e cila në vazhdimësi e përcjellë besimtarin. E për këtë kategori ka ardhur edhe përgëzimi: *“E ata që kanë devotshmëri, do t’ju falen gjynahet e tyre.”* (Et Talak, 5);

Në vargun e gjatë të fryteve të devotshmërisë, mjafton të përmendet edhe dashuria e Krijuesit: *“Me të vërtetë, Allahu i do të devotshmit.”* (Et Tevbe, 4).

Në pikën e pestë të dobive të devotshmërisë e përmendëm se Allahu i do ata që janë të devotshëm, kjo ngase ata janë pasqyrimi më i mirë i robërve që Allahu i do, sepse të tillët janë shëmbëlltyra e mësimëve të Allahut.

Ata nuk janë njerëz të izoluar dhe të vetmuar, nuk janë të tillë që rrinë duke vajtuar apo duke veshur rroba të vjetruara e që ecin rrugëve si të mjerë. Jo, jo, ata janë njerëz të zakonshëm si të gjithë njerëzit e tjerë, janë prindër, familjarë, mësues, nxënës, mjekë, policë, udhëheqës etj., pra janë vetë shoqëria, por ajo që i dallon, e që është më kryesorja e të gjitha obligimeve jetësore, me përkushtim, përgjegjësi dhe profesionalizëm, është se janë të ndihmuar nga Allahu xh.sh., dhe se para së gjithash, ata e dinë se përgjegjësi për veprime e tyre do t’i japin vetëm Atij.

Se sa e nevojshme është devotshmëria në shoqëri dhe se sa të dobishëm do të ishin njerëzit që jetojnë me këto kuptime, Sujuti në *“Durer Menthur”*, na tregon se kur është pyetur Ebu Hurejra r.a., për devotshmërinë, ai ka thënë: *“A ke ecur në rrugë me gjemba?”* *“Po”* – thanë. *“Si ke vepruar?”* Tha: *“Kam pasur kujdes që të mos i prek e të mos therem.”* *“Kështu tha është devotshmëria, të ecësh në dynja e të kesh kujdes të mos prekësh aty ku nuk duhet.”*¹



“Të mos prekësh aty ku nuk duhet” – do të thotë të mos prekësh nderin e tjetrit, të mos prekësh në pasurinë e ndaluar, të mos fyesh e të mos lëndosh ndjenjat e tjetrit, të mos bësh padrejtësi, të mos e lësh pa e kryer punën që ke marrë në përgjegjësi, apo të mos marrësh përgjegjësi që nuk i kryen dot, të mos shkelësh kufijtë, të mos e teprosh etj., pra me një fjalë, të ecësh në këtë botë me përgjegjësi, si dhe të bësh dobi kudo që të jesh.

E brendshmja dhe e jashtmjja jote duhet të jenë njësoj, i thjeshtë, pa mendjemadhësi, pa mendim të keq për tjetrin, i çliruar nga egoja, lakmia, zilia. Kur të gjitha këto i ka parasysh besimtari, nuk është e çuditshme përse kaq shumë qenka përmendur devotshmëria në Kuran. Madje, Allahu i Madhëruar edhe Pejgamberit Muhamed a.s., i ka thënë: *“O ti Pejgamber, qëndro i fortë në besnikëri ndaj Allahut...”* (El Ahzab, 1). Nëse njeriut me zemrën më të mirë që ka shkelur në këtë tokë, Muhamedit a.s., i është thënë kështu, na bëhet edhe më e qartë grada e devotshmërisë dhe domosdoshmëria e pajisjes me këtë virtut.

“Ne i patëm këshilluar edhe pasuesit e librave më herët, por edhe juve, pajisuni me devotshmëri...” (En Nisa, 131), pra njeriu gjithmonë ka qenë i nevojshëm të jetë i mirë, e objektiva e të gjitha librave të shpallura te të gjithë pejgamberët a.s., ka qenë rregullimi dhe përmirësimi i njeriut, e mekanizmi më i saktë dhe më efektiv për këtë ka qenë dhe mbete devotshmëria.

Shkalla jonë e të qenit të mirë, produktiv, të frytshëm, por edhe të shpëtuar, varet nga shkalla e devotshmërisë, andaj të investojmë në veten tonë dhe në shoqëri përmes kësaj dere!

1 Tefsir el Methur”, Dar Ihaja et Turath el Arabi, Bejrut, vëllimi I, fq. 61.

Sigurimi i të varfërve dhe të pafuqishmëve është një nga shtyllat e fesë islame

Islami ka kërkuar prej atyre që mund të punojnë, të ecin nëpër viset e tokës, për të ngrënë nga furnizimi i Allahut në të, dhe të shpërndahen nëpër anët e saj, për të kërkuar mirësitë e Tij. Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Ai jua ka bërë tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai. Si të ringjallemi, do të kthehemi tek Ai.” (El Mulk, 15).

Po ashtu Ai xh.sh. thotë: “Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkon nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.” (El Xhumua, 10).

Islami i ka dhënë punëtorit të drejtën për rezultatin e punës së tij, se pasuria e tij është fryt i përpjekjes dhe angazhimit të tij, kështu që puna është shtylla e parë në shpërndarjen e pasurisë në shoqërinë islame.

Megjithatë, anëtarët e shoqërisë – d.m.th. shoqëria – nuk janë të gjithë punëtorë, që e fitojnë furnizimin e tyre me punën e tyre dhe e bëjnë plotësimin e nevojave të tyre me mundin dhe djersën e tyre. Por, ka edhe të atillë, që nuk janë në gjendje të punojnë dhe të fitojnë, as nuk kanë dikë që kujdeset nga të afërmit e tyre, siç janë fëmijët jetimë, gratë e veja, pleqtë e moshuar, të sëmurët rëndë,

“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkon nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.”

(El Xhumua, 10)

personat me nevoja të veçanta, si dhe të çmendurit dhe të verbrit. Të gjithë këta, nuk janë në gjendje ta fitojnë kafshatën e bukës dhe ta sigurojnë furnizimin e tyre për jetë.

Ka edhe të atillë që i mbyllin dyert e punës para syve të tyre, ndonëse kanë aftësi dhe mundësi për ta bërë atë, pastaj shkojnë dhe kërkojnë mundësi për të punuar në sektorin shoqëror dhe atje nuk e gjejnë, kështu që ata nuk kanë asnjë burim jetese, as burim të ardhurash, përveç punës, sikur që ka edhe nga ata që punojnë, por nga puna e tyre fitojnë më pak sesa që janë nevojat e tyre, për shkak të pagave të ulëta, apo ngarkesave të tyre të shumta.

Këto grupe nuk marrin hise të pasurisë në bazë të punës, sepse disa prej tyre janë të paaftë për punë, disa prej tyre nuk gjejnë punë, disa prej tyre gjejnë punë, por ajo nuk ju mjafton. Për këtë shkak, Islami e ka bërë nevojën dhe paaftësinë e tyre justifikim për të pasur të drejtë në paratë e zekatit, të cilin Allahu e bëri farz në Kuranin famëlartë. Atë pastaj e ka sqaruar me gjuhën e Pejgamberit të Tij a.s., duke shpjeguar se kush janë ata që përfitojnë nga zekati, kush e ka detyrim dhënien e tij, kush përfiton nga dhënia e tij, nga cilat pasuri jepet zekati, cila është shumta për të cilën duhet të jepet zekati, kur është

koha e kryerjes së tij, cila është mënyra e pagimit dhe shpërndarjes së tij, etj..

Zekati në Islam nuk është bamirësi, me të cilën personi i pasur e ndihmon të varfrin nëse dëshiron, ose nuk e ndihmon nëse dëshiron, por përkundrazi, ai është obligim i njohur të cilin Allahu i Plotfuqishëm e ka urdhëruar në pasurinë e të pasurve, dhe zbatimin e tij e ka bërë shtyllë të tretë të Islamit dhe njëren nga bazat më të rëndësishme të fesë, duke e obliguar komunitetin mysliman që të bashkëpunojë në zbatimin e tij. Ai këtë e bëri një nga shërbimet më të rëndësishme, të cilat i kryen shteti islam dhe një nga detyrat më të shenjta me të cilën Allahu e ngarkoi udhëheqësin e myslimanëve.

Transmetohet nga Abdullah bin Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): Në të dëshmuarit se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, haxhillëkun dhe agjërimin e ramazanit.”* (Buhariu dhe Muslimi).

Kujdesi i Islamit në detyrimin e zekatit ka arritur gjer në atë masë, sa që dhënien e tij e ka bërë dëshmi të hyrjes në fe dhe pranimin të besimit, siç janë edhe braktisja e politeizmit dhe falja e namazit. Në lidhje me politeistët, të cilët e luftonin zekatin, Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“... por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë i lini të qetë! Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”* (Et Tevbe, 5).

Pendimi nga politeizmi (shirku), falja e namazit dhe dhënia e zekatit janë ato që e mbrojnë gjakun e politeistëve luftëtarë, e ndalojnë luftimin e tyre dhe justifikojnë pranimin e tyre në komunitetin mysliman, ku e shijojnë vëllazërinë, garancinë dhe solidaritetin, pastaj aty e shijojnë edhe drejtësinë dhe bamirësinë. Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe...”* (Et Tevbe, 11).

Së këndejmi, parimet e ekonomisë janë inkorporuar në prioritetet e Islamit dhe në rregullat e fesë. Në këtë mënyrë, garancia e shoqërisë për anëtarët e saj, të cilët nuk janë në gjendje të punojnë është shtyllë nga shtyllat e fesë dhe rregull nga rregullat e Islamit. Nuk pranohet pretendimi i besimit pa të. Nuk konsiderohet pjesëtar i komunitetit mysliman, ai i cili nuk e pranon atë dhe nuk e kryen me bindje të plotë dhe me gjithë zemër. Nuk ka asnjë ndryshim, në këtë aspekt, midis zekatit dhe namazit. Për këtë arsye, zekati në Kuranin famëlartë ka ardhur gjithmonë bashkë me namazin. Transmetohet nga Ibën Zejdi r.a., se ka thënë: *“Namazi dhe*

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zekatin.”

(El Muminun, 1-4)

zekati janë bërë obligim së bashku, nuk është bërë dallim mes tyre. Pastaj ka lexuar: *“E, nëse ata pendohen, dhe falin namazin e japin zekatin, (atëherë) për nga besimi janë vëllezër me ju.”* - dhe nuk e ka pranuar namazin përveçse me zekatin. Dhe ka thënë: *Allahu e mëshiroftë Ebu Bekrin, sa horizont të gjerë që kishte!”* (Tefsiri i Taberit).

Allahu i Lartëmadhërishtëm, pagesën e zekatit e ka bërë kusht që individit të hyjë nën ombrellën e besimit dhe ta realizojë të drejtën e shpëtimit të madh dhe Xhenetit Firdevs, të cilin Allahu e ka përgatitur për besimtarët. Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zekatin.”* (El Muminun, 1-4).

Dhënia e zekatit është mënyrë e udhëzimit dhe shkak për lajme të mira. Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“Udhërrëfyesi dhe lajm të mirë për besimtarët, të cilët falin namazin, ndajnë zekatin dhe besojnë bindshëm në jetën tjetër.”* (En Neml, 2-3).

Kështu që udhëzimi, të cilin Allahu ua dha besimtarëve dhe sihariqi të cilin ua premtoi atyre, është falja e namazit dhe dhënia e zekatit. Dhënia e zekatit e bën individin një nga bamirësit, të cilëve Allahu ju ka përgatitur mirësi të pakufishme. Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“(I cili) është udhërrëfyesi dhe mëshirë për punëmirët, që kryejnë namazit, japin zekatin dhe besojnë bindshëm në jetën tjetër.”* (Lukman, 3-4).

Përkthim nga arabishtja:

Miftar Ajdini



Pse hanefitë nuk i ngrenë duart kur përkulen në ruku dhe kur ngrihen nga ajo?

Pyetja: Pse hanefitë nuk i ngrenë duart kur përkulen në ruku dhe kur ngrihen nga ajo? A nuk është ky veprim kundër sunetit të Pejgamberit a.s., i cili ka thënë: “Faluni siç më shihni mua duke u falur.”?

Përgjigja:

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit! Pikëpamja korrekte në medhhebin hanefi është që të ngrihen duart vetëm gjatë tekbirit fillestar dhe që të mos ngrihen gjatë tekbireve të tjera. (Haskafi / Ibën Abidin, Reddu'l Muhtar ale'l Durri'l Muhtar, 1340, Bulaq ed.). Kjo gjë

vërtetohet dhe përforcohet fare mirë nga hadithe të transmetuara nga shokë të mëdhenj të Pejgamberit Muhamed a.s., siç janë: Abdullah ibën Mesudi, Abdullah ibën Umeri e shumë të tjerë, Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë!

Ngjashëm, kjo është pikëpamje edhe e shkollës apo medhhebit maliki. Shpresojmë që këto që pasojnë të jenë të dobishme për ta kuptuar këtë çështje më qartë.

TË NGRITURIT E DUARVE GJATË PËRKULJES NË RUKU

Dallimi që gjendet te transmetimet – hadithet në lidhje me ngritjen e duarve janë tri llojesh:

1. Ekzistojnë hadithe që tregojnë qartë se Muhamedi a.s., i ka ngritur duart para përkuljes në ruku.
 2. Po ashtu ekzistojnë hadithe që tregojnë se Muhamedi a.s., nuk i ka ngritur duart asnjëherë gjatë namazit, përveç se kur e ka shqiptuar tekbirin fillestar.
 3. Si dhe ekzistojnë hadithe që e përshkruajnë të tërë namazin e Pejgamberit Muhamed a.s., por nuk përmendin se nëse ai i ka ngritur apo jo duart edhe pas tekbirit fillestar.
- Hadithet e kategorisë së parë janë dëshmi për ata, të cilët mendojnë se duhen ngritur duart edhe pas tekbirit fillestar. Hadithet e kategorisë së dytë shërbejnë si dëshmi për ata që mendojnë se nuk duhen ngritur duart pas ngritjes në tekbirin



fillestar. Edhe pse hadithet e kategorisë së parë duket të jenë më shumë në numër sesa ato të së dytës, kjo nuk do të thotë asgjë, meqë hadithet e kategorisë së tretë gjithashtu mund të përdoren duke u lidhur me kategorinë e dytë si dëshmi e mos ngritjes së duarve.

Arsyeja për këtë është ajo se mospërmendja e diçkaje është dëshmi që ajo nuk ishte praktikë e përhapur. Po ashtu është shumë vështirë të pranohet ajo se duke e demonstruar të falurit e Pejgamberit a.s., demonstruesi të mund të ketë harruar të përmendë diçka aq të rëndësishme sa të ngriturit e duarve, po të kishte qenë ajo një aspekt i rëndësishëm i namazit. Andaj, duke i shfrytëzuar hadithet e kategorisë së tretë si dëshmi për kompliment mbi hadithet e kategorisë së dytë, hadithet që mbështesin mos ngritjen e duarve faktikisht do t'i tejkalojnë në numër ato që mbështesin ngritjen e duarve.

Për të elaboruar edhe më, duhet që të kuptohet ajo se mos ngritja e duarve nga ana e Pejgamberit, Muhamedit a.s., është një veprim inekzistent, e njerëzit nuk i përmendin veprimet inekzistente gjatë bisedave të tyre. Për shembull, nëse një person duke u kthyer në shtëpi nga xhamia ndodh të rrëzohet dhe të lëndohet, atëherë menjëherë do të thuhet se: “*Ai u rrëzua*”, meqë të rrëzuarit e tij është bërë një veprim ekzistent (një gjë që vërtet ka ndodhur).

Në anën tjetër, nëse po i njëjti person vjen në shtëpi pa mos i ndodhur kurrfarë aksidenti, atëherë askush nuk do të thotë se: “*Ai nuk u rrëzua*”, meqë ky është një veprim inekzistent. Ky është vetëm një nga njëqind veprime të tjera të tilla që nuk kanë ndodhur. Rasti i këtyre haditheve është i ngjashëm, pra pasi që Pejgamberi a.s., nuk i ka ngritur duart asnjëherë, përveç se gjatë tekbitit fillestar, transmetuesit nuk e kanë përmendur atë. Po të kishte qenë të ngriturit e duarve një praktikë e rregullt e Pejgamberit a.s., të cilën e ka harruar që ta bënte ndonjëherë, pa dyshim që transmetuesi do ta përmendte. Kjo mund të lidhet me shembullin e një personi, i cili ka kohë fikse për ushqim. Nëse për ndonjë shkak ai do harronte të hante në atë kohë, dikush do t'i përmendte se ai ka harruar të hajë, meqë ngrënia e ushqimit në atë kohë duhej të ishte një veprim ekzistent për të, i cili nuk ka

Po ashtu është shumë vështirë të pranohet ajo se duke e demonstruar të falurit e Pejgamberit a.s., demonstruesi të mund të ketë harruar të përmendë diçka aq të rëndësishme sa të ngriturit e duarve, po të kishte qenë ajo një aspekt i rëndësishëm i namazit.

ndodhur. Askush nuk do të komentonte për mos ngrënie e tij të ushqimit në ndonjë kohë tjetër, meqë të ngrënit në ndonjë kohë tjetër është zakonisht një veprim inekzistent për këtë person, e veprimet inekzistente zakonisht nuk përmenden. Tani, hadithi i kategorisë së tretë nuk përmend asgjë rreth ngritjes së duarve si një veprim i zakonshëm i Pejgamberit a.s..

Si rezultat, edhe këto hadithe gjithashtu mund të përdoren si dëshmi së bashku me ato të kategorisë së dytë për opinionin hanefitë. Kjo gjë dukshëm do ta rrisë numrin e haditheve në favor të mendimit hanefitë duke i kaluar në numër hadithet e kategorisë së parë.

HADITHI MBI NGRITJEN E DUARVE

Grupi i parë zakonisht paraqet transmetimet e Ibën Umerit, r.a. dhe të Malik ibën el Huvejrithit r.a., si burim kryesor të dëshmisë së tyre, meqë të dy këta sahabë kanë transmetuar mbi të ngriturit e duarve gjatë tekbitit për përkuljen në ruku, por ata kanë transmetuar edhe për mos ngritje të duarve.

Grupi i parë i ka pranuar vetëm ato transmetime të këtyre sahabëve r.a., të cilat e përmendin atë se Pejgamberi a.s., i ka ngritur duart gjatë tekbitit fillestar dhe gjatë rukusë, kurse i kanë mospërfillur transmetimet e tjera.

Dijetarët hanefi nuk e kanë bazuar opinionin e tyre në këtë lloj transmetimesh, por e kanë bazuar në ato raporte, transmetuesit e të cilave janë konsekuentë. Burimi i tyre i parë janë transmetimet e Abdullah ibën Mesudit r.a., i cili thotë se duart ngritën vetëm në tekbinin fillestar dhe më nuk ngritën asnjëherë gjatë tërë namazit. Të gjitha raportet e tij shpjegojnë të njëjtën praktikë. Tani po merremi me çështjen e transmetimeve të Abdullah ibën Umerit r.a., të cilat zakonisht citohen nga ata që thonë se Pejgamberi a.s., shpesh i ka ngritur duart gjatë namazit. Dihet fare mirë se Imam Maliku ka marrë shumë transmetime nga Ibën Umeri r.a. Në fakt, zinxhiri i tij i famshëm, i cili kalon përmes Nafiut tek Abdullah ibën Umeri r.a., njihet si “*zinxhiri i artë*”. Megjithatë, në këtë çështje, Imam Maliku nuk e bazoi opinionin e tij në



këto transmetime, por i pranoi transmetimet e Ibën Mesudit r.a., dhe i dha përparësi praktikës së medinasve, praktikë e cila njihet të ngriturit e duarve vetëm gjatë tekbitit fillestar.

Së dyti, Ibën ebi Shejbe dhe Imam Tahaviu kanë transmetuar një tjetër hadith të Ibën Umerit r.a., përmes Muxhahidit, në të cilin përsëri nuk përmendet të ngriturit e duarve. Nëse kjo do të ishte një praktikë konstante e Pejgamberit a.s., atëherë përse nuk u përmend në këtë transmetim? Për më tepër, edhe pse ekzistojnë shumë hadithe të Ibën Umerit r.a., lidhur me ngritjen e duarve, ekzistojnë shumë mospërputhje te to. Një konfuzion i tillë në raportet e një transmetuesi, nuk do të lejojë që transmetimet e tij të pranohen në prani të raporteve të tjera, të cilat janë më precize dhe më të qëndrueshme. Për shembull, në njërin nga transmetimet e tij, i cili përmendet në “Mushkilu’l-Athar” të Imam Tahaviut, thotë se duart ngritën gjatë gjithë namazit, ndërsa në transmetimet e tija të tjera kjo gjë nuk përmendet.

HADITHI MBI MOS NGRITJEN E DUARVE

Ne tani do të paraqesim disa transmetime, të cilat thonë se Pejgamberi a.s., i ka ngritur duart vetëm gjatë tekbitit fillestar:

1. Alkame ka thënë se Abdullah ibën Mesudi, r.a., ka thënë: “A doni që t’ju demonstrojë juve se si është falur Pejgamberi i Zotit a.s.?” Ai (Ibën Mesudi) u fal dhe nuk i ngriti duart, përveçse gjatë tekbitit fillestar.” (Sunen et Tirmidhi, 1:59, Sunen en Nesai, 1:161, Sunen ebi Davud, 1:116). Imam Tirmidhiu këtë hadith e klasifikon si të mirë (hasen). Al’lame ibën Hazmi e klasifikon si shumë autentik (sahih) - (El Muhal-la, 4:88), ndërsa Al’lame Ahmed Muhamed Shakiri, duke e përjashtuar kritikën e disa dijetarëve, shkruan në komentin e tij të Sunen et Tirmidhiut se: “Ky hadith është vërtetuar si autentik nga Ibën Hazmi dhe nga ekspertë të tjerë të hadithit (huffaz) dhe çka do që është thënë mbi të, se përmban defekte, është jo korrekte.” Në *El Xheuheru’n Naki* përmendet se

transmetuesit e tij janë ata të Sahih Muslimit (I’lau’s Sunen, 3:45).

2. Alkame thotë se Abdullah ibën Mesudi r.a., pyeti: “A nuk doni t’ju informoj mbi namazin e Pejgamberit të Allahut a.s.?” Ai (Ibën Mesudi) u ngrit dhe duart i ngriti në fillim të namazit dhe më nuk e bëri një gjë të tillë.” (Sunen en Nesai, 1:158, I’lau’s Sunen, 3:48).
3. Alkame transmeton nga Abdullah ibën Mesudi r.a.: “Pejgamberi i Allahut a.s., i ngrite duart gjatë tekbitit fillestar, pastaj më nuk i ngrite përsëri.” (Sherh Me’ani’l-Athar, 224).
4. Abdullah ibën Mesudi r.a., tregon: “U fala me të Dërguarin e Allahut a.s., Ebu Bekrin dhe Umerin r.a.. Ata nuk i ngritën duart, përveçse në fillim të namazit.” (Nesbu’r Rrajeh, 1:526, Mexhmau’z Zevaid, 2:101). Duke gjykuar nga hadithet e lartshënuara, mund të konkludohet shumë lehtë se Pejgamberi a.s., nuk i ka ngritur duart rregullisht gjatë namazit.

Ibën Mesudi, Aliu dhe sahabë të tjerë r.a., a nuk do të transmetonin kurrë raporte të tilla po ta kishin parë Muhamedin a.s. dhe kalifët pas tij duke i ngritur rregullisht duart gjatë namazit?

Po ashtu të gjitha transmetimet e Ibën Mesudit r.a., janë konsekuente në atë se duart duhen ngritur vetëm në fillim të namazit e jo edhe në pjesët tjera përbërëse të tij.

Në fund themi se Urve ibën Murre tregon: “Kur hyra në xhaminë e Hadrameutit, e dëgjova Alkame ibën Vailin duke transmetuar nga babai i tij se i Dërguari i Allahut a.s., i ngrite duart para dhe pas rukusë. Këtë gjë ia përmenda Ibrahim en Nehaiut (Zoti e mëshiroftë), i cili u përgjigj me hidhërim: A vetëm Vail ibën Huxhri e ka parë Pejgamberin a.s.? A nuk e paska parë atë edhe Abdullah ibën Mesudi r.a., dhe sahabët e tjerë?” (Muvetta Imam Muhamed, 92).

Përktheu: Daim Abazi



Qëllimet, përbërësit dhe sfidat e ligjërimit të xhumasë

PËRKUFIZIMI DHE FILOZOFIA E LEGJISLACIONIT

PËRKUFIZIMI

Predikimi është fjalim në prozë, në të cilin folësi i drejtohet një grupi njerëzish për t'i bindur. Në terminologji ka kuptimin e të folurit të përbërë, që përfshinë elokuencën dhe komunikimin në mënyrë specifike për sa i përket performancës, dialektit, zërit dhe lëvizjes. “Sa herë që i Dërguari i Zotit, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka mbajtur një hytbe, sytë e tij skuqeshin, zëri i tij ngrihej dhe zemërimi i tij bëhej i fortë, sikur të paralajmëronte një ushtri duke thënë: “Mirëmëngjesi dhe mirëmbërëma për ju.” (Transmetohet nga Muslimi).

FILOZOFIA

Filozofinë dhe urtësinë e legjislacionit në hytben e xhumasë e nxjerrim nga fjala e Zotit të Madhëruar: “O ju që besuat, kur të bëhet thirrja për namaz ditën e xhuma, atëherë vazhdoni te përmendja e Zotit dhe lëreni shitblerjen, e kur të përfundojë namazi, shpërndahuni në tokë dhe kërkonin nga dhuntitë e Allahut. Kujtojeni shumë Allahun që të keni sukses.” (El Xhuma, 9).

Hytbeja e xhumasë dhe predikimet e tjera nuk quhen hytbe, përveç se nëse në to do të tregohen çështje me rëndësi dhe domethënie të madhe ku do t'u lexohen me emër të pranishmëve. Për këtë arsye, Ibën Kajimi, në “Zaad el Mead”, ka thënë: “Predikimi i Profetit dhe predikimet e tij ishin vetëm një shpjegim i parimeve të fesë dhe asaj që Zoti ka përgatitur për njerëzit e bindjes së Tij në këtë botë dhe në

Ahiret. Ai i plotëson zemrat e tyre me predikimin e tij me besim, monoteizëm dhe njohje të Zotit të Tij.”

QËLLIMET E HYTBES SË XHUMASË:

Zbatimi i urdhrit të Zotit lidhur me këtë çështje;

Të kuptuarit kognitiv (njohës) në arsim dhe mësim (e gjithë shoqëria);

Përgjigja e sjelljes, e përfaqësuar nga aplikimi dhe vijimi;

Eksitimi pozitiv duke përhapur frymën e dialogut dhe diskutimit pa argument dhe debat.

Faktorët për suksesin e hytbes dhe të predikuesit:

Hytbeja duhet t'i plotësojë kushtet dhe shtyllat ligjore, shkencore dhe teknike;

Predikuesi duhet të jetë i njohur me mesazhin që po ua përcjell njerëzve. Kjo kërkon:

Referencat e transmetimit dhe hulumtim racional;

Konceptin gjithëpërfshirës të Islamit, pasi që nuk ka njohuri përpos të përgjithshmeve. Ebu Naimi ka transmetuar në “El Hilje” një hadith mbi autoritetin e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, në të cilin ai thotë: “Këtë fe nuk e ligjëron vetëm ai që ka njohuri në të gjitha aspektet e saj.” Pastaj vizioni i plotë i planit për predikimet në përgjithësi dhe predikimi aktual në veçanti.

Mjeshtëri në formë dhe përmbajtje, gjuhë, mendim dhe njohuri;

Mundësia për të ripërtërirë çështjen e fesë. Me këtë nënkuptoj ripërtëritjen e fesë së praktikuar që të jetë në përputhje me fenë e shpallur, dhe kjo kërkon përpjekje për të hequr risitë dhe atë që i bashkëngjitet fesë që nuk është pjesë



e saj dhe aktet dalluese të adhurimit nga zakonet, sepse Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Kushdo që fut në këtë çështje tonën diçka që nuk është pjesë e saj, ajo refuzohet*”;

ELOKUENCA NË TË FOLUR DHE KOMUNIKIMI I KUPTIMEVE DHE KONOTACIONEVE.

Predikuesi duhet të jetë i ditur për masën-xhematin që i drejtohet dhe në këtë kërkohet:

Njohuri të sociologjisë dhe psikologjisë dhe njohje të kushteve, nevojave dhe problemeve të audiencës, në mënyrë që t’u sigurojë atyre atë që i përshtatet dhe atë që duhet të dëgjojnë dhe të dinë për të përmirësuar kushtet e tyre;

Sjellja me të tjerët në bazë të nderit, respektit, njohjes dhe vullnetit për t’u njohur dhe bashkëpunuar.

Predikuesi duhet të jetë i guximshëm, ai nuk duhet t’u bëjë lajka njerëzve për ta fituar dashurinë e tyre në kurriz të mendimit, fesë dhe diturisë së tij dhe nuk duhet të jetë hipokrit ndaj pushtetarëve, duke humbur kështu këtë botë dhe Ahiretin, por të jetë i guximshëm edhe me veten e tij, duke pranuar gabimet nëse i bën ato dhe duke kërkuar nga njerëzit këshilla dhe korrigjim. Es Sidiku, Allahu qoftë i kënaqur me të, në hytben e kalifatit, ka thënë: “Unë jam caktuar mbi ju dhe nuk jam më i miri prej jush, nëse bëj mirë, më ndihmoni, e nëse bëj gabim, më korrigjoni.”

Miratimi i qëllimit të reformës, e kjo bëhet duke arritur drejtësinë dhe mëshirën, të cilat janë bazat e reformës. Drejtësi do të thotë dhënia e secilit atë që i takon, kurse mëshirë dhënia e diçkaje me dobi dhe butësi. Zoti i Plotfuqishëm tha: “*Dhe sukcesi im nuk varet prej asgjëje tjetër përveç prej Allahut. Tek Ai jam mbështetur dhe tek Ai kthehem.*” (Hud, 88).

SFIDAT E HYTBES SË XHUMASË:

Shqetësimet e shoqërisë dhe shqetësimet e vetë predikuesit;

Islami politik ose politizimi i Islamit dhe natyra e raportit me autoritetin politik;

Kaosi i termave të vjetra dhe moderne;
Nacionalizmi i munguar dhe i pranishëm;
Hytbe të gjata pa nevojë;
Zgjerim dhe shkurtim;
Imitimi dhe shmangie e krijimtarisë;
Përsëritja e hytbeve ndër vite;
Temat e rëndësishme dhe kriteret e rëndësisë.

Një dokument bashkëpunimi konstruktiv, i bazuar në një thirrje të vetëdijshme për Zotin: O predikues, oratorë, imamë dhe mësues, o predikuese, mësuese dhe predikuese femra, le të bashkohemi për të bashkëpunuar në mënyrë konstruktive me njëri-tjetrin për hir të një thirrjeje të ndërgjegjshme, serioze dhe të dobishme për Zotin, duke këshilluar njëri tjetrin dhe njëra-tjetrën për këto çështje:

Forcimi i sinqeritetit ndaj Zotit Fuqiptotë si pikënisje në thirrjen tonë, duke forcuar lidhjen me Të, nëpërmjet adhurimeve të ndryshme dhe të larmishme, ndër të cilat më kryesoret janë: namazi dhe leximi i Kuranit, veçanërisht gjatë kohës së para agimit dhe pas agimit.

Përkushtimi ndaj metodës shkencore në thirrjen drejt Zotit në aspektin e përmbytjes, që disiplinohet nga përkatësia e vërtetuar ndaj Kuranit famëlartë dhe Sunetit fisnik. Ne jemi urdhëruar që t’u drejtohem njerëzve sipas nivelit të të kuptuarit të tyre dhe t’u flasim atyre për atë që ata nuk e dinë.

Mbajtja e foltores dhe bankave të mësimdhënies nga të qenit zëdhënës për përhapjen e shpifjeve të një personi, shkrimtari ose grupi të caktuar. Detyra jote si ligjërues është të përgënjeshtrosh, të shqyrtosh dhe të studiosh idetë, jo të nënçmosh ose të ofendosh njerëzit.

Përqendrimi në pjesën më të madhe të kohës - përveç rasteve të veçanta - në çështje morale dhe sociale, sepse kriza është një krizë morale dhe kombet mbeten për aq kohë sa morali i tyre mbetet.

Le të jemi të etur për ta bërë veten një shembull të mirë për ata që i thërrasim dhe i mësojmë, duke qenë seriozë në zbatimin e mësimave të fesë sonë të vërtetë dhe duke përqaftuar moralin e Kuranit fisnik dhe moralin që mësuesi ynë, Muhamedi a.s., na e ka mësuar.

Fjalimi duhet të mbahet me një zë të përshtatshëm për temën, predikimin ose mësimin, dhe me një ton që merr parasysh natyrën e fjalisë së thënë, qoftë thirrëse, pyetje apo të ngjashme, me plot respekt e vlerësim për dëgjuesin dhe shikuesin dhe lutjet për të gjithë që atdheu të ruhet, të mbrohet dhe të kujdesemi për të.

Përktheu dhe përshtati:

Avdyl Rrahmani

Besimtari i denjë është atdhedashës

Lirisë më së miri
ia di vlerën i
burgosuri, kurse
vatanit më së
miri ia di vlerën
mërgimtari!

Në rruzullin tokësor ka shumë shtete të ndryshme, por vetëm njëra prej tyre është vatani ynë. Në këtë botë ka shtete të lashta, por vetëm një është shteti më ri në kontinentin tonë.

Meqë një kohë të gjatë, tri dekada e disa vite, kemi jetuar në mërgim, atëherë sa herë që vinim në pushim u thosha shokëve, miqve, madje edhe pjesëtarëve të familjes sime: “Lirisë më së miri ia di vlerën i burgosuri, kurse vatanit më së miri ia di vlerën mërgimtari!”

Nuk e di a thua këtë fjalë e kam lexuar dikur në gjuhën shqipe, boshnjake apo arabe, apo kjo fjalë është rezultat i përvojës dhe përjetimit tim. Megjithatë, sido që të jetë, besoj se lexuesi i nderuar do të

pajtohet me mendimin tim. Prandaj, këtë citat, të cilin filluat ta lexoni, mbaj shpresë se do ta lexoni deri në fund, që është mendim i zakonshëm, i një qytetari të zakonshëm, ku shfaq dashuri për vatanin, i cili më 17 shkurt do të kremtojë pavarësinë e tij. Njëherësh, të mos harroj se ky mendim është po ashtu i një besimtarit të zakonshëm për temën në fjalë.

Njëmend, qejfi nuk ma do, që në fjalorin tim me shkrim apo gojarisht ta përdorë fjalën “i zakonshëm”, jo për shkak se nuk e di saktësisht çdo të thotë ajo fjalë, por për shkak se nuk di çka do të thotë antonimi i asaj fjale “i jashtëzakonshëm”, sepse çdo gjë në botë ka pa ashtu antonimin e vet. Me bindje se lexuesi tani nxjerr në pah se çka është qytetari i zakonshëm dhe çka është besimtari i



zakonshëm i vatanit tonë, prandaj edhe nga ky pozicion do të vazhdoj me këtë shkrim modest.

Kështu, këtu me theks të veçantë do të fokusohem në vështrimin e besimtarit ndaj atdhedashurisë, si motiv nga përvoja ime e deritanishme me njerëz të zakonshëm, thuajse të të gjitha kontinenteve, ku shumica dërrmuese e tyre, ende sot e kësaj dite, i përmbahen parimeve fetare, që përputhen plotësisht me parimet kombëtare. Prandaj, unë shkruaj nga pozicioni përsëri i një myslimani të zakonshëm, gjegjësisht nga një njeri i përkatësisë islame, që është njëri nga tri religjionet e përbotshme monoteiste. Po, gjithsesi kështu përkrah dhe ndjej kënaqësi të madhe kur për atdhedashuri flasin edhe përkatësit e religjioneve të tjera në vatanin tonë shqiptar, madje edhe ata të cilët e konsiderojnë vetën si jobesimtarë apo agnosticistë.

Prandaj, çdokush që e konsideron veten besimtar, është i përcaktuar si besimtar-mysliman, e këtë nuk mund t'ia mohojë atij askush, pavarësisht nivelit të tjetrit. Ai si besimtar beson në Një, të Vetmin Zot, beson në parimet e fesë së tij, që plotësisht përputhen me parimet kombëtare. Ai beson në të gjithë të dërguarit pa kurrfarë dallimi, sikur që beson në të dërguarin Ibrahim, Musa, Isa dhe të dërguarin e fundit Muhamed, paqja, bekimi dhe shpëtimi qofshin mbi ta!

Andaj, besimtari i denjë është atdhedashës, meqë ai si shëmbëlltyrë i ka të gjithë të dërguarit e veçanërisht këta katër, të cilët i theksuam më parë, që po ashtu ishin atdhetarë të denjë. Kështu, besimtari beson se çdo që ndodh në planin tonë individual dhe kolektiv është vullnet i Krijuesit.

Kështu, vullneti i Tij është edhe jeta jonë. Prandaj ne nuk e krijuam veten që nga fetusi në barkun e nënës, e të mos shkojmë më larg. Po ashtu nuk e zgjodhëm se në cilin bark do të jemi, sikur që nuk e zgjodhëm hapësirën gjeografike dhe kohore, në të cilën do të lindim. Andaj, hapësira gjeografike në të cilën kemi lindur, kohën kur kemi lindur dhe kohën kur jetojmë është me (para)caktimin, vullnetin dhe urtësinë e Tij.

Dashuria ndaj vatanit është obligim i prerë nga këndvështrimi islam dhe veprim i parapëlqyer i Krijuesit, sepse atdhetari në këtë mënyrë pranon përcaktimin e Tij. Nuk duhet harruar se dashuria ndaj vatanit është natyrë e lindur e njeriut.

Ai dëshiroi, që ne si krijesa të Tij të jemi pikërisht në këtë vend e në këtë tokë prej këtij globi si dhe pikërisht në këtë kohë. Ai na dhuroi këtë vatan, andaj ne e falënderojmë dhe e madhërojmë Krijuesin e gjithësisë, që në këtë mënyrë konfirmojmë se jemi mëkëmbës të kësaj toke. Në këtë mënyrë e kemi obligim ta respektojmë tërë krijimtarinë e Tij, si botën e dukshme, po ashtu edhe atë të padukshme. Kështu, në tokën ku jemi lindur, Kosovën e dashur, e përqafojmë dhe e pranojmë para së gjithash, si përcaktim, mëshirë, urtësi hyjnore dhe dhuratë e Zotit. Po ashtu me vetëdije e pranojmë këtë epokë d.m.th. shekulli XXI, si kohë jona që jemi krijimtari e papërsëritshme dhe mëkëmbës në këtë tokë. Prandaj, siç thashë më parë, është obligim që ta respektojmë thellë Krijuesin dhe tërë krijimtarinë e Tij të llojllojshme në këtë gjithësi deri në kalim nga kjo botë kalimtare në botën e përtejme.

DASHURIA NDAJ VATANIT ËSHTË PJESË E PANDASHME E IMANIT

Vatan është fjalë e gurrës arabe, por meqë shekuj me radhë kjo fjalë ekziston në fjalorin tonë, prandaj ne të gjithë e kuptojmë domethënien e saj. Po ashtu edhe fjala iman është fjalë e gjuhës arabe, që s'do mend të gjithë e dimë kuptimin e saj. Kështu fjalja: "Dashuria ndaj vatanit është pjesë e pandashme e imanit", është shprehje dhe rezultat i dijetarëve myslimanë, që në këtë rast, si respekt ndaj tyre do ta shkruaj siç ata janë shprehur: (حب الوطن من الإيمان). Kam përshtypje se këto dy fjalë kur kanë hyrë në leksikun tonë, kanë hyrë bashkërisht të pandashme, prandaj të mos i ndajmë edhe ne, sepse delen e vetme e ha ujku. Dashuria ndaj vatanit është obligim i prerë nga këndvështrimi islam dhe veprim i parapëlqyer i Krijuesit, sepse atdhetari në këtë mënyrë pranon përcaktimin e Tij. Nuk duhet harruar se dashuria ndaj vatanit është natyrë e lindur e njeriut.

Nuk ka dyshim se besimtari i denjë e do vatanin e tij, ai po ashtu e do tërë këtë botë, sepse ai e ka kultivuar zemrën e tij vetëm me dashuri, që s'ka vend për urrejtje ndaj askujt. Myslimani, shëmbëlltyrën e tij e kërkon në mirësjelljen e Muhamedit, paqja, bekimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, sepse ai, siç

e dimë e ka dashur shumë vatanin e tij, e ka dashur Mekën, në të cilën ka lindur, po ashtu e ka dashur edhe Medinën, e cila i ofroi strehim për misionin e tij. Kështu, ne duke treguar dashuri ndaj vatanit tonë, ne në ndërkohë ndjekim traditën e të dërguarit Muhamed, paqja, bekimi dhe shpëtimi qofshin mbi të. Nuk duhet harruar këtë se Muhamedi a.s. me rastin e çlirimit të Mekës, për dashuri ndaj vatanit nuk i ndëshkoi ish-bashkëqytetarët e tij, por ju tha: “Shkoni, jeni të lirë!”. Ndërsa në hytbenë e lamtumirës, pos të tjerash tha: “Njeriu është krijimtari e Zotit, mallkuar qoftë ai që e shkatërron atë!”

Dashuria ekstreme është dashuria e verbër dhe anasjelltas. Dashuria është vepër e Krijuesit, të cilën Ai e krijoj si pjesë e mëshirës së pakufishme, që ia dhuroi njerëzve. Mirëpo, ne sot në vendin tonë, shpeshherë dashurinë ndaj vatanit e shprehim në mënyrë të gabueshme. Këtu do t'i theksojmë vetëm dy nga disa të tjera, duke mos hyrë në shpjegim detal. Njëra nga to është konsiderimi se urrejtja ndaj ndryshueshmërisë konsolidon dashurinë ndaj njëjtësisë dhe vatanit, kurse tjetra është identifikimi i dashurisë ndaj vatanit me ndonjë parti politike. Kështu të tillët harrojnë se vatani ynë është më i lashtë sesa regjimet politike njëra pas tjetrës.

Më parë, siç e dimë regjimi monarkik, pastaj regjimi komunist me një partishmëri, kurse tani demokracia që solli regjimin e shumëpartishmërisë. Këtu në këtë kontekst do ta citoj fjalën e historianit dhe letrarit libanez Shekib Arslanit (1869-1946), i cili thotë: “Atdhetari mendon për brezat e ardhshëm, ndërsa politikanin mendon vetëm për zgjedhjet e ardhshme.”

Në vijim do të theksoj kush s'janë vatandashësit e politikës aktuale: Në grupin e parë, janë ata të cilët e kanë dashur vatanin gjatë luftës, por tani shikojnë interesin personal. Këtij grupi i bashkëngjiten edhe disa a shumë ndërkombëtarë. Në grupin e dytë, janë ata të cilët nuk e kanë dashur dhe as që e duan vatanin, por shikojnë vetëm interesin personal, sepse të tillët kanë zhvatur edhe në sistemin komunist, pa përmendur emrat e tyre. Në grupin e tretë, janë ata të cilët e kanë dashur dhe e duan vatanin. Këtu fatmirësisht janë të gjithë qytetarët e zakonshëm të vatanit.

Mirëpo, të mos harrojmë, se edhe në mesin e klerikëve, por ka pak të tillë që s'janë atdhedashës 100%.

Andaj, këta mund t'i ndajmë në dy kategori: Në kategorinë e parë, bëjnë pjesë disa injorantë, të cilët kanë lexuar pak nga Islami, e pretendojnë se dine gjithçka. Të tillët janë injorantë, ndonëse thirren në Islam. Ata manipulojnë me masën dhe fenë e monopolizojnë. Në kategorinë e dytë, bëjnë pjesë disa tullacë finokë vendorë a ndërkombëtarë, që kanë hapur qendra për konvertimin e qytetarëve të zakonshëm, duke shfrytëzuar gjendjen ekonomike të vështirë në vatanin tonë. Prandaj, këta si të tillë krijojnë të vetëquajtur lëvizje, në emër të qytetit të Kosovës, por rrënjët e saj janë jashtë saj. Prandaj, ata në këtë mënyrë dëshirojnë ta destabilizojnë vatanin tonë duke krijuar taraf, për të sjellë ujkun në kope. Kështu



përfundojmë këtë elaborim modest lidhur me politikanët dhe klerikët me fjalë e të madhit Shemsudin bej Sami Frashëri: “Mendimet e larta gjenden në fjalë të shkurtra”.

SI TA DUAM VATANIN?

Në fillim thamë se këtë që lexoni është vështrim i një qytetari të zakonshëm, po ashtu i një besimtarit të zakonshëm ndaj vatanit. Prandaj, çdo njëri prej nesh që e konsideron veten të zakonshëm, ai me vepra modeste mund të bëjë vepra të jashtëzakonshme për vatan, kështu në këtë mënyrë shfaq dhe realizon dashurinë e vet ndaj tij. Prandaj, për të vazhduar këtë rrugëtim, më së pari që mund të ballafaqohemi është shtëpia a oborri ynë. Andaj, çdo kush që pastron para shtëpisë së tij, atëherë pastrohet e tërë mëhalla. E, nëse pastrohet çdo lagje, atëherë është i pastër i tërë qyteti. Në qoftë se pastrohen të gjitha qytetet, atëherë i tërë vatani ynë është pastër. Meqë ra fjala për pastërtinë, atëherë duhet kushtuar kujdes të veçantë të gjithë vatandashësit nga hedhja e plehrave në vatanin tonë. Dikur kishim të pastër thuajse çdo lumë brenda në fshat a qytet, ndërsa tani gati çdo gjë është e ndotur. Më kujtohet fort mirë, atëbotë kur ishim të vegjël nga ura e lumit Krena i shihnim peshqit, kurse sot, siç thuhet në zhargonin popullor, nuk gjendet asnjë peshk as për ilaç. Po kjo ka të bëjë edhe me lumenjtë e tjerë.

Dashurinë ndaj vatanit në këtë krizë ekonomike mund ta shfaqim po ashtu edhe me blerjen e prodhimeve vendore në dyqanet tona. Të mos bëhemi si ndonjë politikan, që trumbeton për prodhimet vendore, ndërsa pikërisht ai është që në shtëpi të vet sjell prodhim të huaj! Të tillët janë llafazanë, që hanë bukën e tyre, por rrahin thekrën e botës. Prandaj, vatani kërkon shërbim dhe sakrificë, e kurrësi fjalë boshe. Më në fund e përfundojmë këtë artikull me fjalën e urtë: “Vatani kur mbrohet nga “vatandashësit”, atëherë ai është i pathyeshëm.” Megjithatë, më shpresë së në të ardhmen e afërt do të kremtojmë në vatanin e natyrshëm, me të gjitha trojet e tij, vetëm deri aty ku bukës i thonë bukë dhe ujit i thonë ujë.

Perspektivat kuranore të dialogut ndërfaqet

Në një periudhë ku ndarjet fetare mund të sjellin konflikte dhe tensione, dialogu ndërfaqet është një mjet efektiv për të ndërtuar marrëdhënie të mira dhe bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve fetare. Për ta kuptuar këtë fenomen në një nivel më thellë, ky studim përqendrohet në perspektivën kuranore të dialogut ndërfaqet.

Në një botë të ndryshueshme siç është bota jonë, dialogu ndërfaqet shihet si një rrugë e nevojshme drejt mirëkuptimit, bashkëjetesës dhe paqes së qëndrueshme. Ndërthurja e kulturave, besimeve dhe praktikave fetare e bën të nevojshme një qasje të hapur dhe dialoguese për të kuptuar, respektuar dhe ndërtuar lidhje të forta ndërmjet komuniteteve fetare. Në këtë kontekst, perspektiva kuranore përfaqëson një dimension të rëndësishëm të dialogut ndërfaqet, duke sjellë kontributin e Kuranit dhe mësimet e tij në ndërtimin e një mjedisi të harmonishëm fetar.

Për ta vlerësuar një fe, një sistem apo shoqëri se sa është paqësore dhe tolerante, është e domosdoshme të analizohen dhe të shikohen dispozitat dhe ligjet e asaj feje apo të atij sistemi, si dhe historia e zhvillimit të asaj shoqërie. Sa më fisnike dhe bujare të jenë dispozitat e një feje, aq më paqësore dhe më tolerante do të jetë ajo fe dhe aq më të mëdha do të jenë predispozitat e saj për t'u bërë fe universale. Nëse i analizojmë dhe i zbërthejmë mirë burimet kryesore të fesë islame, Kurantin

Kurani gjithmonë inkurajon njerëzimin që të njohin dhe të respektojnë njëri-tjetrin pavarësisht nga fiset, kombet dhe fetë e tyre.

dhe Sunetin e të Dërguarit a.s., do të shohim se që të dyja këto burime, me normat dhe rregullat e tyre, në mënyrë reale trajtojnë çështjen e tolerancës, barazisë dhe të bashkëjetesës ndërmjet besimtarëve me përkatësi të ndryshme fetare dhe kombëtare.¹

Kurani është ndoshta i vetmi shkrim i shenjtë që ka folur shumë pozitivisht për fetë e tjera dhe pejgamberët e tyre. Kurani gjithmonë inkurajon njerëzimin që të njohin dhe të respektojnë njëri-tjetrin pavarësisht nga fiset, kombet dhe fetë e tyre. Thelbi i dialogut është mençuria dhe fjalët e bukura, të cilat përshkruhen në mënyrë eksplicite në Kuran.²

Duke përsiatur mbi vargje të ndryshme kuranore, vërehet se Kurani famëlartë e paraqet dialogun si një karakter të dallueshëm të qenies njerëzore, pasi thekson se njeriu është krijuar nga Allahu i Madhëruar për t'i përballuar të gjitha llojet e konflikteve vazhdimisht në jetën e tij.³

Në Kuran janë përmendur terma të ndryshme sa i përket konceptit të dialogut, si:

Hivar – i njohur si bashkëbisedim: *“Dhe i tha shokut të vet, derisa po bisedonte me të.”* (El Kehf, 34);

Ta'arafu – njohje, mirëkuptim dhe ndërtim i marrëdhënieve: *“O njerëz, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin...”* (El Huxhurat, 13);



Muxhadeleh – çdo përpjekje për të konvertuar të tjerët: “Dhe me ithtarët e Librit diskutoni në mënyrë më të mirë...” (El Ankebut, 46);

Ta'awun – bashkëpunim, ndihmë ndaj njëri-tjetrit: “Ndihmoheni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri...” (El Maide, 2).

Konteksti kuranor i dialogut ndërfaqetar i referohet pjesëve kuranore që diskutojnë vlerën e komunikimit dhe mirëkuptimit ndërmjet njerëzve të besimeve të ndryshme. Këto vargje theksojnë besimin në një Zot, vlerën e moralit dhe nevojën për drejtësi shoqërore të përbashkët nga të gjitha fetë. Ai i nxit myslimanët të bisedojnë me pasuesit e feve të tjera për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të thelluar mirëkuptimin e tyre.⁴

Dialogu ndërfaqetar, jo vetëm që është i dëshirueshëm për myslimanët, por është proces i domosdoshëm. Procesi i dialogut ndërfaqetar nuk do të thotë njëkohësisht proces i kristianizimit, katolicizmit, ortodoksizimit, judaizmit, evangjelizmit, respektivisht nuk është asimilim i myslimanëve në ndonjë nga këto grupime apo sekte religjioze, por është proces që ka disa funksione:

1. Është komunikim popujsh kulturash e traditash, dhe;
2. Është pikëpamje e thirrjes së myslimanit në rrugën e drejtë dhe përmbushje e detyrës së shenjtë duke komunikuar me të tjerët.⁵

Për të nxitur paqen, harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfaqetare për të mirën më të madhe të shoqërisë, Islami aspiron ta bëjë botën një vend paqësor për të jetuar, jo vetëm për njerëzit e një besimi, por edhe për njerëzit e të gjitha besimeve dhe kulturave.

Diversiteti është një rregull natyror, nuk është diçka e krijuar nga njeriu, përkundrazi, Allahu i Plotfuqishëm krijoi diversitetin për të mirën tonë. Pra, diversiteti është vullneti i Allahut dhe shërben si një provë për ne që të jetojmë në paqe dhe harmoni, pavarësisht dallimeve tona.

Për të nxitur paqen, harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfaqetare për të mirën më të madhe të shoqërisë, Islami aspiron ta bëjë botën një vend paqësor për të jetuar, jo vetëm për njerëzit e një besimi, por edhe për njerëzit e të gjitha besimeve dhe kulturave. Ai udhëzon adhuruesit e tij që të trajtojnë të gjithë qytetarët sipas parimeve të drejtësisë sociale.⁶

Po ashtu, mësimet islame na mësojnë që gjatë zhvillimit të debateve e polemikave të ndryshme të reflektojmë dhe të rrezatojmë pjekuri e mos të shfaqim ndjenja zemërimi e hidhërimi. Në Kuran thuhet: “...dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.” (En Nahl, 125).

Myslimanët e frymëzuar nga morali islam, përdorin fjalë të bukura, largohen nga fjalori arrogant dhe çdo mendimi i kushtojnë rëndësi dhe kujdes të posaçëm.⁷

Pesë apo gjashtë vjet pas shpalljes, kur pozita e bashkësisë së vogël myslimane në Mekë, e cila nuk i numëronte as njëqind besimtarë, u bë e padurueshme, myslimanët përsëri u dërguan te të krishterët. Pejgamberi a.s. vendosi që ithtarët e tij më të dobët, të cilët nuk mund t'i mbronte nga torturat e bashkëkombësve të tij, t'i dërgojë në Abisini, respektivisht në Etiopi. Duke i dërguar në një rrugë të gjatë dhe të pasigurt, atyre u tha: “Nëse shkoni në tokën e abisinasve, atje do të gjeni një mbret, i cili askujt nuk i bën padrejtësi. Ai është vendi i të sinqeritetit.” Bashkëpunimi myslimano-kristian, i cili filloi me dërgimin e gjashtëmbëdhjetë myslimanëve të hershëm ka zgjatur afër një mijë vjet. Çlirimtarët myslimanë, rregullisht kanë kapërcyer Etiopinë dhe nga të krishterët e atjeshëm nuk kanë kërkuar pagesën e taksave të zakonshme (xhizje) ndaj shtetit mysliman.⁸

Diskutim tjetër krishtero-mysliman ndodhi mes Pejgamberit a.s. dhe të krishterëve të Nexhranit, distrikti i krishterë në Jemen. Ky debat është aluduar në Kuran, në ajetin që



fton delegacionin e krishterë në *mubalah* – thirrja e mallkimit të Allahut.⁹

Këtu nuk na shqetëson pyetja nëse kjo ngjarje e *mubalah* ka ndodhur apo jo. Mjafton të vërehet se njerëzit e Nexhranit zgjodhën me maturi paqen, megjithëse me një çmim, në vend që të pranonin sfidën e hyrjes në *mubalah* me pasojat e saj fetare, politike dhe ushtarake.¹⁰ Me rëndësi më të madhe, për qëllimin tonë, është fakti se ajeti në lidhje me këtë debat përfundon me thirrjen e mëposhtme pajtuese drejtuar ithtarëve të Librit: “*Thuaj: “O ithtarë të Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët edhe për ne edhe për ju; që të mos adhurojmë tjetër përveç Allahut, asnjë send të mos ia bëjmë shok dhe mos trajtojmë njëri-tjetrin si zota në vend të Allahut. E nëse ata kthejnë kryet anash, thoni: “Dëshmojeni se ne njëmend jemi myslimanë!”*” (Ali Imran, 64).

Kur Pejgamberi a.s. po përgatitej për hixhretin në Medinë, e dinte se kishte edhe një obligim ndaj atyre që kishin besim tek ai dhe që ia kishin dorëzuar atij amanetet. Pas tij e la djalnin e xhaxhait të tij, Aliun, që t’i kthente gjërat e besuara te pronarët e tyre. Mesazhi i këtij veprimi është shumë i qartë, e drejta e pronës është e shenjtë, fjala qoftë edhe për njerëzit e një feje tjetër dhe armiq të mundshëm.¹¹

Allahu ka dërguar ligjvënës për çdo popull dhe kishte ligje të ndryshme për popuj të ndryshëm: “Çdo popull ka pasur një profet.” (Junus, 47).

Kurani gjithashtu na mëson se vërtetësia e mesazhit të çdo profeti gëzon të njëjtin status. Barazia e mesazheve të të gjithë profetëve përkufizohet në ajetin: “*Thuaj: “Ne i besojmë Allahut edhe asaj që na shpallet neve, edhe asaj që i ka ardhur Ibrahimit, dhe Ismailit, dhe Ishakut, edhe Jakubit edhe nipërve. Edhe asaj që iu dha Musait dhe Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre, ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre, dhe ne vetëm atij i dorëzohemi.”*” (Ali Imran, 84).

Qëndrimi i Pejgamberit a.s. si sundimtar i Medinës është një shembull i qartë i paqes, solidaritetit dhe harmonisë

ndërfetare. Pejgamberi a.s. bëri një kushtetutë për shtetin e Medinës pasi diskutoi me banorët e tij që ishin myslimanë, hebrenj, të krishterë, politeistë dhe të tjerë që nuk i përkasin asnjë feje. Karta e Medinës ishte, në të vërtetë, kushtetuta e parë e shkruar dhe moderne e botës. Karta hodhi themelet e një politike pluraliste dhe tolerante në Medinë. Në shoqërinë dhe politikën pluraliste të Medinës, Pejgamberi a.s. dha një shembull empirik se si duhej të sillen myslimanët me njerëzit e besimeve të tjera.¹²

Karta e Medinës e dhënë nga Profeti a.s., shprehimisht përmend se njerëzit, që u përkasin feve të ndryshme do të gjykoreshin në bazë të traditave të tyre. Sipas kësaj karte, jomyslimanët kanë të drejta të barabarta për t’u gjykuar nga fetë e tyre, ashtu sikur myslimanët në traditën islame.¹³

Si përfundim, shohim se Islami është fe e paqes dhe mirëkuptimit, fe e cila i pranon fetë e tjera që ishin shpallur para shpalljes së Kuranit, po ashtu na urdhëron të bëjmë dialog, veçse ky duhet të zhvillohet në mënyrën më të mirë, duke i përdorur metodat më të mira.¹⁴

- 1 <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=7061> (parë për herë të fundit: 10/03/2024).
- 2 Al Masud, Abdullah, and Mohammad Elius. “The Qur’anic view of interreligious dialogue and harmony.” *International Journal of Recent Research in Social Sciences and Humanities* 3, no. 1 (2016): 18-21.
- 3 Nawaz, Muhammad, Abdul Aleem, and Naseem Mahmood. “Interfaith Dialogue from the Perspective of Quran and Sunnah: A Solution for Peacemaking & Interfaith Harmony in Pakistan.” *Al-Qamar* (2022): 19-32.
- 4 Akhter, Naseem, Sajid ur Rahman, Ms Irsa Aziz, Ms Saba Rauf, and Shumaila Rafiq. “QURANIC CONTEXT AND INTERFAITH DIALOGUE (BUILDING MUTUAL UNDERSTANDING AND ACCEPTANCE IN A PLURALISTIC SOCIETY).” *PalArch’s Journal of Archaeology of Egypt/Egyptology* 20, no. 2 (2023): 1090-1102.
- 5 Qemajl Morina, (Dialogu ndërfetar në Kosovë), *Edukata Islame* nr. 111, fq. 8.
- 6 Aadil Hussain Wagay; “Interfaith dialogue; Quranic perspective”, Research Scholar, Islamic University of Science and Technology, India, Volumi 4.
- 7 Taha Xhabir el Ulvani, “*Kultura e dialogut në Islam*”, (Logos-A, Shkup 2000), fq. 51.
- 8 https://www.uais.ch/new1/files/Dialogu_midis_feve_te_shpallura.pdf
- 9 Mubalahah ishte një zakon i vjetër arab në të cilin dy palë që bënin pretendime kontradiktore, luteshin me një betim që mallkimi i Allahut të ishte mbi gënjeshtarët e secilës palë.
- 10 Mitwally Ibrahim, Mohammad Said. “INTERFAITH DIALOGUE A MUSLIM LEGAL PERSPECTIVE ON ITS VALIDITY, CONCEPT AND PRACTICES.” *Insights* (20724586) 3, no. 1 (2010).
- 11 https://www.uais.ch/new1/files/Dialogu_midis_feve_te_shpallura.pdf
- 12 Abdullah Al-Masud, and Mohammad Elius. “The Qur’anic view of interreligious dialogue and harmony.” *International Journal of Recent Research in Social Sciences and Humanities* 3, no. 1 (2016): 18-21.
- 13 Ibid.
- 14 Jusuf Kardavi, “Detyrat parësore të lëvizjes islame në periudhën e ardhme”, *Furkan ISM*, Shkup, 2000, fq. 216.

Identiteti, sfidat dhe veprimi i grave myslimane në Evropë

Kur diskutojmë për gratë myslimane në Evropë, është e rëndësishme të kemi parasysh kompleksitetin e këtyre fjalëve. Edhe pse duken të thjeshta si fjalë, ato mbartin kuptime dhe përvoja të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të shmangim përgjithësimet.

Për të qenë sa më të qartë, gratë myslimane janë ato që e identifikojnë veten si të tilla. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të gjitha e praktikojnë fenë në të njëjtën mënyrë. Thjesht të lindësh në një familje myslimane nuk barazohet automatikisht me të qenit një myslimane praktikuere. Shumë individë mund të identifikohen si kulturalisht myslimanë, duke njohur trashëgiminë e tyre dhe lidhjet familjare me Islamin pa iu përmbajtur domosdoshmërisht parimeve ose praktikave të tij fetare. Ata mund ta shohin Islamin si një pjesë të rëndësishme të sfondit dhe identitetit të tyre kulturor, por jo si një forcë udhëzuese në jetën e tyre të përditshme.

Është e rëndësishme të kuptojmë se këto gra kanë të drejtë të zgjedhin vetë se çfarë do të thotë të jesh myslimane. Ato kanë mendime, përvoja dhe zëra të ndryshëm. Ato janë aktive

Ato lundrojnë në kompleksitetin e besimit dhe të jetës së tyre me qëllim dhe vetëdije, duke bërë zgjedhje të vetëdijshme për praktikën dhe besimet e tyre.

në përcaktimin e narrativeve të tyre dhe nuk janë thjesht marrëse pasive të interpretimeve të jashtme. Ato lundrojnë në kompleksitetin e besimit dhe të jetës së tyre me qëllim dhe vetëdije, duke bërë zgjedhje të vetëdijshme për praktikën dhe besimet e tyre.

Kur merren parasysh përvojat e grave myslimane, përcaktimi i Evropës kërkon një qasje të shumanshme, që shtrihet përtej gjeografisë së thjeshtë. Evropa duhet të kuptohet si një koleksion i shteteve-kombeve të ndryshme, secili me historinë e vet unike, sistemin politik dhe qasjen për menaxhimin e diversitetit fetar dhe kulturor. Për më tepër, Evropa nuk është statike, por vazhdimisht në zhvillim. Zgjerimi i BE-së dhe migrimi në rritje kanë nxitur një popullsi myslimane në rritje, duke ndezur debate rreth identitetit kombëtar, integritit dhe përkufizimit të evropianitetit. Këto debate shpesh rrotullohen rreth shprehjes fetare dhe dallimeve kulturore, duke ndikuar drejtpërdrejt në klimën socio-politike për gratë myslimane. Për më tepër, historia e Evropës është e ndërthurur thellë me Islamin, nga prania historike myslimane në Gadishullin Iberik dhe Ballkan e deri te migrimi më i fundit post-kolonial. Kjo histori

e përbashkët, e shënuar nga konflikti dhe bashkëjetesa, vazhdon të ndikojë qëndrimet bashkëkohore ndaj myslimanëve. Evropa përfaqëson një ideal, duke mishëruar vlera të tilla si demokracia dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, zbatimi i këtyre vlerave ndaj popullsisë myslimane, veçanërisht grave myslimane, nuk ka qenë gjithmonë i njëtrajtshëm. Shpeshherë, kjo ka çuar në debate rreth lirive individuale dhe normave shoqërore. Prandaj, për të kuptuar sfidat me të cilat përballen gratë myslimane në Evropë, është e nevojshme të pranojmë ndërveprimin kompleks të disa faktorëve. Këta faktorë përfshijnë kontekstet e ndryshme kombëtare, ndryshimet demografike, trashëgiminë historike dhe zbatimin, i cili jo gjithmonë është në përputhje me vlerat evropiane.

IDENTITETET HETEROGJENE TË GRAVE MYSLIMANE NË EVROPË

Portretizimi i grave myslimane në Evropë është karakterizuar shpesh nga një homogjenitet i thjeshtë, duke reduktuar ato në një tregim të veçantë të shtypjes dhe viktimizimit. Kjo fsheh realitetet kompleks të jetës së tyre dhe krijon një imazh monolit të gruas myslimane si një viktimë pasive e nënshtrimit patriarkal dhe fetar. Për të kaluar përtej këtyre paraqitjeve reduktuese dhe për të kuptuar heterogjenitetin e përvojave të grave myslimane, duhet të përdorim një qasje ndërsektoriale e krijuar nga Kimberlé Crenshaw. Ndërsektorialiteti parashtrohet se kategori të ndryshme shoqërore si gjinia, raca, feja, klasa dhe kombësia ndërthuren për të krijuar sfida unike për secilën grua. Kjo qasje na ndihmon të shohim një pamje më të plotë dhe të saktë të jetës së tyre, duke treguar forcën dhe qëndrueshmërinë e tyre përballë këtyre sfidave.

Një nga tendencat homogjenizuese më të përhapura është ngatërrimi i myslimanit me një identitet të vetëm etnik apo racor, duke e lidhur atë me origjinën arabe ose të Azisë Jugore. Kjo anashkalon praninë e rëndësishme të myslimanëve vendas në Evropë, veçanërisht në Ballkan, dhe numrin në rritje të të konvertuarve nga prejardhje të ndryshme evropiane. Për më tepër, ai errëson diversitetin brenda komuniteteve myslimane emigrante, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë etnish, gjuhësh dhe praktikash kulturore. Nëse shikojmë më me kujdes, mund të shohim se si një grua myslimane shqiptare, për shembull, jeton në një realitet krejt të ndryshëm nga një grua myslimane marokene në Francë, apo një grua myslimane turke në Gjermani. Përvojat e tyre formohen jo vetëm nga identiteti i tyre i përbashkët fetar, por edhe nga prejardhja e tyre specifike kombëtare, etnike dhe gjuhësore, si dhe nga historia dhe politika ku ato jetojnë.

Për më tepër, në diskursin dominues rreth grave myslimane e paraqesin Islamit si faktorin kryesor që e përcakton jetën e tyre, duke anashkaluar faktorë të tjerë të rëndësishëm



shoqërorë. Kjo çon në një interpretim të gabuar të identitetit të tyre, duke i lidhur të gjitha aspektet e jetës së tyre vetëm me fenë. Megjithatë, një qasje ndërsektoriale zbulon se si klasa, për shembull, i ndikon në jetën e grave myslimane. Një grua myslimane pakistaneze e klasës punëtore në Britani mund të përballë me diskriminim të dyfishtë, si racor, ashtu edhe ekonomik. Ajo mund të ketë vështirësi në punësim, strehim dhe akses në shërbime sociale, ndryshe nga një grua myslimane turke nga klasa e mesme. Në mënyrë të ngjashme, arritja arsimore, statusi i migrimit dhe mosha kontribuojnë në heterogjenitetin e përvojave, duke krijuar një larmi sfidash dhe mundësish që nuk mund të reduktohen vetëm në fenë e tyre.

Pikëpamja e homogjenizuar shpesh i portretizon gratë myslimane si të shtypura universalisht nga normat patriarkale islame, duke anashkaluar lirinë e tyre dhe rezistencën brenda komuniteteve të tyre dhe shoqërive më të gjera. Megjithatë, një kuptim i ndërlikuar zbulon mënyrat e ndryshme në të cilat gratë myslimane negociojnë identitetet e tyre dhe sfidojnë strukturat shtypëse. Ato janë të angazhuara dhe marrin pjesë në procese politike, kontribuojnë në jetën intelektuale dhe kulturore dhe krijojnë hapësira fuqizimi brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre. Për shembull, një aktiviste e re myslimane holandeze, për shembull, mund të sfidojë islamofobinë në shoqërinë e gjerë dhe normat patriarkale brenda komunitetit të saj, duke treguar se si identitetet e saj të shumëfishta e frymëzojnë aktivizimin e saj. Të injorosh këto akte të agjencisë, do të thotë të përjetosh një narrativë viktimizimi, por edhe të mos njohësh natyrën dinamike dhe në zhvillim të identiteteve të grave myslimane në Evropë.

SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLLEN GRATË MYSLIMANE NË EVROPË

Një nga sfidat më të spikatura me të cilat përballen gratë myslimane në Evropë është përhapja e islamofobisë dhe diskriminimit. Kjo manifestohet në forma të ndryshme, duke

filluar nga mikroagresionet në jetën e përditshme deri te barrierat sistematike në punësim, arsim dhe strehim. Portretizimet mediatike shpesh përjetësojnë stereotipa negative të myslimanëve, duke përforcuar paragjykimet që i konsiderojnë gratë myslimane ose si viktimat të shtypura ose si kërcënime sigurie. Diskursi i “luftës kundër terrorit”, i shoqëruar me rritjen e lëvizjeve populiste të krahut të djathtë në të gjithë Evropën, ka përkeqësuar më tej ndjenjën antimyslimane, duke krijuar një klimë frike dhe dyshimi. Kjo është veçanërisht e vërtetë për gratë që zgjedhin veshjen fetare si shamia, të cilat shpesh perceptohen gabimisht si një shenjë e prapambetjes, shtypjes apo edhe mbështetjes për ekstremizmin. Rrjedhimisht, këto gra mund të përjetojnë nivele të larta të diskriminimit, duke u përballur me përjashtimin nga puna, izolim social dhe madje edhe sulme verbale ose fizike. Debati rreth shamisë dhe formave të tjera të veshjes fetare nxjerr një tension themelor midis sekularizmit, shpesh i përshtatur si një vlerë evropiane, dhe të drejtës për liri dhe shprehje fetare. Kufizimet ligjore për veshjet fetare në hapësirat publike, të zbatuara në disa vende evropiane, marginalizojnë më tej gratë myslimane dhe kufizojnë mundësitë e tyre.

Gratë myslimane shpesh përballen me presionin për t'u përshtatur me përkufizimet e ngushta të identitetit mysliman dhe evropian. Ata janë kapur mes dy botëve, duke u përballur me pritjet e komuniteteve të tyre për të ruajtur vlerat dhe normat tradicionale, si dhe me presionin e shoqërisë për t'u asimiluar në një mënyrë jetese “evropiane”. Kjo mund të krijojë një ndjenjë tjetërsimi dhe të kontribuojë në krizat e identitetit, veçanërisht për brezat e rinj, që përpiqen të gjejnë veten në kompleksitetin e të qenit bikulturore. Ndërsa Evropa ka ndryshuar mënyrën se si e përcakton përkatësinë, kulturalizimi i qytetarisë është bërë një mjet i rëndësishëm. I shtyrë nga ankthet që rrethojnë dukshmërinë në rritje të myslimanëve, ky ndryshim largohet nga përcaktimi i integritetit nëpërmjet pjesëmarrjes shoqërore dhe në vend të kësaj thekson asimilimin në normat kulturore dominuese evropiane. Modele të ndryshme të sekularizmit në të gjithë kontinentin luajnë një rol në këtë fenomen. Ndarja e rreptë midis fesë dhe jetës publike në Francë bie në kontrast me qasjen më neutrale të vendeve si Gjermania dhe Holanda, megjithatë kjo e fundit shpesh në mënyrë implicite ka favorizuar krishterimin. Sot, shqetësimi në këto vende është më pak për fenë në jetën publike në përgjithësi, dhe më shumë për praninë e Islamit si një fe “e huaj”. Në këtë kontekst, gratë myslimane, veçanërisht ato që shprehin hapur besimin e tyre, janë bërë figura simbolike. Trupat dhe zgjedhjet e tyre shpesh interpretohen si një refuzim për t'u integruar dhe shihen si dëshmi e një konflikti thelbësor midis vlerave islame dhe evropiane. Ky konflikt thelbësor, i ushqyer si nga e djathta, ashtu edhe nga disa aktorë të së majtës, e ndan

popullsinë myslimane në dy grupe: ata që konsiderohen të pranueshëm për shkak të sekularizmit dhe asimilimit të tyre, dhe ata që konsiderohen të papranueshëm për shkak të besimit të tyre dhe lidhjes me një komunitet global mysliman.

Një nga sfidat më komplekse me të cilat përballen gratë myslimane është diskriminimi i shumëfishtë. Ato shpesh përballen me diskriminim të bazuar në fe, gjini, origjinë etnike dhe status social-ekonomik. Për shembull, një grua myslimane me ngjyrë mund të përballë jo vetëm me islamofobi, por edhe me racizëm dhe seksizëm, duke krijuar kështu një sërë disavantazhesh. Ky diskriminim i shumëfishtë e bën shumë të vështirë akçesin në mbështetje dhe drejtësi, pasi institucionet shpesh nuk janë të përgatitura për t'iu përgjigjur nevojave specifike të individëve, që përballen me forma të shumta diskriminimi. Mungesa e të dhënave të detajuara e vështirëson edhe më shumë kuptimin e përvojave specifike të grave myslimane, duke e bërë të vështirë zhvillimin e politikave dhe ndërhyrjeve të nevojshme.

Margjinalizimi ekonomik është një tjetër pengesë e rëndësishme. Diskriminimi në punësim, i shoqëruar ndonjëherë me vështirësi gjuhësore dhe arsim më të ulët, mund të çojë në papunësi dhe pasiguri ekonomike për gratë myslimane. Kjo mund të ketë një ndikim të dëmshëm në mirëqenien e tyre, duke kufizuar pavarësinë dhe mundësitë për përparim shoqëror. Kjo çështje përkeqësohet nga simbolet e dukshme fetare, të cilat ulin mundësinë e tyre për t'u punësuar.

Përtej këtyre barrierave strukturore, gratë myslimane përballen edhe me sfida që lidhen me përfaqësim, por edhe me zërin e padëgjuar të tyre. Zërat e tyre shpesh mungojnë ose marginalizohen në diskutimet publike, duke çuar në mungesë të mirëkuptimit dhe ndjeshmërisë për përvojat e tyre. Kur ato përfaqësohen, kjo shpesh bëhet në mënyrë të kufizuar dhe stereotipike, ose si viktimat pasive që kanë nevojë për shpëtim, ose si kërcënim ndaj vlerave evropiane. Kjo mungesë e një përfaqësimi të plotë përjetëson stereotipat e dëmshme dhe pengon dialogun e vërtetë. Narrativi mbizotërues shpesh i paraqet sfidat e grave myslimane si pasojë të fesë ose kulturës së tyre, duke anashkaluar rolin e faktorëve më të gjerë shoqërorë si racizmi, diskriminimi dhe pabarazia.

VEPRIMET E GRAVE MYSLIMANE NË EVROPË

Përderisa sfidat e përshkruara më lart, janë reale dhe të shumta, ky portretizimi anashkalon një dimension thelbësor: veprimet e gjalla dhe të larmishme të grave myslimane. Në të gjithë Evropën, gratë myslimane po sfidojnë në mënyrë aktive si islamofobinë, ashtu si edhe normat patriarkale, duke krijuar hapësira për veten e tyre dhe duke formësuar narrativet e tyre. Gratë myslimane në Evropë janë aktive në

shumë mënyra. Ato organizohen në komunitetet e tyre dhe flasin hapur për çështje të rëndësishme. Ato tregojnë forcë dhe ndërmarrin veprime edhe kur përballen me vështirësi.

Një fushë shumë e rëndësishme e aktivizimit të grave myslimane është lufta kundër islamofobisë dhe diskriminimit. Ato janë në ballë të përpjekjeve për të sfiduar politikat diskriminuese, si ndalimi i veshjeve fetare dhe luftimi i stereotipave negative që përhapen nga media dhe politikanët. Organizatat e udhëhequra nga gratë myslimane po dokumentojnë krimet e urrejtjes, duke ofruar mbështetje ligjore për viktimat e diskriminimit dhe duke u angazhuar në avokim për të ndryshuar politikat. Ato po punojnë gjithashtu për të edukuar publikun rreth Islamit dhe për të sfiduar keqkuptimet që shkaktojnë paragjykimet. Përmes të folurit publik, shkrimit dhe përdorimit të mediave sociale, ata po rimarrin kontrollin e narrativeve të tyre, duke kundërshtuar ato dominuese që shpesh i heshtin. Ato po ndërtojnë lidhje me komunitetet e tjera të marginalizuara, duke njohur ndërlidhjen e formave të ndryshme të shtypjes, si racizmi, seksizmi dhe ksenofobia, dhe po punojnë drejt çlirimit kolektiv.

Gratë myslimane në Evropë po përdorin kulturën për të shprehur veten dhe për të bërë një ndryshim. Nëpërmjet artit, letërsisë, filmit dhe muzikës, gratë myslimane po sfidojnë stereotipat, po eksplorojnë identitetet e tyre komplekse dhe po krijojnë përfaqësime alternative. Këto shprehje krijuese u japin atyre një platformë të fuqishme për t'u shprehur, për të ndarë përvojat e tyre, për të sfiduar narrativet mbizotëruese dhe për të kontribuar në një kuptim më të thellë të jetës së grave myslimane në Evropë. Ato po përdorin talentin e tyre krijues për të ndërtuar ura me shoqërinë, duke nxitur ndjeshmërinë dhe mirëkuptimin.

Aktivizimi digjital është bërë gjithashtu një mjet i rëndësishëm për gratë myslimane, veçanërisht për brezat e rinj. Platformat online ofrojnë hapësira për rrjetëzim, organizim dhe shkëmbim informacioni. Ata po përdorin mediat sociale për të sfiduar islamofobinë, për të ndërtuar solidaritet dhe

Aktivizimi digjital është bërë gjithashtu një mjet i rëndësishëm për gratë myslimane, veçanërisht për brezat e rinj. Platformat online ofrojnë hapësira për rrjetëzim, organizim dhe shkëmbim informacioni. Ata po përdorin mediat sociale për të sfiduar islamofobinë, për të ndërtuar solidaritet dhe për të përfunduar zërat e tyre në një nivel global.

për të përfunduar zërat e tyre në një nivel global. Ato po krijojnë komunitete online që ofrojnë mbështetje, mentorim dhe një ndjenjë përkatësie. Kjo hapësirë digjitale u lejon atyre të lidhen me gra të tjera myslimane përtej kufijve, të ndajnë strategji dhe të ndërtojnë një lëvizje globale për ndryshim. Ato mund të fillojnë peticione, të rrisin ndërgjegjësimin për çështje të caktuara dhe të lidhen me aktivistë të tjerë.

KONKLuzioni

Përvojat e grave myslimane në Evropë janë të ndryshme dhe komplekse, të formuara nga një kombinim faktorësh fetarë, kulturorë, socio-ekonomikë dhe politikë. Ky shkrim ka nxjerrë në pah kufizimet e tregimeve të thjeshtuara që i trajtojnë gratë myslimane si një grup homogjen, duke theksuar në vend të kësaj rëndësinë e një qasje ndërsektoriale që pranon shumëllojshmërinë e identiteteve dhe përvojave të tyre. Ndërsa përballen me sfida të shumta, duke përfshirë islamofobinë, diskriminimin, presionin për t'u asimiluar dhe marginalizimin, gratë myslimane janë larg viktimave pasive. Ato demonstrojnë veprim dhe qëndrueshmëri të jashtëzakonshme, duke sfiduar në mënyrë aktive normat dhe stereotipat kufizuese, si brenda komuniteteve të tyre, ashtu edhe në shoqërinë e gjerë evropiane.

Referenca:

- Crenshaw, K. (1989). Demarginalizing the intersection of race and sex: A black feminist critique of antidiscrimination doctrine, feminist theory and antiracist politics. *University of Chicago Legal Forum*, 1989(1), 139-167.
- Moors, A., & Salih, R. (2009). 'Muslim women' in Europe: Secular normativities, bodily performances and multiple publics. *Social Anthropology/Anthropologie Sociale*, 17(4), 375-378.
- Alidadi, Khadijah (2018). *Muslim Women in the UK and the Challenge of Securitisation*. Routledge.
- Bullock, Katherine (2002). *Rethinking Muslim Women and the Veil: Challenging Historical and Modern Stereotypes*. Herndon, VA: International Institute of Islamic Thought.
- Cesari, Jocelyne (2009). *Muslims in the West after 9/11: Religion, Politics, and Law*. New York: Routledge.
- Afshar, Haleh, et al. (2005) "Muslim Women in the UK and Their Experience of Racialization." *Ethnic and Racial Studies*, 632-658.

Pasojat shëndetësore të imoralitetit

Imoraliteti si një fenomen që prek individët dhe shoqërinë ka pasojë të thella në shumë aspekte të jetës, duke përfshirë edhe shëndetin fizik dhe mendor. Ky koncept, që mund të përfshijë sjellje të papranueshme nga norma morale dhe shoqërore, ndikon në mënyra të ndryshme në mirëqenien e individëve dhe komunitetit. Përderisa imoraliteti është shpesh i lidhur me shkeljen e normave dhe vlerave shoqërore, pasojat e tij në shëndet janë të shumëfishta dhe të ndërlikuara. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të shqyrtojmë ndikimet


që imoraliteti mund të ketë në shëndetin fizik dhe mendor, në marrëdhëniet ndërpersonale, si dhe në ndjenjat e përgjithshme të lumturisë dhe stabilitetit emocional.

Përveç pasojave mendore, imoraliteti mund të ketë gjithashtu pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda në shëndetin fizik. Abuzimi me substanca, sjelljet e rrezikshme seksuale dhe mungesa e kujdesit ndaj shëndetit personal mund të çojnë në sëmundje të ndryshme, përfshirë infeksione dhe sëmundje kronike. Për shembull, individët që angazhohen në marrëdhënie seksuale të pamatura ose të pasigurta mund të përjetojnë infeksione seksualisht të transmetueshme, që përveçse ndikojnë në shëndetin e tyre, mund të dëmtojnë edhe ata që janë të afërt me ta.

Në nivelin shoqëror, pasojat e imoralitetit shfaqen edhe në shtimin e tensioneve dhe mosbesimit. Nëse individët nuk respektojnë normat dhe vlerat që krijojnë kohezionin shoqëror, mund të lindin përçarje dhe konflikte, që dëmtojnë harmoninë dhe bashkëjetesën e komunitetit. Kjo mund të ndikojë gjithashtu në ndjenjën e sigurisë dhe qëndrueshmërisë në shoqëri, duke kontribuar në një klimë më të pasigurt dhe më të tensionuar.

Pasojat shëndetësore të imoralitetit janë të shumta dhe të ndërlikuara, duke përfshirë dëmtimin e shëndetit mendor dhe fizik, si dhe ndikimin në mirëqenien sociale dhe emocionale të individëve dhe shoqërisë.

Përmes këtij punimi do mundohemi të shfaqim pasojat – dëmet shëndetësore të cilat i shkakton amoralityti (zinaja).



Për këtë kemi shqyrtuar literaturën mjekësore duke tentuar ta përputhim me atë fetare dhe të nxjerrim për përfundim qëllimin e përbashkët të tyre.

SËMUNDJET INFEKTIVE

Sëmundjet infektive janë shmangie strukturore dhe funksionale e organit apo organizmit nga normaliteti i tij fiziologjik,¹ si shkak i mikroorganizmave (viruseve, baktereve, kërpudhave apo të tjera.) Janë të shumtë mikroorganizmat të cilët jetojnë në trupin e njeriut. Këta janë zakonisht të padëmshëm ose edhe të dobishëm për shëndetin, mirëpo në rrethana të caktuara disa mikroorganizma mund të shkaktojnë sëmundje. Sëmundjet ngjitëse janë gripi (influenza), lija e ujit (variçela) e shumë të tjera. Sëmundjet infektive janë të njohura gjithashtu si çrregullime të transmetueshme brenda qelizave të shkaktuara nga futja e mikroorganizmave ose parazitëve në trup nga ndonjë agjent patogjen. Këto sëmundje shpesh quhen sëmundje ngjitëse, sepse ato transmetohen nga një person në tjetrin ose nga një specie në tjetrën. Të gjitha sëmundjet ngjitëse karakterizohen nga mundësia e transmetimit të njerëzit në një ose më shumë mënyra, nga një person në tjetrin, nga kafshët të njerëzit. Gjithashtu mund të transferohet nga toka e kontaminuar.

Sipas kritereve që janë caktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me fjalën shëndet kuptojmë mirëqenien e plotë fizike, mendore dhe sociale. Faktorët sëmundje-shkaktues për njeriun janë të shumtë, si mikroorganizmat (që shkaktojnë sëmundje infektive, e të cilat janë tema jonë), çrregullimet metaboliko-degjenerative, sëmundjet gjenetike, helmimet, traumat etj.. Sëmundjet infektive gjithmonë kanë tërhequr vëmendjen e shoqërisë njerëzore për karakterin masiv, epidemik, për vdekshmërinë e lartë, për ndërlikimet dhe invalidizimet që shkaktojnë.

Sëmundje ngjitëse vdekjeprurëse kemi shumë, por do të cekim vetëm disa siç janë: Antraksi, Tetanosi, Leptospira, Tuberkulozi, Pneumonia, Kolera, Botulizmi, Infeksionei Pseudomonas, Infeksioni MRSA, Infeksioni E.Coli, Meningjiti, Gonorrhea, Dezinteria, Sifilizi, AIDS-Sida, Fasciiti nekrotizues, etj..²

Në veçanti bakteri i Sifilizit transmetohet nëpërmjet kontaktit direkt me puçrrat e Sifilizit, të cilat zakonisht paraqiten në sipërfaqen e organeve gjenitale.

HIV – SIDA

Sida paraqet sëmundje infektive, e cila njihet si infeksioni i virusit të mungesës së imunitetit të njeriut dhe sindroma e mungesës së imunitetit të fituar. HIV/AIDS apo SIDA është një spektër kushtesh të shkaktuara nga infeksioni me virusin e mungesës së imunitetit të njeriut (HIV), një retrovirus.³

Që kur u identifikua SIDA deri në vitin 2021, sëmundja ka shkaktuar rreth 40 milionë vdekje në mbarë botën. Në vitin 2021, kishte 650.000 vdekje dhe rreth 38 milionë njerëz në mbarë botën që jetonin me HIV. Rreth 20.6 milionë nga këta njerëz jetojnë në Afrikën Lindore dhe Jugore. HIV/AIDS konsiderohet një pandemi - një shpërthim sëmundjesh që është i pranishëm në një zonë të madhe dhe po përhapet në mënyrë aktive.

Përderisa nuk ka një kurë ose vaksinë të disponueshme gjerësisht, trajtimi antiretroviral mund të ngadalësojë rrjedhën e sëmundjes dhe mund të çojë në një jetëgjatësi pothuajse normale. Trajtimi rekomandohet sapo të vendoset diagnoza. Pa trajtim, koha mesatare e mbijetesës pas infektimit është 11 vjet.⁴ (Sipas të dhënave më të reja shkencore-mjekësore, sepse në literaturën 10 vjet e më të vjetër, koha mesatare e mbijetesës është vetëm 3 vjet.)

SIFILIZI

Sifilizi – sëmundje seksualisht e transmetueshme apo infeksion kongjenital shkaktohet nga bakteri i quajtur Treponema pallidum. Zakonisht shkaktohet nga kontakte intime me partner të infektuar. Manifestohet nga formacione ulceroze në zonën gjenitale, rektum, gojë, gishtërinj, pastaj zmadhim i nyjave limfatike, lodhje, dhembje koke, ethe, humbje oreksi, skuqe të lëkurës.⁵

Është sëmundje komplekse që shkakton simptome të llojllojshme në fazat e ndryshme të infeksionit. Sifilizi i pa trajtuar ka shumë komplikime. Shkaktari pra është Treponema e zbehtë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është një sëmundje e ndryshme bakteriale, që transmetohet përmes kontaktit seksual. Bakteria Treponema pallidum transmetohet gjithashtu përmes kontaktit fizik dhe puthjeve



të gjata. Përveç kësaj, nënat shtatzëna që janë të infektuara janë në gjendje të transmetojnë bakterin dhe sëmundjen të foshnjat e tyre gjatë lindjes dhe pas lindjes. Sifilizi përhapet përmes plagëve dhe mund të shkaktojë dëmtime në organe si sytë, trurin ose kyçet.

Sifilizi transmetohet nëpërmjet kontaktit seksual (vagjinal, anal, oral) me personin e infektuar. Në veçanti bakteri i Sifilizit transmetohet nëpërmjet kontaktit direkt me puçrrat e Sifilizit, të cilat zakonisht paraqiten në sipërfaqen e organeve gjenitale. Faktorët kryesor të rrezikut janë: përfshirja në seksin e pambrojtur; marrëdhënia seksuale me më shumë se një partner; marrëdhënia seksuale me personin i cili ka shumë partnerë seksual.

Simptomat e para të Sifilizit zakonisht janë puçrrat të cilat nuk janë me dhembje dhe që paraqiten në penis, vagjinë, anus, rektum dhe gojë. Puçrrat zakonisht paraqiten dy deri në gjashtë javë pas infektimit dhe zhduken për një kohë të shkurtër. Mostrajtimi i drejtë i Sifilizit mund të shkaktojë sëmundje të zemrës, çmendje, verbim, paralizë edhe vdekjen. Mostrat nga puçrrat e Sifilizit ekzaminohen me mikroskop. Gjithashtu Sifilizi mund të diagnostikohet edhe me testin e gjakut.⁶

HERPESI

Herpesi gjenital është një infeksion nga virusi herpes simplex (HSV) i organeve gjenitale në rastin kur është i llojit gjenital. Shumica e njerëzve ose nuk kanë simptoma, ose kanë simptoma të lehta dhe kështu nuk e dinë që janë të infektuar. Pra paraqet inflamacion në lëkurë dhe mukoza, i shkakton nga herpes viruset. Karakterizohet me flluska të vogla, të cilat zhvillohen te personat që kanë pasur temperaturë të lartë.⁷


Kur simptomat ndodhin, ato zakonisht përfshijnë flluska të vogla që hapen për të formuar ulcera të dhimbshme. Mund të shfaqen edhe simptoma të ngjashme me gripin, si ethe, dhembje ose nyje limfatike të fryrë. Fillimi është zakonisht rreth 4 ditë pas ekspozimit me simptoma, që zgjasin deri në 4 javë. Pasi të infektohen, shpërthime të mëtejshme mund të ndodhin, por janë përgjithësisht më të lehta.

Sëmundja zakonisht përhapet nga kontakti i drejtpërdrejtë gjenital me sipërfaqen e lëkurës ose sekrecionet e dikujt që është i infektuar. Kjo mund të ndodhë gjatë seksit, përfshirë seksin anal dhe oral. Plagët nuk kërkohen që të ndodhë transmetimi. Rreziku i përhapjes midis një çifti është rreth 7.5% gjatë një viti. HSV klasifikohet në dy lloje, HSV-1 dhe HSV-2. Historikisht HSV-2 ishte më i zakonshëm, ndërsa HSV-1 gjenital është bërë më i zakonshëm në botën e zhvilluar. Diagnoza mund të ndodhë duke testuar lezionet duke përdorur ose PCR ose kulturë virale ose teste të gjakut për antitropa specifike.

Përpjekjet për të parandaluar infeksionin përfshijnë shmangien e marrëdhënieve seksuale, përveç marrëdhëniet seksuale me dikë që nuk është i infektuar. Pasi të infektohet, nuk ka shërim. Megjithatë, ilaçet antivirale mund të parandalojnë shpërthimet ose të shkurtojnë shpërthimet nëse ato ndodhin. Përdorimi afatgjatë i antiviralëve mund të zvogëlojë rrezikun e përhapjes së mëtejshme.⁸

GONORREA

Gonoreja është sëmundje ngjitëse, purulente, që prek cipat mukoze gjenitale, e cila transmetohet kryesisht me anë të aktit seksual, e cila shkaktohet nga gonokoku. Është një sëmundje seksualisht e transmetueshme (STD). Disa njerëz mund të kenë gonorre pa shfaqur asnjë simptomë. Gjithashtu, simptomat e gonoresë të femrat mund të jenë të ndryshme



në krahasim me ato që shfaqen te meshkujt. Nëse mendoni se keni gonorre, është e këshillueshme të vizitoni mjekun tuaj. Trajtimi i menjëhershëm ndihmon në shmangien e problemeve afatgjata. Një kurs i antibiotikëve zakonisht shëron gonorrenë.⁹

Mënyra më e sigurt për të parandaluar gonorrenë dhe IST të tjera është përmes abstenencës. Pra shkencëtarët e fushës mjekësore kanë ardhur në përfundim që të abstenuarit nga marrëdhëniet intime me të huajt përveç partnerit legjitim (bashkëshortit) është zgjidhja më e mirë.¹⁰

PËRFUNDIMI

Duke u bazuar nga e gjitha që u tha më sipër, u vërtetua edhe një herë se çdo rregull, çdo urdhër, çdo sugjerim, çdo gjykim dhe çdo ndalesë që ka bërë për ne i Madhi Allah xh.sh., qoftë përmes fjalës së Tij të lartësuar, Kuranit fisnik, qoftë përmes të dërguarve të tij, paqja qoftë mbi ta, e veçanërisht përmes Pejgamberit të fundit Muhamedit a.s., qoftë përmes fjalëve të dijetarëve që janë trashëgimtarë të Pejgamberit a.s., është për të mirën tonë, qoftë të individit, ashtu edhe të shoqërisë.

Nëse i krahasojmë dispozitat fetare me zhvillimet më të reja mjekësore vërejmë përputhshmëri të pashoqe, shohim që edhe ndëshkimet më të rënda, me plot kuptimin e fjalës janë rahmet (mëshirë) si për njeriun në veçanti, ashtu edhe për njerëzimin në përgjithësi. Kur këto na u argumentuan edhe me fakte shkencore të fushës së mjekësisë, arrijmë në një vërtetim të një baraspeshe në mes të ndëshkimeve për imoralitetin dhe dëmet që shkakton ai në aspektin mjekësor.

- 1 Nazmi N. Velija, Nazmije A. Velija, *Fjalor i terminologjisë mjekësore*, (Tiranë: "Infbotues", 2013), fq. 564.
- 2 Ilir Q. Tolaj, Hamdi Ramadani, Shemsedin Dreshaj, *Sëmundjet Infektive*, (Prishtinë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2018), fq. 21-34; Kenard E. Nelsen et al.: *Infectious Disease Epidemiology*, 3rd Edition, Jones and Brothers Pub., 2014. P: 11-32; Leon Gordis, *Epidemiology*, 5th Edition, Elsevier Inc., 2014. P: 27-41.
- 3 Nazmi N. Velija, Nazmije A. Velija, *Fjalor i terminologjisë mjekësore*, (Tiranë: "Infbotues", 2013), fq. 287.
- 4 John Bennett, Raphael Dolin, Martin J. Blaser. Mandell, Douglas and Bennet's, *Principles and Practice of Infectious Diseases*, 8th edition, Elsevier, 2015. P: 421-518.
- James Cherry, Gail Harrison, Sheldon Kaplan, Peter Hotez, William Steinbach, Feigin & Cherry's Textbook of *Pediatric Infectious Diseases*, 8th edition, Elsevier, 2019. P: 129-248.
- Ilir Q. Tolaj, Hamdi Ramadani, Shemsedin Dreshaj, *Sëmundjet Infektive*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - "Hasan Prishtina", 2018), fq. 583-627;
- Elmas Eltari, Pëllumb Pipero, Drita Gera, *Sëmundjet Infektive*, (Tiranë: Universiteti Mjekësor i Tiranës, 2015), fq:58-63.
- 5 Nazmi N. Velija, Nazmije A. Velija, *Fjalor i terminologjisë mjekësore*, (Tiranë: "Infbotues", 2013). Fq: 566.
- 6 Jonathan Cohen, William G. Powderly, Steven M. Opal, *Infectious Diseases*, 4th Edition. Elsevier, 2017. P:124-200; Janez Tromazic in Franc Strle s sodelavci, *Infekcije Bolezni* (English version), 2014/2015. P: 234-246;
- Ilir Q. Tolaj, Hamdi Ramadani, Shemsedin Dreshaj, *Sëmundjet Infektive*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - "Hasan Prishtina", 2018). Fq: 583-627.
- 7 Nazmi N. Velija, Nazmije A. Velija, *Fjalor i terminologjisë mjekësore*, (Tiranë: "Infbotues", 2013), fq. 268.
- 8 Karen E. Rogstad, *ABC of Sexuality Transmitted Infections*, 6th Edition, BMJ Books, 2011. P: 46-72;
- Mark Loeb, Fiona Smaill and Marek Smieja, *Evidence Based Infectious Diseases*, 2nd Edition, Blackwell Publishing Ltd. 2009. P: 210-249.
- Ilir Q. Tolaj, Hamdi Ramadani, Shemsedin Dreshaj, *Sëmundjet Infektive*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - "Hasan Prishtina", 2018), fq. 519-522.
- 9 Nazmi N. Velija, Nazmije A. Velija, *Fjalor i terminologjisë mjekësore*, (Tiranë: "Infbotues", 2013). Fq: 243.
- 10 Tom Elliott, Anna Casey, Petter Lambert, Johnatan Sandoe, *Lecture notes, Medical microbiology and infection*. 5th Edition, Wiley Blackwell, 2011. P:326-345.
- Gerd Gross, Stephen K. Tying, *Sexually Transmitted Infections and Sexually Transmitted Diseases*, Springer, 2011. P:43-61.
- Muham-med Ali El-Barr, *Narkomania, sëmundjet gjenitale dhe prostitucioni*, (Tetovë: "ASR", 2002/1422 h), fq. 107-109;
- Ilir Q. Tolaj, Hamdi Ramadani, Shemsedin Dreshaj, *Sëmundjet Infektive*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - "Hasan Prishtina", 2018), fq. 522-524.
- Elmas Eltari, Pëllumb Pipero, Drita Gera, *Sëmundjet Infektive*, (Tiranë: Universiteti Mjekësor i Tiranës, 2015). Fq:63-67.

Mr. Esad Ejupi

Korrupsioni dhe pikëpamjet e ndryshme për të

Termi korrupsion, pa dyshim, është fjalë shpesh e dëgjuar dhe e lexuar. Do të ishte fat i mirë që këtë term ta dëgjojmë e lexojmë vetëm duke e mësuar e studiuar në teori, por fatkeqësisht korrupsioni është edhe një dukuri e keqe që gjendet pothuajse në çdo shoqëri, ku më shumë e ku më pak. Që nga kohërat e lashta, për korrupsionin, janë dhënë mendime e definime të ndryshme. Kjo për faktin se korrupsioni nuk është vetëm i ditëve të sotme, por daton qysh nga kohërat e lashta.

Në fjalorin e gjuhës shqipe fjala “*korrupsion*” nënkupton një prishje morale të dikujt, që merr një rrugë të keqe për qëllime të caktuara, nënkupton një nxitje të dikujt që me anë të dhuratave, ryshfeteve, të veproj në kundërshtim me detyrën që ka, të shkel ligjet, etj..

Praktika po tregon se korrupsioni edhe pse është i kohërave të lashta, ai dita – ditës po bëhet gjithnjë e më i sofistikuar dhe në shumë raste tejkalon shumë nga ato përkufizime, që janë dhënë në forma të ndryshme. Kjo do të thotë se të përkufizosh se çka është ose çka e përbën korrupsionin tashmë është goxha sfiduese, prandaj është e nevojshme që kjo të bëhet nga këndvështrime të ndryshme.

Ndër me të rëndësishmit këtu është këndvështrimi juridik, këndvështrimi ekonomik, këndvështrimi politik, e për revistën në të cilën botohet ky shkrim, i rëndësishëm është edhe këndvështrimi fetar, i cili mbase është sqaruar edhe shumë herë të tjera më parë.

Në vazhdim do të mundohemi që këto pikëpamje t'i shpjegojmë një nga një. Sa i përket këndvështrimi juridik, mund të themi se korrupsioni është diçka e ndaluar me shumë ligje përkatëse të vendeve të ndryshme e deri në kushtetuta. Po ashtu korrupsioni është i ndaluar edhe në aspektin ndërkombëtar me konventa të ndryshme ndërkombëtare. Këtë dukuri, s'ka dyshim që edhe mësimet fetare e ndalojnë. Konkretisht korrupsioni nënkupton një abuzim me detyrën ose funksionin e besuar publik, si në qeveri, gjyqësi, ekonomi, politikë apo edhe shoqata jo qeveritare, për të fituar një përfitim material ose shpirtëror, për të cilën nuk ekziston një kërkesë apo bazë e vlefshme dhe e arsyeshme ligjërish.

Nga këndvështrimi ekonomik, korrupsioni konsiderohet si pengesë e madhe e zhvillimit ekonomik, sepse përbën një



nga faktorët kryesor që ndikon në zvogëlimin e investimeve, rrit pabarazinë e të ardhurave, mundëson krijimin e monopolit, etj..

Këndvështrimi politik i korrupsionit vazhdon edhe më tej të jetë më i komplikuari. Derisa në njërën anë politika deklarativisht vazhdimisht e dënon korrupsionin, në anën tjetër është pikërisht politika ose njerëzit e lidhur me politikën, ata që mbesin fare indiferent nga ndëshkueshmëria nga kjo dukuri e keqe e shoqërisë.

Në fakt, raportet e perceptimeve të ndryshme për korrupsionin tregojnë se pikërisht politika është tereni më i përshtatshëm për korrupsion, sepse ata (presidenti, kryeministri, ministrat, deputetët, kryetarët e komunave, drejtuesi e ndërmarrjeve publike...etj.), janë ata që qeverisin me paranë publike.

Kjo i bënë ata që herë pas here të tentojnë që në emër të interesit publik, disa fondeve t'ua devijojnë cakun dhe të përfundojnë në llogaritë e politikës apo të të afërmeve të tyre, qoftë përmes bizneseve të tyre, apo bizneseve (të kamufluara) në emra të personave të tjerë të besueshëm. Pikërisht për shkak të aferave të këtilla korruptive, nëpër vende të ndryshme të botës ka politikanë që kanë humbur pozitat e tyre, diku janë burgosur, e në raste më të rralla ajo klasë politike zëvendësohet tërësisht.

Ky fenomen, diku më shumë e diku me pak, është problematike shqetësuese, përfshirë këtu edhe vendin tonë, vendet e rajonit dhe disa vende të Evropës. Korrupsioni është një nga format mjaft të rrezikshme "të kriminalitetit të jakës së bardhë", i cili vazhdon të jetë prezent edhe sot në shoqëritë bashkëkohore. Në vija të përgjithshme, shumica e burimeve e përkufizojnë korrupsionin si "shpërdorim i pushtetit publik për përfitime personale".

Së këndejmi, pikëtakimi i shumë përkufizimeve dhe definicioneve se çka është korrupsioni lidhet me atë që nënkupton "keqpërdorimin e fondeve publike për interesa private".

Megjithatë korrupsioni është një dukuri shumë më e ndërlikuar sesa ajo që nënkuptojnë përkufizimet ligjore.

Korrupsioni nënkupton një abuzim me detyrën ose funksionin e besuar publik, si në qeveri, gjyqësi, ekonomi, politikë apo edhe shoqata jo qeveritare, për të fituar një përfitim material ose shpirtëror, për të cilën nuk ekziston një kërkesë apo bazë e vlefshme dhe e arsyeshme ligjërisht.

MASAT PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Kemi dëgjuar shpesh maksimën e njohur "më mirë të parandalosh sesa të shërosh". Kjo në fakt është maksimë që lidhet me parandalimin e sëmundjeve, e që përdoret më shumë në mjekësi e shëndetësi, por kuptimi i saj, pak i modifikuar, ka shtrirje edhe në fusha të caktuara, konkretisht kur kemi të bëjmë me sundimin e ligjit dhe në përgjithësi me parandalimin e dukurive të këqija.

Masat më efikase dhe më frytdhënëse në politika antikorruptive të shteteve të suksesshme në këtë luftë janë ato që merren me brendinë e korrupsionit apo shkaqet e shfaqjes së tij. "*Këto masa kanë karakter parandalues dhe ato drejtohen kundër shkaqeve dhe jo kundër shfaqjes së jashtme apo pasojave.*" Kështu thotë prof. Luan Gjonca, në librin e tij "Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar".

Institucionet publike duhet të orientohen që organizmin e luftës kundër korrupsionit ta forcojnë në parandalimin e shfaqjes së tij. Masat e ndryshme që ndihmojnë në parandalimin e korrupsionit janë si vijon: studimi dhe analiza mbi shfaqjen e korrupsionit në një vend, strategjitë parandaluese, bashkëpunimi me qytetarë, inkurajimi dhe mbrojtja e tyre për të raportuar, ngritja e besueshmërisë në institucione publike, parandalimi i konfliktit të interesit, transparenca, deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, mediat, edukimi i nëpunësve civil lidhur me rritjen e integritetit personal dhe institucional, etj..

Një garanci për më pak korrupsion në institucione publike është rritja e integritetit të zyrtarëve publik, ose thënë ndryshe, sa më shumë integritet në institucione publike, aq më pak korrupsion. Integriteti nënkupton harmonizimin dhe respektimin e vazhdueshëm të vlerave etike, parimeve dhe normave të përbashkëta, që mbështesin dhe përcaktojnë prioritetin e interesit publik mbi interesin privat.

Çështja e integritetit është temë që ka zënë vend të veçantë në reformën e administratës publike në vendin tonë, sikurse edhe strategjitë kundër korrupsionit. Tashmë ka vite që planifikimi i integritetit është detyrë e të gjitha



institucioneve lokale e qendrore. Përmes një plani të detajuar të integritetit bëhet vlerësimi i individëve (punonjësve), institucioneve e madje edhe i vetë shtetit.

Termi “integritet” ndryshe kuptohet edhe me fjalët “ndershmeri” ose “pakurruptueshmeri” ose diçka që është “i pa njollosur”, “i pa prekur” apo konsistent ndaj të keqes. Kur thuhet për dikë si “njeri me integritet” nënkuptohet si “njeri me vlera”. Në rastet më të këqija, e kundërta. Integriteti është faktori kryesor i suksesit të qëndrueshëm.

ÇKA ËSHTË KONFLIKTI I INTERESIT?

Janë të njohura dy drejtime të luftës kundër korrupsionit. Njëri është ai i parandalimi (preventiva) dhe tjetri është ai i ndëshkimit (represiv). Lufta kundër korrupsionit fillon me parandalimin e tij, e parandalimi fillon me edukimin kundër korrupsionit. Kur flasim për konfliktin e interesit duhet ta vejmë në konsideratë se çdo zyrtar publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, për çdo ditë mund të vijë në ndonjë situatë të konfliktit të interesit. Prandaj është më se e domosdoshme që njohuritë për të ditur si shfaqet, si shmanget dhe si parandalohet konflikti i interesit duhet të thellohen çdo ditë.

Konflikti i interesit në fakt është analizë dinamike. D.m.th. situatat e shfaqjes së konfliktit të interesit mund të jenë nga më të ndryshmet. Por ajo që i lidhë këto situata të ndryshme ose pikë e krejt këtyre është vendimmarrja. Pra, konflikti i interesit është thjesht i lidhur me vendimmarrjen. Prandaj duhet pasur kujdes që të kemi vendimmarrje pa konflikt interesi.

Situatat e konfliktit të interesit nuk duhet domosdoshmërisht të kuptohen si korrupsion. Në fakt, konflikti i interesit nuk është apriori korrupsion. Nuk është korrupsion nëse identifikohet me kohë dhe evitohet ose shmanget

vendimmarrja me konflikt interesi. Përndryshe, nëse një situatë e konfliktit të interesit nuk deklarohet, nuk evitohet, nuk parandalohet e nuk shmanget, atëherë kjo mund të shpije në korrupsion.

Pra, çdo situatë kur nuk zgjidhet konflikti i interesit dhe ka vendimmarrje, ajo mund të shpije në korrupsion. Është e ditur se rrugët më të ndërlikuara të përballjes me korrupsionin janë ato që synojnë parandalimin e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve të sistemeve të besueshme për qytetarët. E thënë ndryshe, parandalimi i korrupsionit lidhet me qeverisjen e mirë.

Me gjithë këto masa të përmendura dhe disa prej tyre edhe të elaboruara, edhe me tutje personalisht mendoj se forma më e mirë për të luftuar korrupsionin është edukimi kundër korrupsionit. Pra, vazhdimisht krahas masave kundër korrupsionit, duhet të këtë aktivitete edukuese kundër këtij fenomeni të dëmshëm për shoqërinë. Dhe në favor të kësaj që po them, kam nxjerr edhe një aforizëm të shkurtë si vijon: “Me dënim kufizojmë të korruptuarin, me edukim mund të kufizojmë korrupsionin!”

Referenca:

- Esad Ejupi, “Konflikti i interesit”, doracak, Prishtinë, 2014.
- Esad Ejupi, “Vendimmarrje pa konflikt interesi”, Prishtinë, 2020.
- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit (Nr.06/L-011).
- Luan Gjonqja, “Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004.
- Edukimi kundër korrupsionit, “Manual për mësues”, shkurt, 2012, Tiranë.
- Gazeta ditore “Zëri”, dt.8.12.2017 (<https://zeri.info/zerat/175548/me-shume-integritet-do-te-thote-me-pak-korrupsion>).
- Gazeta ditore “Zëri”, dt.9.12.2020 (<https://zeri.info/zerat/381827/si-te-tejkalohet-pandemia-e-korrupsionit>).

Kompozitat në Kuran

Fjalët e përbëra janë të gjitha ato fjalë të bashkuara nga dy ose më shumë fjalë apo tema motivuese të thjeshta, të cilat bashkohen në një fjalë të vetme, ku në formimet e tyre gjejmë emra, mbiemra, folje e ndajfolje, por nuk mungojnë edhe rastet e tyre (fjalë të përbëra) me temë numërorësh dhe përemrash.¹ Sipas llojit të marrëdhënieve sintaksore midis gjymtyrëve, dallojmë kompozitat me marrëdhënie bashkërenditëse (këpujore) dhe nënrenditëse (përcaktore). Këto dy grupe, ndahen në nëngrupe si emra të përbërë, ku hyjnë *emër + emër*; *emër + mbiemër*; *emër + folje*; *emër + pjesore* e ndonjë nëntip tjetër, të cilat kanë dhënë apo krijuar edhe pjesë të tjera të ligjëratës. Në këtë studim janë cituar dyzet e shatë (47) kompozita të reja, të cilat dëshmohen në tabelën e parë dhe si të tilla janë përdorur në Kuran, kurse dyqind e njëzet e nëntë (229) janë cituar në tabelën e dytë, të cilat gjithashtu janë përdorur në Kuran.


STUDIUESIT SHQIPTARË PËR KOMPOZITËN


Studiuesit e ndryshëm vendor kanë dhënë kontribut të vlerësuar për kompozitën, prandaj në vazhdim po i citoj disa nga ata:

Sipas llojit të marrëdhënieve sintaksore midis gjymtyrëve, dallojmë kompozitat me marrëdhënie bashkërenditëse (këpujore) dhe nënrenditëse (përcaktore).

Jani Thomaj për këtë çështje thotë: “Kompozitë-a, -at. Fjalë të përbëra, janë të formuar nga bashkimi i dy e më shumë temave në procesin e krijimit të fjalëve të reja. Pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore, si: zemërgur, belhollë, buzëqesh, keqkuptoj, fjalëshumë.”²

Disa autorë që e kanë botuar Gramatikën e gjuhës shqipe 1, për kompozitën e ka dhënë këtë mendim: “Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi, me anë të cilës krijohen fjalë të reja, që kanë në përbërjen e tyre dy e më shumë tema motivuese, njëra nga këto (tema





mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër është e asnjënjësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore, p.sh. bregdet, botëkuptim, marrëdhënie, juglindje, veriperëndim, vendbanim, syzi, mësimor-edukativ (...).³

Kompozitat janë trajtuar edhe nga A. Kostallari, i cili e ka paraqitur këtë mendim: “Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një njësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohen semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintetike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj”.⁴ Fjalët e përbëra (kompozitat) dokumentohen në veprat e shkruara të autoreve të vjetër, si të Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani etj., kurse në onomastikë dhe toponomastikë gjejmë një dokumentim edhe me të lashtë se në gjuhën e shkruar të autorëve të cekur më lart, mirëpo për t’u informuar me gjerësisht për kompozitën shih dhe studioni citatin e parë të këtij punimi (Millaku, 2024). Për këtë çështje gjuhësore kanë folur e shkruar edhe studiues të tjerë të gjuhës.

STUDIUESIT E HUAJ PËR KOMPOZITËN E SHQIPES

Fjalët e përbëra të shqipes janë të ndryshme dhe janë pasqyruar relativisht vonë në gramatikat e gjuhës shqipe. Ato kanë filluar nga mesi i shekullit XIX duke kaluar përmes dy rrymave: Në rrymën e parë hynë autorët e huaj, si: *Hahni*, *Dozoni*, *Weigandi* e ndonjë tjetër, të cilët e mohojnë plotësisht ekzistimin e kompozitave të mirëfillta të shqipes, mirëpo nga ana tjetër (rryma e dytë), dashamirët e gjuhës shqipe, të cilët u mbështetën në gjuhën popullore të shqipes dhanë një pasqyrim objektiv të fjalëve të përbëra. Si themelvënës të një tradite të tillë janë gramatikanët: K. Kristoforidhi, K. Cipo, A. Xhuvanit, S. Frashëri, N. Frashëri e ndonjë tjetër (Millaku, 2015).

NË VAZHDIM I CITOJ DISA MENDIME TË AUTORËVE TË HUAJ:

F. Boppi. Nuk i trajton fare kompozitat e shqipes.

J. G. Hahn. Në fjalorin dhe në gramatikën e tij, ka sjellë pikërisht kompozita që janë mjaft produktive për pasurimin e leksikut të shqipes, mirëpo ai nuk i kushtoi ndonjë kapitull të veçantë dhe shpreh pikëpamjen se në gjuhën tonë janë të rralla.

D. Kamarda. Në shqyrtimin e kompozitave të shqipes nisët gjithashtu nga mendimi i gabuar, se shqipja nuk është shumë e pasur me kompozita të mirëfillta. Ai thotë shprehimisht se një gjë e tillë e ka vë re edhe Boppi.

GJUHA E KURANIT

Kurani (i përkthyer) është i shkruar në shqipen standarde dhe respekton rregullat normative të saj. Fjalët dhe fjalitë janë të menduar e sistemuar me një sintaksë kodifikuese apo normative. Nuk mungojnë edhe rastet e riplotësimit dhe risistemimit si në aspektin drejtshkrimor, leksikor, morfologjik e sintaksor.

Fjalët e përbëra i ekonomizojnë fjalitë dhe janë me interes për lexuesin, por edhe ka të tilla që janë të reja për gjuhën shqipe, të cilat janë përdorur, por nuk janë vendosur në fjalorët shpjegues.

Në këtë studim nuk i kemi ndarë kompozitat këpujore dhe përcaktore të shqipes, mirëpo edhe nuk i kemi analizuar formimet e tyre, por e kemi ruajtur origjinalitetin e fjalës në përdorim dhe mundësinë e tyre për t’i studiuar në një rast tjetër, sepse ka raste se kërkohen edhe këshillime drejtshkrimore e morfo-sintaksore.

Në vazhdim e kemi tabelën e parë, e cila i prezanton 47 kompozita, të cilat janë të reja dhe si të tilla nuk janë në FEGjSh⁵: Të gjitha kompozitat janë të shkruara në formën origjinale të përdorimit të tyre në Kuran. Kurani është i pasur me përdorimin e fjalëve të prejardhura dhe me

Të gjitha kompozitat e cituara në këtë studim, të cilat janë në tabelën e parë janë të krahasuar me fjalorët ekzistues, mirëpo si të tilla, me kuptimësinë e përdorimit, si në Kuran nuk ekzistojnë, prandaj janë risi për gjuhën për ta pasuruar, por edhe kompozitat e tabelës së dytë janë me interes për ta shtuar kuptimësinë në fjalor.

kompozita, të cilat i ekonomizojnë fjalitë dhe i bëjnë më praktike dhe më të kuptueshme. Në vazhdim i prezantoj 229 kompozita, të cilat janë të përdorura në Kuran: *Surja El Fatiha – Kaptina 1* Mëshirëbërësit f.27, f.213; *Surja El Bekare – Kaptina 2*, I plotfuqishëm f.33, f.61, f.89, f.102, f. 123, f. 389; Vendkthimi f.48, Vendsigurie f.48, Vendfaljeje f.48, Vendmbjellje f.64, I gjithëfuqishëm f.65, f. 73, f. 421, Gjdhënie f. 66, Testamentojnë f.68; *Surja El Enfalë – Kaptina 8*, Ndëshkimfortë f.214; *Surja Hudë – Kaptina 11*, Vepërmirë f.260, Fatkëqinjve f.271; *Surja Jusuf – Kaptina 12*, Ujëbartësi f.276, Vendmbështetjeje f.278; *Surja El Hixhr – Kaptina 15*, I plotkuptueshëm f. 305; *Surja El Kehf – Kaptina 18*, Vendpritje f.350; *Surja Merjeme – Kaptina 19*, Gjithëmëshirshmit f.353; *Surja Sad – Kaptina 38*, Syperulura f.523; *Surja Fussilet – Kaptina 41*, Mëshirëbërësi f.547; *Surja Esh Shura – Kaptina 42*, Kryefshatin f.554; *Surja El Ahkaf – Kaptina 46*, Gjdhënia f.579; *Surja El Huxhuratë – Kaptina 49*, Mëkatfalës f.594; *Surja El Xhinn – Kaptina 72*, Vendvështimin f.674; *Surja El Insan – Kaptina 76*, Bashkëdyzuar f.684; *Surja Ali Imran – Kaptina 3*, Udhërefim f. 81; *Surja En Nisaë – Kaptina 4*, Fuqiforti f.123, Lajmgëzues f. 136; *Surja El Maide - Kaptina 5*, nesara-krishterë f.154; *Surja El En'amë – Kaptina 6*, Urdhërfyes f.173, f.192; *Surja El A'rafë – Kaptina 7*, Vendturpësinë f. 188, Katërdhjetë f.202, Punëmirëve f.206, f.281, Bashkëkohaniku f. 209; *Surja Ta Ha – Kaptina 20*, Symavijosur f. 367, *Surja Llukman – Kaptina 31*; Llukman f.469, f.471, Të plotbindur f.470; *Surja Es Sexhde – Kaptina 32*, Mëshirëbërësi f.475; *Surja El Ahzabë – Kaptina 33*, Sadakadhanësit f.483, Sadakadhënëset f.483; *Surja Sebe'e – Kaptina 34*, Mëkatfalësi f.490, f. 500, Myzhdedhënës f.493; *Surja Fatir – Kaptina 35*, Lajmgëzues f.500; *Surja En Nexhm – kaptina 53*, Fuqiforti f.609; *Surja El Muxhadele – Kaptina 58*, Mëkatfalës f.632; *Surja El Hashr – Kaptina 59*, Ndëshkimfortë f.635, *Surja El Mulk – Kaptina 67*, Vepërmirë f.659, Mëkatfalësi f.659.

PËRFUNDIMI

Fjalët e përbëra janë të mundshme për të qenë prodhimtare dhe si të tilla e pasurojnë gjuhën. Përkthimi i Kuranit është i shkruar në

gjuhën standarde dhe ka fjalë të përbëra të shqipes, të cilat shumë nga ato janë në fjalorët tonë të zakonshëm shpjegues, por ka edhe disa nga ato fjalë që janë të mundshme për të qenë të reja, ashtu siç janë prezantuar në tabelën e parë, të cilat me një kujdes të shtuar mund të sistemohen për përdorim, kurse në tabelën e dytë, dëshmojnë se në Kuran ka kompozita me interes për t'i studiuar, brumëzuar e për t'i dhënë formë kuptimore 'e plotësuese' polisemike. Kompozitat e prezantuara në tabelën 1 dhe 2 janë shembuj argumentues dhe me interes për t'i analizuar e studiuar, të cilat disa nga ato nuk ekzistojnë në fjalorët ekzistues (mirëpo edhe nëse do të jenë ekzistuese, ato mund të kenë variante polisemike, homonimike, sinonimike dhe si të tilla e pasurojnë leksikun e shqipes), andaj analiza e këtyre kompozitave do të mundësojë krijimin dhe pasurimin e fjalorit të shqipes me fjalë të reja dhe plotësuese.

Si përfundim mund të themi, gjitha fjalët që i përdorë shoqëria dhe në veçanti ato që janë përdorur në Kuran dhe si të tilla kanë zënë vend në paradigmat e shqipes, por që nuk e rrezikojnë sistemin dhe brumin e saj, për mendimin tim mund të pranohen dhe të sistemohen në fjalorët tonë shpjegues. Të gjitha kompozitat e cituara në këtë studim, të cilat janë në tabelën e parë janë të krahasuar me fjalorët ekzistues, mirëpo si të tilla, me kuptimësinë e përdorimit, si në Kuran nuk ekzistojnë, prandaj janë risi për gjuhën për ta pasuruar, por edhe kompozitat e tabelës së dytë janë me interes për ta shtuar kuptimësinë në fjalor.

- 1 Shkelqim Millaku, *Kërkime gjuhësore 3*, Prishtinë, 2024, f. 96.
- 2 Jani Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, f. 90.
- 3 Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 70.
- 4 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhë shqipe*; Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë 1972, f. 83.
- 5 FEGjSh – Fjalori elektrik i gjuhës shqipe.



Shteti i së drejtës në dritën e intencave të legjislacionit islam

SHTETI I SË DREJTËS – KONCEPTI DHE PRINCIPET

Shteti i së drejtës konsiderohet shteti, pushteti i të cilit themelohet në drejtësi,¹ dhe si nocion konsiston në përgjegjësinë e të gjitha subjekteve dhe institucioneve para ligjit, apo me fjalë të tjera, të gjithë i nënshtrohen ligjit, dhe asnjë nuk është mbi ligjin. Shteti i së drejtës përbën themelin dhe idealin e demokracisë. Ai është sinonim i krijimit të kuadrit të nevojshëm të mbrojtjes me ligj nga shteti i lirive dhe të drejtave elementare qytetare, pa bërë dallim mes tyre për shkak të racës, kombit, etnisë, religjionit, statusit ekonomik, social dhe kulturologjik. Kjo nënkupton edhe kufizime të caktuara për veprimin e shtetit, pasi administrata dhe institucionet kufizohen dhe duhet t'i përmbahen ligjit.²

Veprimet shtetërore që bazohen në parimet e shtetit të së drejtës, rezultojnë me besim të qytetarëve tek autoritetet dhe prirje për të bashkëpunuar si pjesë e së njëjtës shoqëri. Në mungesë të shtetit të së drejtës, individët priren të veprojnë në mënyrë të izoluar dhe individualiste. Shteti i së drejtës garanton një sistem ligjor funksional, i cili përcakton rregullat themelore, që organizojnë jetën shoqërore dhe siguron zbatimin e tyre në praktikë.

Principet themelore të shtetit të së drejtës, përmbledhen në sa vijon: Supremacia e ligjit; barazia para ligjit; liria dhe të drejtat themelore; ndarja e pushteteve; kontrolli gjyqësor, pavarësia e gjyqësorit; siguria juridike dhe pjesëmarrja demokratike.³

Pas përkufizimit të intencave të legjislacionit islam dhe shtetit të së drejtës dhe principet e tij, arrijmë në konstatimin se, sipas qasjes më gjithëpërfshirëse të intencave, shteti i së drejtës, si dhe bazat dhe principet e shtetit të së drejtës janë intenca të legjislacionit islam. Në vazhdim do t'i trajtojmë disa nga intencat e legjislacionit islam, që janë edhe principe të shtetit të së drejtës:

DREJTËSIA

Vënia e drejtësisë dhe gjykimi me drejtësi, përbën një nga intencat themelore të legjislacionit dhe mësimave islame në përgjithësi, që në mënyrë taksative shprehen në burimin primar të legjislacionit islam, gjegjësisht në Kuran. Kurani shprehet se shpalljet hyjnore dhe të dërguarit e Zotit kanë ardhur që të venë drejtësi, dhe që në mesin e njerëzve të gjykohej me drejtësi. Në Kuran qëndron: “*Ne i dërguam të dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne e zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t'i përmbahen njerëzit të së drejtës...*” (El Hadid, 25). Në një kaptinë tjetër në Kuran lexojmë se drejtësia është urdhër i Zotit: “*Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna...*” (En Nahl, 11). Ka edhe shumë vende tjera në Kuran, ku kërkohet drejtësi, dhe kjo formësohet në të gjitha nivelet dhe dimensionet e jetës: individual, familjar, komunitar, shoqëror, politik, ekonomik marrëdhëniet ndërkombëtare etj..

Bazuar në këtë, shumë dijetarë të shquar si: El Xhuvajni, El Izz ibnu Abdisselam, Ibën Tejmije etj., e kanë konsideruar

drejtësinë prej intencave të legjislacionit islam.⁴

Në këtë kontekst, dijetari i shquar, që njihet si pionier i fushës së intencave të legjislacionit islam në kohën më të re, Et Tahir ibën Ashuri, shprehet se intenca e përgjithshme e legjislacionit është mbrojtja e rendit dhe sistemit të bashkësisë. Ai shprehet: “Nëse ne i induktojmë burimet e legjislacionit islam që flasin për intencat e tij, nga argumentet e tërësishme dhe parcialet të induktuara të këtyre burimeve, na bëhet e qartë se intenca e përgjithshme e legjislacionit është mbrojtja e sistemit të bashkësisë, vazhdimësia e mirëqenies së bashkësisë përmes mirëqenies së llojit njerëzor, e kjo e përfshinë mirëqenien mentale, mirëqenien e punës së tij dhe të mirave të kësaj bote ku njeriu jeton, që gjenden në disponim të tij.”⁵

Drejtësia në vokabularin e burimeve islame dhe në terminologjinë e dijetarëve të cilët e kanë identifikuar atë si intencë bazë dhe të përgjithshme të legjislacionit islam, konsiston në sundimin e ligjit, detyrimin që të gjitha veprimet dhe vendimet e institucioneve shtetërore të jenë në përputhje me ligjin dhe që veprimet e autoriteteve publike të jenë komform ligjit.

Kjo intencë e legjislacionit islam në rrafshin e shtetit të së drejtës përfshinë disa principe themelore të tij, me theks të veçantë: Supremacinë e ligjit, e që aludon në atë se në shtetin e së drejtës ligji është mbi të gjitha dhe të gjithë qytetarët dhe autoritetet publike janë të detyruar ta respektojnë ligjin. Drejtësia përbën thelbin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimit demokratik në hierarkinë e principeve themelore të shtetit të së drejtës; kontrollin gjyqësor, i cili është thelbësor për të siguruar zbatimin e ligjit nga të gjitha institucionet; dhe ligjin si garanci kundër arbitraritetit.

NDARJA E PUSHTETEVE

Një nga principet themelore të shtetit të së drejtës është edhe ndarja e pushteteve. “Ky parim ka karakter organizativ dhe synon të garantojë që të gjitha pushtetet janë të kufizuara dhe i nënshtrohen një kontrolli. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve përbën në fakt thelbin e shtetit të së drejtës.”⁶

“Ne i dërguam të dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne e zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës...”

(*El Hadid, 25*).

Ndarja e pushteteve parandalon koncentrimin e autoritetit në një degë të pushtetit brenda shtetit, dhe siguron një sistem kontrolli dhe balancimi ndërmjet tyre. Në shtetin e së drejtës, pushtetet janë të ndara në tri degë: legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

Ndarja e pushteteve në kuptim të kontrollit dhe balancimit ndërmjet tyre është element thelbësor në mësimet islame, dhe kjo është praktikuar edhe nga vetë i Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe për rrjedhojë është edhe një nga intencat e legjislacionit islam në fushën e sistemit politik dhe rendit të shtetit.

Nga jeta dhe praktika e tij, kuptojmë se ai e ka etabluar ndarjen e pushteteve. Kështu, kur ka folur për pejgamberinë, ai është shprehur se çdo gjë që e thotë, është shpallje prej Zotit, dhe ka thënë: “*Më është dhënë Kurani dhe diçka si ai, bashkë me të*.”⁷ Me këtë ka aluduar në thëniet e tij. Por, kur ka qenë në cilësi të gjykatësit, ka treguar se gjykimi mes njerëzve është i ndarë nga pejgamberia. Gjatë gjykimit të një rasti, njëra palë e ka imponuar version e vet si rezultat i elokuencës dhe dominimit me fjalë mbi palën tjetër. Në këtë rast, në cilësi të gjykatësit, i Dërguari i Zotit ka gjykuar në bazë të prezantimit të provave nga palët, e që nuk e kanë pasqyruar realitetin e çështjes kontestuese dhe palën e cila ka të drejtë. Për



atë ka thënë: “Ndoshta dikush prej jush është më i aftë në prezantimin e provave nga tjetri, dhe unë gjykoj në bazë të asaj që më prezantohet.”⁸ Me këtë ai e ka vënë bazën ndarjes së pushteteve, pasi si Pejgamber ka thënë se çdo gjë i shpallet, ndërkaq si gjykatës, ka gjykuar në bazë të provave që i prezantohen. Këtu shihet thelbi i ndarjes së pushteteve, që është një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës.

Po ashtu, në cilësi të komandantit të ushtrisë, është konsultuar me shokët e tij për çështje që kanë të bëjnë me strategjinë e luftës, trajtimin e pengjeve dhe shumë gjëra të tjera. Sa për ilustrim do ta përmendim rastin në luftës së Bedrit dhe pozicionimin e ushtrisë, kur Habab ibën Mundhiri, njëri nga shokët e tij, i thotë: “A është ky pozicion urdhër i Zotit, apo vlerësimi yt personal?” Ai përgjigjet: “Ky është vlerësimi im personal.” Atëherë, ai i propozon vend tjetër për pozicionimin e ushtrisë, pasi ka qenë më i përshtatshëm dhe i Dërguari i Zotit e pranon.⁹ Edhe këtu e lexojmë parimin e ndarjes së pushteteve përmes cilësisë së diskursit të të Dërguarit të Zotit.

Nisur nga kjo, dijetarët islamë kanë diskutuar për dallimin mes veprimeve të të Dërguarit të Zotit. Kështu, El Karafi, nënvizon se i Dërguari i Zotit i ka bërë veprimet në disa cilësi, bazuar në qëllimin e vetë të Dërguarit të Zotit me këto veprime. El Karafi potencon se ka

“...dhe mos bëni
çrregullime në
tokë pas
përmirësimit të
saj...”

(El Arafë, 85).

dallim mes veprimeve të të Dërguarit të Zotit në gjykim-kada, veprimeve të tij në fetva-përgjigjeve fetare, dhe veprimeve të tij në udhëheqje. Për pasojë, edhe efektet e veprimeve të tij me këto cilësi në sheriat janë të ndryshme.¹⁰ Me këtë, El Karafi i ka identifikuar intencat e të Dërguarit të Zotit në role, veprime e thënie të ndryshme të tij.¹¹ Kuptimin e ri të intencave si intenca të të Dërguarit të Zotit në role, veprime e thënie, që vuri në dukje El Karafi, gjë që rezultoi me dallimin që ai i bëri mes veprimeve të të Dërguarit të Zotit, e ka zhvilluar më tej dijetari i shquar Et Tahir ibën Ashuri, duke i bërë këto dallime pjesë të teorisë së intencave-mekasid.¹²

MOS ABUZIMI ME PUSHTETIN!

Kontrolli i pushtetit dhe kufizimi i administratës shtetërore dhe autoriteteve publike me ligje, paraqesin gurin themeltar të sistemit demokratik dhe mekanizmat kryesore të shtetit të së drejtës për pengimin e keqpërdorimit të pushtetit. “Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të

normave kushtetuese. Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë, e jo vetëm madje, përbën një çështje me rëndësi thelbësore për vetë shtetin e së drejtës.”¹³



Fesadi është i ndaluar në Islam, dhe fesadi është nocion i gjerë, që e përfshinë korrupsionin dhe çdo formë të çrregullimit, përfshirë këtu edhe abuzimin me pushtetin. Në disa vende në Kuran, fesadi ndalohet në mënyrë taksative. Në Kuran qëndron: “...dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj...” (El Arafë, 85); “...dhe mos shkaktoni rrëmujë në tokë!” (Hud, 85).

I Dërguari i Zotit ka folur për amanetin si bazë e mbrojtjes së ligjshmërisë dhe pengimin e abuzimit me pushtetin. Bile, shkelja e parimit të amanetit, është tregues i fundit të botës dhe çrregullimeve të mëdha në shoqëri. I Dërguari i Zotit ka thënë: “*Kur të humb amaneti, prite fundin e botës*”. Beduini e ka pyetur: “O i Dërguari i Zotit, si humb amaneti?” I Dërguari i Zotit është përgjigjur: “*Kur gjërat do t’u besohen njerëzve jo kompetentë, prite fundin e botës*.”¹⁴

Kalifi i parë i myslimanëve, Ebu Bekri, i cili e udhëhoqi shtetin pas vdekjes së Profetit të Zotit, në fjalimin e tij të parë para masës, pas zgjedhjes për kalif, qartë e ka theksuar përcaktimin e tij për shtet të së drejtës dhe ndëshkimit e abuzimit me pushtetin. Ai, më këtë fjalim, ka deklaruar: “Nëse punoj mirë, mu bindni. Nëse punoj keq, më përmirësoni.”¹⁵ Me këtë, Ebu Bekri e betonoi përgjegjësinë dhe llogaridhënien e udhëheqësve të popullit, si dhe ndalimin e abuzimit të çdo lloji me pushtetin.

BARAZIA PARA LIGJIT

Barazia para ligjit përbën një nga principet bazë të shtetit të së drejtës. Kjo do të thotë se të gjithë qytetarët, pavarësisht statusit të tyre social, ekonomik apo politik, trajtohen njësoj para ligjit. Ky princip i shtetit të së drejtës ndalon çdo formë diskriminimi në zbatimin e ligjit.

Barazia para ligjit është një nga intencat e legjislacioneit islam që gjen shtrirje në burimet bazë të tij: Kuran, trashëgiminë profetike, si dhe në praktikën e zëvendësve të të Dërguarit të Zotit në udhëheqjen e shtetit.

Kështu, Islami e ka luftuar energjikisht diskriminimin e njeriut mbi çfarëdo baze qoftë. Kjo shihet qartë në tekstet kuranore që e afirmojnë gjenezën e përbashkët të njerëzve dhe respektimin e dinjitetit njerëzor. Me këtë rast, do të përmendim dy tekste të Kuranit që e vërtetojnë këtë pohim: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijjat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (El Huxhuratë, 13); “Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Adem (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.” (El Isra, 70).

I Dërguari i Zotit në shumë thënie të tij e ka konfirmuar gjenezën e përbashkët të njerëzve dhe ndalimin e diskri-

minimit të njeriut në çfarëdo baze. Në veçanti, këtë e ka theksuar me rastin e haxhit të lamtumirës, para mijëra haxhilerëve të tubuar, gjë që ka karakterin e proklamatës universale, si dhe me rastin e çlirimit të Mekës, kur në fjalimin e tij para njerëzve, i publikoi parimet islame për trajtimin e njerëzve dhe raportet e myslimanit me të tjerët. Me këtë rast, në mes të tjerash, pati deklaruar: “*Njerëzit janë bijë të Adem, e Ademi është krijuar prej dheut*.”¹⁶

Ebu Bekri, kalifi i parë i myslimanëve, e ka theksuar barazinë para ligjit si parim thelbësor të qeverisjes së tij në fjalimin para masës, pas zgjedhjes së tij për kalif. Ai ka thënë: “Vini re se i fuqishmi te ju është i dobët tek unë, derisa të marr hakun prej tij, ndërsa i dobëti te ju është i fuqishëm tek unë, derisa të marr hakun për të.”¹⁷ Me këtë, Ebu Bekri në cilësi të udhëheqësit të shtetit, proklamoi se përcaktimi i mësimave islame për shtet të së drejtës, funksionim të ligjit për të gjithë, dhe barazinë e njerëzve para ligjit, është objektiv kryesor i programit të tij qeverisës.

Pra, thënë përmbledhtas, principet bazë të shtetit të së drejtës, janë intenca të legjislacioneit islam, pasi i referohen mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe garantimit të prosperitetit, sigurisë, rendit dhe shanseve të njëjta në shoqëri.

- 1 Kulić, Živko & Mirko Kulić, *Uvod u pravo*, Evropski Univerzitet, Brčko, 2015, f.179.
- 2 Shih: Huber, Hans, *Rechtstheorie- Verfassungsrecht-Völkerrecht. Ausgewählte aufsätze 1950-1970*, Verlag Stämpfli & Cie AG, Bern, 1971, f.28.
- 3 Kulić, Živko & Mirko Kulić, vep. e cit., f.178.
- 4 Shih: Sidiki, vep. e cit., f.51.
- 5 Ibën Ashur, Et Tahir, *Mekasidu esh sheri’a el islamije*, Mektebetul istikame, Tunizi, 1366h, f.63.
- 6 Zaganjori dhe të tjerë, vep. e cit, f.28.
- 7 Hadithin e ka transmetuar Ebu Davudi në Es Sunen, libri i sunetit, nr.4604. Shih: El Karij, Nuruddin Alij ibën Sultan Muhamed, El Mul-la Alij, *Mirkatul mefatih sherh Mishkatil mesabih*, Darul fikr, Damask, 2002, vëll.I, f.246.
- 8 Hadithin e kanë transmetuar Buhariu dhe Muslimi në dy përmbledhjet e tyre të sakta-Sahihajn. Buhariu e ka transmetuar në librin e dispozitave, nr.7168, dhe Muslimi e ka transmetuar në librin e gjykimeve, nr.1713. Shih: El Karij, po aty, vëll.VI, f.2441.
- 9 Sallabi, Ali Muhamed, *Jeta fisnike e të Dërguarit*, përktheu: Driton Maxhuni, Fjala e Bukur, Prishtinë, 2019, vëll.II, f.14.
- 10 El Karafi, Sihabuddin, *El Furuk*, redaktuar nga: Halil Mensur, Darul kutub el ilmije, 1998, vëll.I, f.357.
- 11 Avde, Xhasir, *Intencat e sheriatit si filozofi e së drejtës islame-përfaqje sistemeshe*, përktheu nga gjuha arabe: Shaban Sulejmani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, 2020, f.45.
- 12 Po aty.
- 13 Zaganjori dhe të tjerë, vep. e cit, f.71.
- 14 Hadithin e ka transmetuar Buhariu në Sahihun e tij, libri: qetësimi i zemrës, kapitulli: Ngrija e amanetit, nr.6131. Shih: El Askalani, Ahmed ibën Alij ibën Haxher, *Fet-hul Bari sherhu Sahihil Buharij*, Daru Er Rejjan li et turath, Kajro, 1986, vëll.XI, f.342.
- 15 Sallabi, Ali Muhamed, *Biografia e Ebu Bekër Es Sidik*, përktheu: Driton Maxhuni, Fjala e Bukur, Prishtinë, 2020, f.182.
- 16 Ibën Hisham, *Es Siretu en nebevije*, El Mektebetu et tixharije, Kajro, vëll.IV, f.32.
- 17 Cituar sipas: Karadavi, po aty, f.59.



Aakd. Mehmet Halimi

“Bardhësitë e atdheut” – kryepërmendore e përmendoreve të atdheut tonë

“Shkruaj, se kur ke talentin dhe s’e përdorë, është krim.”
(Lasgush Poradeci)

Autori Afrim Mustafa na ka sjellë një vepër intelektuale e piramidale të bazuar në të thëna e të dhëna, në rrëfime e përjetime reale, në argumente e fakte konkrete historike. Me rastin e përrurimit të veprës serioze e dinjitoze, emblematike e enciklopedike para disa vjetësh, më 5 maj 2015, në Fakultetin e Studimeve Islame, duke iu drejtuar pjesëmarrësve të pranishëm të këtij përrurimi madhështor, unë pata shkruar: “Prania juaj e madhështon, e solemnizon dhe e kuptimson këtë tubim, duke e kurorëzuar një vepër kapitale dhe enciklopedike-historike të autorit Afrim Mustafa, i cili falë dëshirës së madhe dhe vullnetit të flakët,

duke investuar shumë mund, djersë e punë, duke kaluar shumë net pa gjumë, punoi vijimisht e intensivisht dhe arriti t’i tejkalojë të gjitha pengesat drejt synimit e qëllimit të caktuar, në realizimin e kësaj vepre madhore të historisë sonë kombëtare.

Fjala ime përshëndetëse u mirëprit me kureshtje të madhe e interesim të veçantë, gjë që e dëshmon edhe publikimi i saj në disa revista e gazeta. E, tani edhe pas kaq vitesh, me rastin e ribotimit të kësaj vepre të autorit në fjalë, ruaj të njëjtin respekt e ngrohtësi njerëzore, si ndaj autorit, po ashtu edhe ndaj veprës së tij, i cili shpreh e kultivon në këtë vepër simbolikën e bashkimit kombëtar, si ide, porosi e program të Rilindjes Kombëtare, të artikuluar e të kurorëzuar në Lidhjen Kombëtare Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), të cilin kur e pyetëm përse këtë vepër madhore kaq vëllimore nuk e keni ndarë në tri vëllime?, ai u përgjigj: “Tri ushtritë çlirimtare, UÇK-ja e Kosovës, UÇK-ja e Maqedonisë dhe UÇPBM-ja e Preshevës, Bujanocit dhe e Medvegjës, kishin një ide, një synim e një qëllim të përbashkët – çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare, ashtu, siç e kishte edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, fryma e së cilës, kurrë nuk u zbeh, as nuk u shua, që nga shekulli XIX e deri më sot, dhe se ajo nuk do të shuhet, derisa ideja e synimi dhe qëllimi programatik e politik i Lidhjes së Prizrenit të realizohet tërësisht.” Kjo ide frymon e vibron, tejpertej indit thelbësor në veprën integrale të autorit Afrim Mustafa, vepër kjo që përfaqëson një vlerë kapitale, emblematike dhe enciklopedike, e shkruar me një gjuhë të pastër e stil të rrjedhshëm e të latuar lapidar.



“Gjëja kryesore është të shkruash sa më tepër. Lapsi është krijuesi dhe mësuesi më i mirë dhe më i mrekullueshëm i të shprehurit” – (Ciceroni) dhe se “Lapsi është gjuha e mendjes” – (Servantesi). Ndërsa, shkrimtari ynë i shquar, Lazgush Poradeci këshillon: “Shkruaj, se kur ke talentin dhe s’e përdorë, është krim.” Madje, sipas këshillave dhe mësimet që janë evidentuar në literaturën islame, ngjyra apo lapsi me të cilën shkruan shkencëtari, ose shkrimtari është e barabartë me gjakun që derdh dëshmorë në fushëbetejë kundër armikut, për çlirimin e popullit e atdheut të vet.


Format dhe mënyrat e luftës për çlirim kombëtar janë të shumta dhe të nduarnduarta, por ne mund të dallojmë e të veçojmë tri mënyrat më të shquara, më thelbësore, më të rëndësishme e më përmbajtjesore, e këto janë: Lufta dhe rezistenca me dituri, me pasuri dhe me trimëri, me jetë me gjënë më të shenjtë e më të shtrenjtë të njeriut, që sakrifikon dhe flijon jetën e vet në luftën konkrete me armë në dorë, ballë për ballë me armikun, bie dëshmor, bëhet kurban dhe themel i lirisë së popullit dhe atdheut të vet, vdekja e të cilit nuk duhet quajtur vdekje. Sepse, ai ka fituar krenarinë e lavdinë, pavdekshmërinë dhe përjetësinë historike. Mirëpo, lufta nuk bëhet pa armë e pa pasuri, pa dituri e pa diplomaci dhe pa strategji, madje, këta janë faktorë bazë, që i paraprijnë, e zhvillojnë dhe udhëzojnë luftën konkrete në fushëbetejë.

Faik Konica, një intelektual i ditur e i ngritur, me nam e famë, një poliglot e diplomat i spikatur, shkrimtar e atdhetar i dalluar dhe i shquar, për t’u arsyetuar para popullit, me përvujtni e modesti, me përlësi e sinqeritet njerëzor tha: “Unë nuk jam njeri i luftës. Palla (shpata) ime është pena. Me këtë, përpigëm t’i ndihmoj atdheut.” Edhe, në fillim shekullin XXI, eprorët ushtarakë të KFOR-it, kur i shkuan Mehmet Gjevorit, autorit të abetares shqipe e flakadanit të arsimit kombëtar, e gjetën duke shkruar me laps në dorë në tavolinën e tij të punës, i trokitën në dritare dhe e pyetën: “A ke armë?” – “Po kam” – iu përgjigj Mehmet Gjevari. “Ku i ke armët?” – “Ja ku i kam”, - ngriti lapsin. Lapsi është arma ime, me të cilën, tërë jetën i kam ndihmuar popullit tim. Ata qeshën dhe shkuan.

Me këtë vepër
madhore
publicistiko-
shkencore të
historisë sonë
kombëtare,
autori i
nderuar,
Afrim Mustafa
e ka pasuruar
literaturën për
historinë tonë
kombëtare,
duke
përjetësuar
shumë beteja e
përleshje
kundër
armikut të
egër e barbar
serbo sllav dhe
i ka vënë në
bazamentin
faktiko-
historik.

Andaj, edhe autori i kësaj vepre madhore, i cili falë dëshirës së tij të madhe dhe vullnetit të flakët, diturisë së tij, prirjes dhe talentit për të shkruar, mjeshtëri i fjalës dhe i pendës, duke investuar shumë energji, mund e punë, duke punuar gjatë kohë, arriti t’i mposhtë, t’i mbizotërojë e t’i tejkalojë të gjitha pengesat, drejt qëllimit e realizimit dhe kurorëzimit të kësaj vepre intelektuale e piramidale të bazuar në të thëna e të dhëna, në rrëfime e përjetime reale, në argumente e fakte konkrete historike.

Mbështetur në faktografi historike, shkencore e publicistike, autori Afrim Mustafa me saktësi e përpikëri, me mjeshtri e dashuri, me seriozitet e dinjitet, si një kronikan i rryer e i vyer, që syrit të tij, nuk i shpëtoi asgjë, ai i përshkroi të gjitha ngjarjet e ndodhitë, të gjitha betejat e ushtarëve dhe eprorëve ushtarakë të të tri ushtrive çlirimtare, duke ndjekur çdo betejë, në çdo hap e në çdo vend, i bëri ngjarje e beteja të përjetshme, ushtarë e eprorë luftarakë e historikë, që do të zënë vend të çmuar dhe të merituar në historiografinë tonë të lavdishme mbarëkombëtare shqiptare. Në këtë mënyrë, autori, mbështetur në themelet e betejave të të tri ushtrive tona çlirimtare, ndërtoi një vepër të përkryer lapidare me vlera piramidale të historiografisë sonë kombëtare. Tash e tutje, kjo vepër do të shërbejë si një vepër bazë, që do t’ua lehtësojë punën kërkimore dhe shkencore historianëve tanë, që do të marrin mundimin e guximin, vullnetin e durimin dhe synimin, të merren me ndriçimin dhe studimin e betejave të të tri ushtrive tona çlirimtare në fjalë. Kjo vepër nuk mund të anashkalohet, por ajo do të shërbejë si pasurim e argument dokumentimi dhe citimi e dëshmi e betejave të zhvilluara. Me këtë vepër, autori, duke qenë edhe vetë një vlerë, krijoi një vepër me vlerë jo vetëm publicistiko-shkencore e historike, por edhe me vlerë artistike, sepse edhe historia është art. Duke pasur parasysh faktin se ngjarjet e ndodhitë, betejat e luftërat, nëse nuk shkruhen, ato nuk ruhen, por shlyhen në arkivin gojor e mendor. Sepse, kujtesa për to, mund të pësojë ndryshime e variantizime, ose zbehet e zhduket, krejtësisht. “Kujtesa është gjah, kurse shkrimi është kurth” (fj.u). Ashtu siç e zë kurthi gjahun e nuk e lëshon të ikë dot, po ashtu, edhe shkrimi e zë kujtesën dhe e



përjetëson. Me këtë vepër madhore publicistiko-shkencore të historisë sonë kombëtare, autori i nderuar, Afrim Mustafa e ka pasuruar literaturën për historinë tonë kombëtare, duke përjetësuar shumë beteja e përleshje kundër armikut të egër e barbar serbo sllav dhe i ka vënë në bazamentin faktiko-historik, shumë viktime e shumë dëshmorë e heronj, gjaku i të cilëve na solli lirinë, i ka bërë të pavdekshëm, sepse liria fitohet, ajo nuk dhurohet. Ajo është e shenjtë dhe shumë e shtrenjtë. Ndaj, me ndërgjegjësinë e përgjegjësinë më të lartë njerëzore e kombëtare, duhet ta çmojmë e ta gëzojmë, duhet ta ruajmë e ta vlerësojmë, siç i ka hije një populli liridashës e paqedashës. “Ne duhet të përpiqemi vijimisht e intensivisht, që ta ndërtojmë e lulëzojmë atdheun tonë, që të jemi të denjë e krenarë, që jetojmë në të, e nëse është nevoja, edhe të vdesim për të.” (Harri Fulc).

Afrim Mustafa ka bërë një punë serioze, shkencore dhe dinjitoze, humane e njerëzore dhe vepra e tij monumentale, mund të konsiderohet kryepër mendore e përmendoreve.

Populli ynë, qytetarët tanë, ashtu siç mburremi e krenohemi me luftëtarët, dëshmorët e heronjtë tanë, po ashtu, mburremi e krenohemi edhe me njerëzit e dijes e të pendës, të artit, të kulturës e të teknikës, që kanë shkruar dhe afirmuar vlerat historike dhe artistike, të kombit dhe të atdheut tonë. Sepse, shkolla shqipe, shkronjat e alfabetit shqip janë të lara e të shkruara me gjak. “Më vrisni, por lejoni, që gjaku im të shërbejë për ngjyrë, që t’i shkruani shkronjat e alfabetit shqip” (Petro Nino Luarasi). Autori, me punën e vet të lodhshme e të mundimshme, por të ngulmët, të vullnetshme e të ndërgjegjshme publicistiko-shkencore, fillimisht, krijoi idenë, (bëri skicimin skeletor), e hartoi planin e realizimit dhe të jetësimit të saj, i dha shije e kuptim, vlerë e qëllim kësaj vepre të dobishme e shumë të rëndësishme, për të gjithë pjesëtarët e hisedarët e kombit shqiptar, kudo që gjenden ata, në rruzullin tokësor, sepse të gjithë kontribuan në fitoren e lirisë.

Afrim Mustafa ka bërë një punë serioze, shkencore dhe dinjitoze, humane e njerëzore dhe vepra e tij monumentale, mund të konsiderohet kryepër mendore e përmendoreve.

Pra, me këtë vepër, autori, duke qenë edhe vetë një vlerë, ai krijoi një vepër me vlerë, jo vetëm publicistiko-shkencore e historike, por edhe me vlerë artistike, sepse edhe historia është art. Ndaj, në këtë rast e çast, mund të themi me plot gojën se, autori Afrim Mustafa ka bërë një punë të mirë

serioze, shkencore dhe dinjitoze, humane e njerëzore, me hartimin e kësaj vepre monumentale, që mund të konsiderohet kryepër mendore e përmendoreve. Andaj e përshëndesim sinqerisht, e përgëzojmë dhe e urojmë për zemërsisht për këtë vepër madhore, që përfaqëson një përmendore dokumentare me vlerë të lartë enciklopedike të historiografisë sonë kombëtare edhe me rastin e ribotimit e ndërplotësimit dhe pasurimit me vlera të shtuara faktografiko-historike.

Duke i uruar shëndet e vullnet, nxitje e cytje, dashuri e përsosmëri, nga autori presim për të na dhuruar edhe vepra të tjera me cilësi edhe më të lartë shkencore, me stil të rrjedhshëm, me gjuhë të pastër e të qartë të gjuhës sonë të ëmbël e të artë amtare.

Qëndrimi i diplomacisë turke ndaj pavarësisë së Kosovës

Dr. Nuridin Ahmeti

ROLI I TURQISË NË MBËSHTETJEN E KOSOVËS (1981-1999)

Turqia ka pasur një rol të vazhdueshëm dhe të shume anshëm në mbështetjen e popullit shqiptar dhe çështjes së Kosovës gjatë dekadave të fundit të shekullit XX. Duke nisur që nga vitet -80ta, interesimi turk për ngjarjet në Kosovë u shfaq qartë përmes mbulimit të ngjarjeve nga mediat turke dhe angazhimit të figurave diplomatike e intelektuale për të pasqyruar situatën e vështirë të shqiptarëve nën regjimin jugosllav. Në vitet e 90-ta, me shpalljen e institucioneve të para të

Republikës së Kosovës, Turqia forcoi mbështetjen e saj për Kosovën, duke pritur liderë si presidenti Ibrahim Rugova dhe kryeministri Bujar Bukoshi, dhe duke ofruar platforma diplomatike për njohjen ndërkombëtare të vendit.

Ndërhyrja e NATO-s dhe mbështetja aktive e Turqisë për fushatën e bombardimeve kundër forcave serbe e vendosën këtë shtet në vijën e parë të aleatëve strategjikë të Kosovës. Angazhimi turk nuk u kufizua vetëm në nivel diplomatik apo ushtarak. Komuniteti shqiptar në Turqi, shoqatat e tyre dhe media turke luajtën një rol të rëndësishëm në sensibilizimin

Ndërhyrja e NATO-s dhe mbështetja aktive e Turqisë për fushatën e bombardimeve kundër forcave serbe e vendosën këtë shtet në vijën e parë të aleatëve strategjikë të Kosovës.





e opinionit publik ndërkombëtar. Ky bashkëpunim dhe përkushtim ndaj çështjes kosovare u kurorëzuan me njohjen e menjëhershme të pavarësisë së Kosovës nga Turqia, duke ilustruar një partneritet të thellë dhe të qëndrueshëm mes dy vendeve.

ROLI I TURQISË NË MBËSHTETJEN NDËRKOMBËTARE DHE NË FORCAT E NATO-S

Në muajin korrik të vitit 1997, analisti i njohur turk Sami Kohen kishte dhënë një intervistë, ku në mes të tjerash ishte pyetur edhe për Kosovën se “çfarë ndikimi kanë ShBA-të dhe Turqia si aleate të NATO-s për zgjidhjen e çështjes së Kosovës?” “Turqia ka marrëdhënie shumë të mira me Amerikën, prandaj edhe në çështjen e Kosovës e udhëheq një politikë të njëjtë si ShBA”¹ - deklaroi në mes të tjerash z. Kohen.

Më 28 nëntor të vitit 1997, në varrimin e mësuesit Halit Geci, i cili u vra nga forcat serbe, doli publikisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Qëndrimet e Turqisë si një shtet anëtar i NATO-s ndaj këtij formacioni ushtarak do të jenë në linjë me ShBA-në.

Në fillim të muajit mars, më 5, 6 dhe 7 të vitit 1998, forcat ushtarake dhe paramilitare serbe, masakruan anëtarët e familjes Jashari në Prekaz të Drenicës. Ky veprim, i forcave ushtarake dhe paramilitare serbe në Prekaz dhe në viset e tjera të Kosovës, preku shumë shqiptarë gjithandej globit. Shpërthyen demonstratat në qendra të ndryshme të botës, në përkrahje të popullatës shqiptare të Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sikurse në shumë vende të botës, demonstrata u organizuan edhe në Stamboll dhe në qytete të tjera të Turqisë, në përkrahje të popullit shqiptar të Kosovës. Më 8 mars, në përkrahje të popullit shqiptar të Kosovës, organizohen protesta masive në Stamboll, ku marrin pjesë një numër i madh i qytetarëve.²

Lufta e UÇK-së është edhe njëra nga ngjarjet me më rëndësi historinë e vendin tonë, ku fillimisht faktori ndërkombëtar kishte hezitimet e veta ndaj kësaj organizate. Por me kalimin e kohës, kjo luftë fitoi përkrahjen ndërkombëtare dhe ndihma ndaj popullit të Kosovës nga faktori ndërkombëtar ishte konkrete, e cila u kurorëzua me ndërhyrjen e forcave të NATO-s. As në këtë rast, Republika e Turqisë nuk mbeti në anën e spektatorit, por u renditë në krah të atyre shteteve që morën pjesë në bombardimin e caqeve ushtarake e policore serbe në kudër të forcave të NATO-s, duke vënë në dispozicion edhe hapësirën e vet ajrore, tokësore dhe ushtarake në ndihmë të këtyre forcave. Ndërsa, siç dihet kishte edhe nga shtetet anëtare të NATO-s, siç ishte Greqia, e cila nuk lejoi hapësirën e vet ajrore dhe tokësore që të shfrytëzohej nga forcat e NATO-s, për t'i bombarduar caqet ushtarake dhe policore serbe, duke dashur që mos t'i prish raportet e mira që kishte me Serbinë.

Por, në lidhje me përkrahjen e Republikës së Turqisë ndaj luftës së fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të dhëna me interes ofron në ditarin e tij, ish-atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Ankara, kolonel Hajro Limaj, i cili këtë detyrë e kreu nga vitit 1994 deri në vitin 2000. Në kohën e luftës së Kosovës, ky e kryente detyrën e atasheut ushtarak të Shqipërisë në Ankara. Hajro Limaj, në ditarin e tij shënon se më 2 dhe 3 mars të vitit 1999, Pandeli Majko ish-kryeministër i Shqipërisë kishte arritur në Turqi për një vizitë zyrtare në krye të një delegacioni qeveritar nga Shqipëria. Problemi që ishte shtruar në këtë takim sipas Hajro Limajt ishte zgjidhja e krizës së Kosovës dhe mbrojtja e sovranitetit të Shqipërisë në rast të ndonjë sulmi eventual nga ushtria serbe. Në bisedë e sipër, shefi i shtatmadhorisë turke, gjeneral armate Hysejn Kevrekoglu, do të deklaronte se do ta mbështeste ushtarakisht Shqipërinë “ nëse ajo do të detyrohej të futej në luftë me Serbinë, për ta shmangur gjenocidin serb ndaj shqiptarëve të

Kosovës”³. Për me tepër, Hajro Limaj, në ditarin e shënon edhe këtë fakt se “nga të gjitha shtetet ku Shqipëria kërkoi mbështetje politike, diplomatike dhe ushtarake, për një ndërhyrje ushtarake të detyruar për mbrojtjen dhe çlirimin e Kosovës, i vetmi vend, që iu përgjigj pozitivisht ishte Turqia”.⁴ Ndërsa, pas takimit në shtatmadhorinë turke, gjithmonë sipas Hajro Limajt, Pandeli Majko ishte drejtuar atij dhe Luan Hajdargës që asokohe mbante postin e ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë se: “Turqia tregoi edhe këtë herë veten se është mikja dhe aleatja e vërtetë strategjike e Shqipërisë”.⁵ Në fund të muajit mars të viti 1999, Pandeli Majko e merr në telefon në Ankara Hajro Limajn, dhe e porositi që të kërkoi takim urgjent me kryeministrin e atëhershëm turk Bulen Exhevit se forcat serbe kanë bombarduar me artileri në Veri të Shqipërisë dhe të kërkohet nga ai që të dalë me një deklaratë në mbështetje të Shqipërisë. Edhe pse ishte festa e Bajramit dhe ishte pushim në Turqi, brenda ditës i ishte mundësuar takimi i Hajro Limajt me kryeministrin e atëhershëm turk Bulen Exhevit dhe, pas sqarimeve të nevojshme që i ofroi Hajro Limaj, kryeministri turk del te nesërmen me deklaratë të fuqishme në mbrojtje të Shqipërisë se: “Shteti dhe Forcat e Armatosura të Turqisë janë në krah të popullit vëlla shqiptar dhe nuk do të lejojnë askënd të prek kufijtë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë. Në rast nevojë, vazhdoi ai, Turqia do të mbrojë së bashku me Shqipërinë sovranitetin dhe pavarësinë e popullit mik dhe vëlla të Shqipërisë”.⁶

Me hyrjen e forcave të KFOR-it në Kosovë, forcat ushtarake turke vazhduan të japin kontributin e tyre në fushën e sigurisë në vendin tonë. Ndërsa në aspektin diplomatik hapën zyre ndërlidhëse në Prishtinë, e cila me rastin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, siç raportonte shtypi i vendin tonë, kjo zyre, së bashku me disa zyre ndërlidhës të vendeve perëndimore u shndërruan në ambasada.

NJOHJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS NGA REPUBLIKA E TURQISË

Se cili ishte qëndrimi i diplomacisë së Republikës së Turqisë në raport me njohjen e Republikës së Kosovës, u shpërfaq edhe në takimin zyrtar, përmes deklaratave që dhanë dy zyrtaret e dy vendeve, gjatë qëndrimit të delegacionit të vendit tonë në Turqi, para një viti.

“Turqia është një nga vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Atë kohë kam qenë duke drejtuar mbledhjen e kabinetit dhe ma komunikuan që ShBA-ja e kishte njohur si vendi i parë dhe thashë se ne do të jemi vendi

Turqia ishte
ndër vendet e
para që njohu
pavarësinë e
Kosovës,
menjëherë pas
ShBA-së.

i dytë që e njohim Kosovën”⁷- u shpreh në takim me kryeministrin e vendit tonë, ish-kryeministri i Turqisë, tani president, Rexhep Taip Erdogan në fjalimin e tij para gazetarëve. Në lidhje me këtë deklaratë, mbështetëse ishin edhe fjalët e kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, se “jemi gjithmonë mirënjohëse për rolin e Turqisë në intervenimin e NATO-s në Kosovë në vitin 1999, për ndaljen e gjenocidit mbi popullin e Kosovës e që solli çlirimin dhe paqen në vend; për kontributin e pakursyer në ndërtimin e institucioneve; shpalljen dhe njohjen e pavarësisë së Republikës sonë; dhe për mbështetjen e plotë e të pakursyer të Turqisë në politikën e jashtme”⁸.

Pra këto dy deklaratat, të dy zyrtarëve të dy vendeve, ishin vetëm një ri konfirmim i asaj që edhe shumë zyrtarë të te dyja vendeve, por edhe zyrtarë nga Shqipëria e kanë thënë në forma të ndryshme. Por përtej këtyre

deklaratave, duket se marrëdhëniet në mes të dy shteteve vazhdojnë të jenë të qëndrueshme.

Një ditë para leximit të deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, mediat e shkruar njoftonin se kishin informacione, se ndër shtet e para që do ta njohin shtetin e Kosovës janë ShBA, Gjermania, Anglia dhe Turqia. Ndërsa, me rastin e shpalljes së pavarësisë, Turqi u renditë me shtetet e para që e njohën shtetin e pavarur të Kosovës. Pas dy dite nga shpallja e deklaratës së pavarësisë, shtypi në vendin tonë i datës 19 shkurt, vuri në dukje se janë vendosur marrëdhënie diplomatike me ShBA-në, Britaninë, Francën dhe Turqinë. Gjithashtu, shtypi turk i bëri jehonë kësaj ngjarje, nga data 16 shkurt. “Sytë nga Kosova”- shkruante më datën 16 shkurt gazeta e njohur “Vakit”⁹ dhe tregonte për përgatitjet që janë bërë në Kosovë për ta festuar këtë ditë. Datën 17 shkurt, shtypi turk e vlerësonte si “Dita e pavarësisë së Kosovës”¹⁰, ndërsa me datën 18 shkurt, gazeta e njohur “Yeni Şafak”¹¹, kishte vendosur titullin në gjuhën shqipe “Kosova e pavarur”. Më 19 shkurt, shtypi në Turqi jepte lajmin në gjuhën turke me titull: “Kosova e pavarur”.¹² Jehona për këtë ngjarje në shtypin turk vazhdoi edhe në ditët në vazhdim me datën 20, 21 e 22 shkurt.

Në Kosovë i bëhej jehonë edhe deklaratës të ministrit të Punëve të Jashtme të Turqisë të asaj kohe Ali Babacan në lidhje me njohjen e Republikës së Kosovës nga ky shtet ku thoshte se “Republika e Turqisë e ka mirëpritur deklaratën së pavarësisë dhe kështu ka vendosur që ta njohë Republikën e Kosovës. Turqia i kushton rendësi avancimit të kuptimit të paqes afatgjate në Ballkan që ka vuajtur aq shumë viteve të kaluara dhe shpreson që pavarësia e Kosovës do të jetë një

mundësi për forcimin e stabilitetit dhe mirëbesimit ndërmjet vendeve të rajonit. Serbia ka rol të rëndësishëm dhe përgjegjësi për të ardhmen e Ballkanit. Turqia i kushton rëndësi përparimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të saj me Serbinë edhe në nivel bilateral e edhe rajonal. Turqia beson se sundimi i ligjit dhe vlerat universale të të drejtave të njeriut, demokracia dhe pluralizmi do të promovohen në Kosovë. Turqia beson që lidhjet e gjata historike, kulturore dhe njerëzore me Kosovën do të forcohen edhe më shumë. Turqia do të vazhdojë ndihmën dhe kontributin e saj për zhvillimet në Kosovë, thuhet, veç të tjerash, në deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Turqisë.¹³

Ndërsa më 22 shkurt jepet njoftimi në shtypin e Kosovës se Turqia zyrtarisht ka kërkuar lokacion për Ambasadë nga Komuna e Prishtinës.¹⁴ Por pas shpalljes së deklaratës së pavarësisë së Kosovës, diplomacia turke u tregua aktive në lobimin për njohjen e pavarësisë nga vendet e tjera. Këtë fakt e potencojnë edhe zyrtarët e Prishtinës, por edhe në Tiranë. Në vitin 2011, ish-presidenti i Shqipërisë Bamir Topi, gjatë një vizite zyrtare në Ankara, në një intervistë dhënë gazetës se njohur turke “Huriet”, e vlerëson me nota pozitive rolin e Turqisë në lobimin për njohje e Kosovës nga shtetet e tjera, të cilat nuk e kanë njohur vendin tonë.

REZYME

Nga vitet e 80-ta, roli i Republikës së Turqisë ka një vazhdimësi në mbështetje të popullit shqiptar në ish-Jugosllavi. Grupet atdhetare nga ish-Jugosllavia që vepronin në Turqi, nuk u ndoqën, u lanë të lirë për veprime.

Mbështetja në vitet e 90-ta për qeverinë e atëhershme të Kosovës edhe të presidentit të atëhershëm janë për t'u vlerësuar, në kohën mjaftë delikate për vendin tonë.

Pas viteve të 90-ta, pavarësisht se gjatë kësaj periudhe kishte kriza qeveritare në Turqi, ministrat e kryeministrat ndërroreshin, partitë e ndryshme kishin mosmarrëveshje për të lidhur koalicione qeverisëse, kushdo që vinte në pushtet, politika ndaj shqiptarëve e partive në pushtet ishte konstante, të gatshëm për përkrahje. Rrjedhimisht, kjo politikë shihet edhe me rastin e Kosovës gjatë këtyre viteve.

Gjithashtu, shoqatat e themeluara në Turqi nga shqiptarët të cilët jetonin dhe vepronin në Turqi, luajtën rol me rëndësi në lobimin për çështjen shqiptare¹⁵ dhe për Kosovën në veçanti.¹⁶ Këto shoqata bënë përpjekje në forma të ndryshme që ta sensibilizonin opinionin përmes shkrimeve të botuar e

protestave të organizuara e takimeve të ndryshme me diplomat të huaj të cilët vepronin në Turqi.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbështetja që Republika e Turqisë e dha në kuadër të forcave të NATO-s për popullin e Kosovës, mendoj se meriton mirënjohjen tonë.

Sigurisht, se njohja nga të parat vende të Republikës së Kosovës pa asnjë hezitim, flet edhe për përkushtimin e këtij shtetit ndaj Kosovës. Nga hulumtimi në shtypit turk që kemi bërë, na rezultojnë se nga data 16 shkurt, kur filluan të njoftonin në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, e deri me datën 22 shkurt u shkruan mbi 40 artikuj e njoftime. Pjesa dërmuese e artikujve këtë datë e paraqisnin si një datë historike për vend tonë. Duhet potencuar, se ky interesim i shtetit të Turqisë vjen edhe për shkak të komuniteti turk që ekziston në vendin tonë dhe sigurisht se ka interesat edhe veta.

Por, ajo që është për t'u potencuar se ky shtet, pavarësisht sfidave në të cilat ka kaluar, lobimin për njohjen e shtetit të Kosovës nga vendet e tjera, të cilat nuk e kanë njohur, nuk e ka ndaluar asnjëherë.

- 1 Burbuqe Rushiti, “Turqia në “trekëndëshin e djallit”, *Bujku*, 26 korrik, Prishtinë, 1997, f. 3.
- 2 N. Ç., “Shqiptarët e Turqisë do të luftojnë për Kosovën”, *Bujku*, 9 mars, Prishtinë, 1998, f. 8.
- 3 Hajro Limaj, *Midis Ankarasë dhe Tiranës 1990-2000-Nga ditari i një atasheu ushtarak*, Emal, Tiranë, 2012, f. 180.
- 4 *Po aty*.
- 5 *Po aty*.
- 6 Hajro Limaj, *Midis Ankarasë dhe Tiranës...*, f. 188.
- 7 “Erdogani i ofroi Kosovës mbështetje për anëtarësim në NATO e në Këshillin e Evropës”, *Koha ditore*, 4 shkurt, Prishtinë, 2023, f. 2.
- 8 “Fjala e plotë e kryeministrit Albin Kurti në Konferencën e përbashkët për media me presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan”, 3 shkurt, 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/fjala-e-plote-e-kryeministrit-albin-kurti-ne-konferencen-e-perbashket-per-media-me-presidentin-e-turqise-rexhep-taip-erdogan/>, (hulumtuar, më 4. 2. 2023).
- 9 “Gözler Kosova’da”, *Vakit*, 16 Şubat, 2008, f. 6.
- 10 *Milli Gazete*, 17 Şubat, 2008, f. 9.
- 11 *Yeni Şafak*, 18 Şubat, 2008, f. 10.
- 12 *Milli Gazete*, 19 Şubat, 2008, f. 17.
- 13 *Koha ditore*, 19 shkurt, Prishtinë, 2008, f.7.
- 14 *Koha ditore*, 22 shkurt, Prishtinë, 2008, f. 1.
- 15 Rexhep Rifati, “Shoqatat shqiptare-shtylla atdhetare”, *Bujku*, 7 nëntor, Prishtinë, 1994, f. 6.
- 16 Rexhep Rifati, “Lobi shqiptar-organizim i mundshëm në Turqi”, *Bujku*, 4 maj, Prishtinë, 1995, f. 7.



Dokumentimi i luftës në Kosovë – sfidat dhe ndërgjegjja kolektive

HYRJE

Lufta, si përvojë e tmerrshme që është përjetuar nga qytetarët e Kosovës, nuk është trajtuar asnjëherë mjaftueshëm në aspektin profesional si realitet yni kolektiv, në mënyrë që t'i adresonim pasojat traumatike dhe çrregullimet që ajo i ka shkaktuar në planin social e psikologjik. Nga ana tjetër, ajo as nuk është evidentuar mjaftueshëm në mënyrë institucionale, për çka ende na mungon ditari kolektiv dhe shtetëror i luftës, ndonëse ai mund të jetë i shpërndarë në copëza shënimesh e fotografish gjithandej Kosovës tek individë, organizata, institucione dhe media, apo edhe në kujtesën e njerëzve. Zbardhja e të vërtetës për viktimat dhe

vendosja e drejtësisë qëndrojnë ende pezull, ndër të tjera, edhe për shkak të kësaj vonese. Po ashtu, kjo vonesë shkakton pasojë serioze edhe për planin e pajtimit dhe për vendosjen e paqes së qëndrueshme, qëllime këto në të cilat insistohet shumë, veçanërisht nga qarqet ndërkombëtare. Nuk mund të ketë proces serioz për ndërtimin e paqes dhe pajtimit pa u ditur epilogu njerëzor, social, material e shpirtëror i pasojave të luftës. Ky epilog pastaj do të implikonte obligime reciproke të palëve të përfshira në konflikt për të ardhur kështu deri te pajtimi reciprok potencial.

Nevoja për dokumentim bëhet edhe më e domosdoshme kur dihet se lufta ishte një përpjekje sitematike e Serbisë për spastrim

Nuk mund të ketë proces serioz për ndërtimin e paqes dhe pajtimit pa u ditur epilogu njerëzor, social, material e shpirtëror i pasojave të luftës.



etnik. Raporte të ndryshme ndërkombëtare kanë nënvizuar këtë fakt: “Ofensiva e qeverive serbe dhe jugosllave në Kosovë që filloi më 20 mars 1999, vetëm katër ditë para se të fillonte bombardimi i NATO-s, ishte një fushatë metodikisht e planifikuar dhe me pasoja fatale për popullsinë vendase të Kosovës. Shkarkime dhe emërime të rëndësishme në aparatin e sigurimit të Jugosllavisë nga fundi i vitit 1998, përfshirë kreun e sigurimit shtetëror serb dhe shefin e shtabit të përgjithshëm të ushtrisë, të bëjnë të mendosh se përgatitjet për ofensivën po bëheshin në atë kohë. Në fillim të vitit 1999, u vu re përqendrimi ushtarak i konsiderueshëm në Kosovë dhe armatosja e civilëve serbë. Aksionet policore e ushtarake nga fundi i shkurtit dhe fillimi i marsit në rrethinat e Vushtrrisë dhe Podujevës, të emërtuara nga qeveria “stërvitja e dimrit” siguruan lidhjet hekurudhore dhe rrugore të Veriut të Kosovës me Serbinë. Edhe ofensivat e mëparshme qeveritare ishin të shoqëruara nga dhunime serioze të ligjit humanitar ndërkombëtar...”¹

DOKUMENTIMI SI PROCES KOMPLEKS NDËRMJET DISIPLINAVE TË NDRYSHME

Dokumentimi i krimeve të kryera gjatë luftës është një proces kompleks shkencor dhe organizativ. Ai përfshinë një gamë të tërë konceptesh, qasjesh e praktikash, që burojnë nga disiplinat juridiko-ligjore, shkencore, historike, ekonomike, sociologjike e psikologjike. Përderisa evidencat penale, ushtarako-policore dhe mjekësore, ndonëse kanë një rëndësi jetike në procesin e dokumentimit dhe operojnë brenda misionit të njëjtë për drejtësi e paqe, fokusohen në respektimin e ligjeve, ndëshkimin e individëve ose grupeve konkrete që kanë kryer krime, përshkrimin e urdhrave dhe hierarkisë, përkatësisht çështjet forenzike e mjekësore, evidencat dhe qasjet shkencore të përpiluara e përpunuara nga institutet apo qendrat për hulumtimin e këtyre krimeve synojnë arritjen e një procesi më të ndërlikuar historik e moral: zbardhjen e të vërtetës historike dhe ruajtjen e kujtesës kolektive. Ndonëse të dyja këto qasje janë kompatible, që e plotësojnë njëra-tjetrën, secila ka specifikat dhe rëndësinë e vet brenda një konteksti të caktuar socio-politik e rrethanor. Evidencat penale ndihmojnë në kompletimin e dosjeve të një instituti lidhur me dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës, ashtu siç ndihmojnë dosjet me të dhëna dhe analiza të një instituti për të mësuar detaje

shtesë të një konteksti të krimit, i cili potencialisht është objekt i hetimit penal. Ky ndërveprim ndërmjet disiplinave po ashtu do ta bënte të mundur që në krye të herës vënien e standardeve shkencore e metodologjike për klasifikimin e krimeve që kanë ndodhur në atë periudhë si: krime kundër njerëzimit, krime të gjenocidit, krime të luftës, krime psiko-sociale, masakër, vrasje masive, dëbim me dhunë, krime ndaj ambientit apo krime ndaj pronës kulturore e shpirtërore. Prandaj rruga e dokumentimit të krimeve të kryera gjatë luftës kalon nëpërmjet një procesi koordinimi të ngushtë ndërmjet këtyre kategorive apo segmenteve institucionale. Shteti dhe shoqëria mund ta ketë një ditar kolektiv rreth asaj që ka ndodhur vetëm në sajë të punës së përbashkët dokumentuese e hulumtuese ku përfshihen qasjet dhe perspektivat penale-ligjore, shkencore, historike, sociologjike dhe psikologjike, madje edhe në sajë të një ndërveprimi ku takohen perspektivat institucionale me ato personale/individuale.

SFIDAT E DOKUMENTIMIT NË RASTIN E KOSOVËS

Në rastin e Kosovës, procesi i dokumentimit dhe hulumtimit sistematik të krimeve të kryera gjatë luftës së vitit 1998-1999 karakterizohet me një tipar tejet shqetësues: vonesën. Prandaj në kontekstin e Kosovës, sfida e parë që paraqitet është vonesa e nismave serioze nacionale për ta realizuar këtë proces. Ndonëse ndër vite ka pasur iniciativa ndërministrorë e ndërkomunale për ta filluar evidencën e krimeve në fjalë, procesit i ka munguar vazhdimësia dhe shtrirja e gjerë institucionale-shtetërore, apo vendosja në një hierarki të lartë shtetërore që do ta bënte çështjen më serioze dhe më llogaridhënëse. Ndonëse jo në nivel të kënaqshëm kuantitativ dhe organizativ, Kosovës nuk i mungojnë faktet, dëshmitë, fotografitë, dokumentet, video-incizimet e ditarët personalë, të cilët ruajnë të dhëna me vlerë për të vërtetat që kanë ndodhur gjatë luftës. Edhe pse Kosovës i ka munguar një sistem dhe nivel i tillë i dokumentimit dhe hulumtimit, janë për t'u respektuar nismat dhe punët e disa individëve, organizatave, institucioneve dhe mediave që kanë punuar në këtë fushë e materialet dhe dosjet e të cilëve, krahas atyre nga mekanizmat e sigurisë dhe ligjit, mbeten trashëgimia pothuajse e vetme dokumentuese që nga viti 1999. Këto dosje kanë një vlerë jetike për ndërgjegjen tonë kolektive dhe procesin e paqes dhe

Shteti dhe shoqëria mund ta ketë një ditar kolektiv rreth asaj që ka ndodhur vetëm në sajë të punës së përbashkët dokumentuese e hulumtuese ku përfshihen qasjet dhe perspektivat penale-ligjore, shkencore, historike, sociologjike dhe psikologjike.



drejtësisë. Por ato materiale janë të shpërndara (në kuptimin fizik) në qytete, fshatra e madje edhe shtete të ndryshme, nëpër zyre, shtëpi, bodrume e shoqata. Po ashtu, ato nuk janë unike dhe standarde në formën e evidentimit dhe ruajtjes, karakterizohen me heterogjenitet metodologjik e arkivistik. Prandaj vonesa shprehet pikërisht këtu, në sistematizimin dhe unifikimin e tyre sipas një sistemi shkencor e arkivistik dhe në hulumtimin e tyre. Duke i pasur parasysh këto fakte rreth decentralizimit dhe shkarjes së dosjeve në nivel hapësinor e metodologjik, në fazën aktuale, urgjenca kombëtare duhet orientuar drejt konstituimit të një qendre nacionale e cila bën grumbullimin, verifikimin, përpunimin, sistematizimin, arkivimin dhe analizën e hulumtimin e këtyre dosjeve të krimeve të kryera gjatë luftës. Kështu ndërtohet qendra kombëtare e dokumentimit dhe kujtesës së përvojës sonë kolektive, e cila do të ishte referenca jonë kryesore për të vërtetën historike.

MOMENTE NGA RETROSPEKTIVA

Përveç vonesës, janë edhe disa sfida serioze në rrugën e dokumentimit. Urgjencat politike janë një faktor me peshë në këtë proces. Shikuar kronologjikisht, bindja dhe atmosfera dominante në shoqëri dhe krerët shtetërorë pas përfundimit të luftës nuk ishte ajo e një ballafaqimi serioz me atë që kishte ndodhur rishtazi, por ndërtimi i një rendi dhe kushteve të reja pas çlirimit. Kjo sigurisht se i ka arsyt e veta psikologjike e sociale, por këtij procesi i ka vënë shtysë të madhe edhe urgjenca ndërkombëtare për ta krijuar një ambient paqësor, të sigurt dhe një shoqëri e shtet që shikon nga e ardhmja. Kjo qasje, ndonëse ka ndihmuar Kosovën në shumë procese për

të zënë hapin me vendet e rajonit, ka lënë pasojat e veta dhe ka lënë shoqërinë e shtetit tonë pa e përmbyllur një proces: ballafaqimin sistematik me të kaluarën dhe vendosjen e drejtësisë. Urgjencat në agjendën politike pastaj kanë vazhduar të jenë prapë të një natyre të tillë që sheh nga e ardhmja, kryesisht që burojnë nga nevoja imediate për konsolidimin dhe forcimin e shtetit.

Mospendimi dhe ngurrimi vazhdueshëm i Serbisë për të bashkëpunuar në këtë fushë dhe insistimi i saj për të mbrojtur, justifikuar e strehuar kriminelët, paraqet një problem tjetër që ka privuar edhe institucionet e drejtësisë për të zbardhur rastet e krimeve kundër civilëve. Për më tepër, ajo as nuk distancohet nga masakrat e kryera nga ushtria, policia dhe paramilitarët e saj në Kosovë. Përkundrazi, ajo ende vazhdon të mbajë gjallë kërcënimin e hapur e permanent ndaj Kosovës, me tone lufte e agresioni klasik.

Mungesa e kapaciteteve shtetërore për ta evidentuar saktë luftën, humbjet njerëzore dhe dëmet materiale ishte një pengesë tjetër që ka ndikuar në ngecjen apo vonesën e procesit të dokumentimit dhe hulumtimit sistematik të pasojave të luftës.

Shkatërrimi dhe nevoja imediate për rindërtim ishte një faktor tjetër i cili ka ndikuar që ky proces të shtyhet për periudhat mëvonshme derisa kur një ditë të paraqiteshin sfida kryesore, siç është distanca kohore, humbja e dëshmitarëve, zbehja e kujtesës etj..

Instituti si mënyrë e adresimit shtetëror e shoqëror të dokumentimit

Puna që është realizuar deri sot nga segmente të ndryshme të shoqërisë meriton respekt dhe mbetet si trashëgimi e vlefshme për proceset e mëtejme të dokumentimit. Kjo vlen si për nismat shtetërore, aq sa kanë qenë, si për individët, familjet e organizatat. Por tani duket të jetë një momentum i ri për këtë proces. Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, i themeluar me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në këtë kuadër, përbën një moment të rëndësishëm institucional e kolektiv.

Nisur nga përvoja e vendeve të tjera, këto qendra/institute zakonisht insistojnë në respektimin e standardeve ndërkombëtare të evidentimit, hulumtimit dhe publikimit, në mënyrë që të dhënat dhe analizat e tyre të jenë valide e të përdorshme për instanca të ndryshme vendore e ndërkombëtare dhe të aplikueshme në rrethanat e reja të teknologjisë informative e madje edhe të inteligjencës artificiale. Dokumentimi që respekton këto procedura bën të mundur edhe shndërrimin e dosjeve arkivore të luftës në referencë shkencore për akademinë e universitetin, e po ashtu edhe në dëshmi valide shtesë e të verifikuar për proceset e tjera juridike e penale. Pra do të ishte një referencë për drejtësinë, universitetin/akademinë, artin e letërsinë. Në rrethanat ideale, një institut apo qendër nacionale e dokumentimit, përveç misionit dokumentues, mision tjetër ka edhe sensibilizimin shoqëror për atë që ka ndodhur dhe për nevojën e vendosjes së drejtësisë.

Mungesa e një qendre nacionale të dokumentimit - pasojat në narrativen e luftës dhe kulturën memoriale

Mungesa e një qendre të tillë nacionale ka lënë mundësinë që narrativi/rrëfimi për luftën të jetë jo i konsoliduar mjaftueshëm, i segmentarizuar, jo i menduar mirë në aspektin psiko-social, vleror e as në atë diplomatik. Narrativi i luftës është zhvilluar pothuajse spontanisht e kuturu, madje edhe atëherë kur ka pasur një mbikëqyrje dhe përkujdesje për të, shpesh kanë munguar qasjet adekuate psiko-sociale, kreativiteti artistik e estetik dhe orientimi në frymën e duhur të kujtesës. Në nivelin e kulturës memoriale janë krijuar modele që shpesh kanë probleme me shijet artistike, arrijtjet e kohës moderne në art e teknologji dhe madje me ekspozimin real të situatave dhe individëve të rënë gjatë luftës. Studimet e thella për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë luftës, nga perspektiva e disiplinave të ndryshme dhe jetësimi i atyre

Duke pasur parasysh një epilog të tillë, dokumentimi i krimeve në fjalë i dedikohet një fati kolektiv dhe një tragjedie të viktimave, dhe ai, krahas objektivave ligjore e procedurale, ka për bazë ndërgjegjen njerëzore dhe principet morale.

studimeve në regjistrin shtetëror, në art, kulturë, teatër, film, libra të historisë, kulturë memoriale etj., do të mënjanonin në masë të madhe këto dy probleme që shpesh kanë njollosur kujtesën tonë për luftën.

DOKUMENTIMI SI MISION KOLEKTIV

Nga statistika të ndryshme del se mbi 13 mijë civilë duke përfshirë fëmijë, gra e pleq janë vrarë gjatë luftës në Kosovë. Një raport i Departamentit Amerikan të Shtetit në dhjetor të vitit 1999 rikonfirmon si në vijim: “Më shumë se 1.5 milionë shqiptarë të Kosovës, të paktën 90% e popullsisë së përllëguar të shqiptarëve të Kosovës në vitin 1998 u dëbuan me forcë nga shtëpitë e tyre. Dhjetëra mijëra shtëpi në të paktën 1200 qytete dhe fshatra kanë pësuar dëmtime ose janë shkatërruar. Gjatë konfliktit, forcat dhe paramilitarët serbë zbatuan një fushatë sistematike për pastrimin etnik të Kosovës...”² Duke pasur parasysh një epilog të tillë, dokumentimi i krimeve në fjalë i dedikohet një fati kolektiv dhe një tragjedie të viktimave, dhe ai, krahas objektivave ligjore e procedurale, ka për bazë ndërgjegjen njerëzore dhe principet morale. Duke qenë i tillë, dokumentimi është një mision kolektiv dhe individual njëkohësisht. Secili individ që ka përjetuar luftën, dhunën, shpërnguljen, burgosjen a torturën është një arkiv në vete për dokumentim. Secili qytetar, secili njeri mund të ndihmojë në plotësimin e mozaikut të së vërtetës sonë historike, qoftë me rrëfimin dhe kujtesën e tij, qoftë me shënimet e ditarin personal, qoftë me dokumente, fotografi e

video-incizimet që i ka siguruar, koleksionuar, mbledhur e ruajtur deri më sot. Duke e forcuar dhe konsoliduar kujtesën, e bëjmë edhe më të fortë tregimin tonë për luftën dhe fitoren. Në prag të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, – kjo ese le të jetë një zë mbështetës e sensibilizues për nevojën e një ditari shtetëror e kolektiv për vrasjet, dhunën dhe dëbimet e popullatës civile, djegiet dhe shkatërrimet e shtëpive, ekonomive familjare, xhamive, kishave dhe teqeve, dhe për shkatërrimin e trashëgimisë intelektuale e artistike nga forcat serbe në Kosovë gjatë vitit 1998-1999.

1 Raporti *Nën pushtetin e urdhrave: Krimet e luftës në Kosovë* (Human Rights Watch, 2002), 3-4.

2 Raporti *Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting* (U.S. State Department Report 1999), 3.



Projekti “Bota Serbe” (“Srpski svet”) është një projekt destabilizues për Ballkanin

Ideja “Bota Serbe”, të cilën tash e disa kohë është duke e proklamuar ish-ministri i Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandër Vulin, është ide të cilën ai e ka ripërsëritur edhe më 18 korrik të vitit 2021. Në shek. XXI, ishte zyrtari i parë shtetëror serb që plasoi këtë koncept politik shovinist, kurse si ide i pari që e plasoi këtë koncept politik shovinist ishte Zharko Llazareviq, më pastaj Petar Niketiç në vitin 1881, më pastaj është botuar gazeta “Srpski svet” në Beograd në vitin 1908, ndërsa në vitet 1913-1914 është botuar gazeta javore “Srpski svet”.

Ky koncept shovinist e kthen Serbinë në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar dhe është formë e kërcënimit për sigurinë e vendeve të

rajonit. Të tilla janë edhe vlerësimet e njohësve ndërkombëtarë të çështjeve të sigurisë. Projekti “Bota Serbe”, si koncept politik, për herë të parë në shek. XXI u përmend në shtator të vitit 2020 dhe që nga ajo kohë, në Ballkanin Perëndimor ka pasur paralajmërime se ajo frazë rikujton aspiratat ekspansioniste të politikës zyrtare serbe, e cila politikë, kishte rol kyç në shpërbërjen e përgjakshme të ish-Jugosllavisë në fillim të viteve 1990. Në fakt, prapa projektit “Bota Serbe” fshihet projekti për “Serbinë e Madhe”, projekti ky i ngjashëm sikurse ai “Bota Ruse” ideolog i së cilës është mendimtari dhe bashkëpunëtori i afërm i Putinit dhe ultra nacionalisti rus, Aleksandër Dugin.¹



Në raportin vjetor të publikuar më 27 shtator 2021, Agjencia e Inteligjencës në Kroaci thekson se ky është një koncept i mbështetur nga Rusia për ta destabilizuar më shumë Ballkanin Perëndimor.



Proklamues i projektit “Bota Serbe” nga ana e zyrtarëve shtetëror serb ka qenë Aleksandër Vulin derisa ishte ministër i Mbrojtjes i Serbisë, i cili e plasoi këtë ide më 26 shtator të vitit 2020. Ideja themelore është që derisa “Serbia e Madhe” mbetet një ëndërr, “Bota Serbe” mund ta zëvendësojë atë, ose serbët duhet të presin një ose dy dekada derisa të mund të jetojnë në një shtet të vetëm, por që gjithmonë do ta mbajnë të bashkuar “Shpirtin Serb”. Ekspertët ndërkombëtarë shprehin shqetësime se duke pasur parasysh atë që ndodhi në vitet e 90-ta, është e qartë se kjo gjithmonë do t’i bëjë fqinjët e Serbisë jashtëzakonisht nervoz, sepse ajo është një ide destabilizuese. Në raportin vjetor të publikuar më 27 shtator 2021, Agjencia e Inteligjencës në Kroaci thekson se ky është një koncept i mbështetur nga Rusia për ta destabilizuar më shumë Ballkanin Perëndimor.²

Ky projekt i ri, i cili, në vitet e ardhshme pretendon të jetë një program ekspansionist serb, për bashkimin e të gjithë serbëve në një shtet, dëshmon se në politikat shtetërore serbe, asgjë nuk ka ndryshuar, andaj rajoni mbetet i rrezikuar nga ambiciet imperialiste të Serbisë. Ky është një vazhdim i diskursit të viteve të 90-ta, të kohës së regjimit gjenocidal të Milloshoviqit, e cila politikë, shkaktoi luftërat me pasoja tragjike.³ “Bota Serbe” nuk është projekt kulturor, por thjesht politik me aspirata territoriale ndaj fqinjëve që, nëse nuk merr përgjigjen e duhur ndërkombëtare, do të shkojë drejt një lufte të re ballkanike.

Për realizimin e projektit serb të quajtur “Bota Serbe” Serbia ka mbështetje të aleatëve të saj, posaçërisht të Rusisë. Serbia, për ta jetësuar këtë projekt, ka mbështetje nga të gjitha shërbimet ruse dhe diplomacia ruse, si dhe nga kisha ortodokse ruse. Patriarku i Rusisë, Aleksis 2, që kishte pritur delegacionin e kryesuar nga ish-presidentit Tadiq, deklaroi se Zoti na ka caktuar ne rusëve t’u qëndrojmë pranë miqve tanë dhe ne po i demonstrojmë botës lidhjet e ngushta mes dy kishave.⁴

Diplomacia serbe për t’i realizuar synimet e saj ekspansioniste dhe posaçërisht për ta realizuar projektin “Bota Serbe” dëshiron ta ndjek diplomacinë e saj duke pas raporte

të mira me Lindjen dhe Perëndimin. Udhëheqja dhe vizioni i Shën Savës janë me rëndësi qendrore për popullin serb, koncepti i të qenit midis Lindjes dhe Perëndimit, i identifikuar që në formacionet e para shtetërore, është perceptuar si veçanti e shteteve serbe dhe është një pjesë thelbësore e saj se kush është sot kombi serb. Konceptin diplomatik të Shën Savës, Serbia e ka zhvilluar në vazhdimësi, e sidomos tani këtë fillim shekulli, ku Serbia ka partner dhe aleat nga Lindja dhe Perëndimi.⁵

Për t’u jetësuar “Bota Serbe”, synon ta shfrytëzojë pozitën e mirë gjeostrategjike që ka Serbia. Karlo Jean, në punimin e tij “Gjeopolitika”, identifikon si faktor gjeografik përcaktues të gjeopolitikës së shekullit XX hapësirën, pozicionin, largësinë dhe natyrën kontinentale apo detare të një shteti. Në përforsim të këtij përcaktimi është edhe mendimi i Morgen Thau, i cili pohon se vendndodhja gjeografike mbetet faktor themelor, me rëndësi të përhershme, që politika e jashtme e të gjitha vendeve duhet ta marrin parasysh, sado i ndryshëm që mund të jetë sot ndikimi i saj mbi vendimet politike nga sa ishte në periudha të tjera historike. Me fjalë të tjera, në të shkuarën, dimensionin territorial i gjeopolitikës ka dominuar mbi faktorët e tjera, ndërsa sot, edhe pse zhvillimi i teknologjisë ka zvogëluar rëndësinë e dimensioneve natyrore dhe sidomos të hapësirës, territori përsëri mbetet përcaktues.⁶

Pushteti jugosllav në vitin 1959 kishte bërë ndryshime, respektivisht këmbime territorial ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me synim që të krijoheshin balance të reja demografike dhe strategjike. Kështu në këtë vit, pa konsultime me palën kosovare, Leposaviqi, Leshaku dhe Zubin Potoku i bashkohen Kosovës, ndërsa nga Kosova shkëputet dhe i bashkohet Serbisë, Lugina e Preshevës (Medvegja, Bujanoci dhe Presheva), përderisa veriu i Kosovës ishte me shumicë me popullatë serbe, Kosova Lindore (Lugina e Preshevës) banohej kryesisht me shqiptarë. Në pikën strategjike të Leposaviqit, bëhet ndërprerja e lidhjeve dhe komunikacionit ndërmjet Evropës dhe Lindjes së Afërme: Vjenë-Zagreb-Banjallukë-Sarajevë-Vishegrad-Mitrovicë-Prishtinë-Shkup-Selanik.

Bashkimi i Lindjes së Kosovës me Serbinë kishte për qëllim që shqiptarët mos t’i bllokoni korridoret e Serbisë në drejtim të Maqedonisë dhe të Greqisë, të mbanin nën kontroll të gjitha pikat strategjike (Bjelluha, Leposaviqi, Mitrovica, Kosova Lindore apo Lugina e Preshevës), si synim kishin ekspansionin pansllav.⁷

Pra, nisur nga pozita që zotëron zona e Luginës së Preshevës, ajo vlerësohet si hapësirë e rëndësishme

gjeostrategjike, sepse ajo çdo ditë e më shumë është duke u kthyer në një nyje në të cilën lidhen interesat rajonale ballkanike. Korridori X, që çon drejt Shkupit dhe Athinës shumë shpejt do të bashkohet me autostradën e Anamoravës në Kosovë, që është duke u ndërtuar nga Republika e Kosovës. Kjo autostradë do të lidhë drejtpërdrejt zonën me detin e Adriatikut, Shqipërinë, Malin e Zi, Sanxhakun e Pazarit të Ri (Novi Pazarit), Bosnjë e Hercegovinën dhe të tjera. Gjithashtu, aspekti ujor i Luginës veçohet për nga rëndësia e madhe, ngase aty pritet të zë fill njëri nga megaprojektet gjeostrategjike e gjeopolitike jo vetëm rajonale, por edhe ndërkontinentale. Tash është e qartë se Serbia pa këtë trevë të pushtuar shqiptare nuk mund të mbijetoj as si fuqi rajonale e as si fuqi ekonomike. Serbia i ka humbur shpresat e lidhjes me detin, një ambicie e kahershme e saj, ndërsa rajoni i Luginës së Preshevës me pozitën e favorshme ujore mes lumenjve Morava dhe Vardari, për interesat gjeostrategjike serbe, paraqet një mundësi reale për dalje në detin Egje përmes lundrimit nga Danubi, nëpërmjet lumit Morava dhe duke kaluar në Maqedoninë Veriore në lumin e Vardarit drejt portit të Selanikut në Greqi, respektivisht në detin Egje.⁸

Projekti drejt detit Egje, ekziston që nga kohërat e hershme brenda objektivit serb, qysh para Kongresit të Berlinit. Këto ide datojnë që nga kohërat kur Rusia cariste prezantonte hartën e Mbretërisë Serbe, një vendi të vogël brenda Ballkanit, ndërsa që kishte ambicie të mëdha të pushtonte Sanxhakun e Nishit për të kaluar pastaj drejt detit Egje. Kështu në periudhën 1844-1864, hartohen projekte mbi lumin Morava që kalonte përmes trevës shqiptare të Sanxhakut të Nishit, një zonë e cila shtrihej brenda një sipërfaqeje prej 11 mijë kilometra katror. Kështu në vitin 1860, 18 vjet para Kongresit të Berlinit, francezët arritën marrëveshje me serbët dhe morën të drejtën e shfrytëzimit të lumit Morava për komunikacionin lumor, sidoqoftë kompania franceze kishte dështuar për disa arsye. Përpjekja për rifunksionalizimin e këtij kanali lumor në vitin 1879, e nxiti inxhinierin serb Ante Aleksiq, i cili idetë e tij i kishte hedhur në librin e tij me titullin “*Morava, gjendja e tanishme dhe mundësitë lundruese*”. Këto ide iu prezantuan gjermanëve, anglezëve, si dhe amerikanëve, me qellim të përkrahjes nga fuqitë e madha të ideve serbe në njëerën anë, e në anën tjetër duke ua ofruar mundësinë për prezencë gjeostrategjike fuqive të madha, si dhe Serbia të kthehet në një lider rajonal. Si rezultat i këtyre prezantimeve nga pala serbe, në vitin 1907, një kompani amerikane nga Nju Xhersi, projekttoi idenë për ndërtimin e kanalit lundrues “Morava-Vardar”, të titulluar si linja e gravitetit ekonomik evropian në raport me kanalin e Suezit.⁹

Tentativat për realizimin e projektit për lundrim mbi Moravë janë të shumta. Ato janë ringjallur edhe në vitin 1973, nga Enti Projektues i Komunikacionit Lumor (Projekanski Zavod Recnog Saobracaja) nga Beogradi, i cili

këtë projekt ua kishte prezantuar edhe ekspertëve të Kombeve të Bashkuara. Me shpërbërjen përfundimtare të Jugosllavisë dhe ndarjen e Malit të Zi nga unioni me Serbinë, kjo e fundit humbi çdo mundësi të daljes në det, kështu, projekti Morava përsëri ka marrë objektivin numër një në Serbi. Aktualisht në instanca më të larta serbe, projekti i lundrimit mbi Moravë është futur brenda dokumentit të planit hapësinor të vitit 2020. Serbët janë të vetëdijshëm se realizimi i kësaj ideje përveç kostos së lartë financiare, bart edhe shumë rreziqe dhe fërkime gjeostrategjike rajonale. Kina e ka ofertuar projektin serb për lundrim mbi Moravë në vlerë 18 miliardë dollar. Realizimi i këtij projekti nga Kina, Rusia dhe Serbia është vlerësuar si projekt i një rëndësie të madhe për rolin e ardhshëm në Ballkan dhe Evropë. Megjithatë, Serbia është e vetëdijshme se pa harmonizimin me shqiptarët në këtë projekt, veçmas me Republikën e Kosovës, jetësimi i projektit për daljen në detin Egje përmes Moravës do të mbetet vetëm një ëndërr në letër.¹⁰ Në situatën e sotme gjeopolitike dhe ekonomike të marrëdhënieve në rajonin e Ballkanit, ndërtimi i rrugës lundruese është pothuajse i pamundur. Në fakt, ideja për ndërtimin e kanalit është e tejkaluar, dhe që në konjunkturat aktuale gjeopolitike dhe ekonomike është projekt i paralizuar. Kjo ide ka qenë grandioze për rrethanat gjeopolitike të fund të shek. XIX dhe fillimi të shek. XX, por jo tani dhe do të ketë një kosto të lartë financiare dhe nuk është rentabil në aspektin ekonomik.

Vlen të potencohet se objektivi kryesor i diplomacisë serbe në shek. XIX, por dhe fillim shek. XX ka qenë dalja në detin Adriatik. Diplomacia serbe në fillim të shek. XX, edhe botërisht kishte shprehur ambiciet e saj për dalje në detin Adriatik. Në vitin 1912, J. Cvijiq, lansoi projektin për dalje në detin Adriatik.

- 1 Prof. dr. Arsim Bajrami, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë – aspektet juridike*, (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2023), fq. 282.
- 2 Po aty, fq. 283.
- 3 Po aty, fq. 284.
- 4 Shaban Murati, *Enigmat diplomatike të Pavarësisë së Kosovës*, (Tiranë, 2007), fq. 15.
- 5 Rovena Aliraj, *Gjeopolitika Serbe në mijëvjeçarin e ri: ndikimi i saj në sigurinë ballkanike dhe hapësirën shqiptare*. Teze e doktoratës. Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Tiranë, 2018, fq. 34. https://tradic.mil.al/images/DOKTORATURAT/Doktoratura_Rovena_ALIRAJ_.pdf.
- 6 Po aty, fq. 14.
- 7 Prof. dr. Muharem Cerabregu, prof. dr. Muhamet Sadiku, *Gjeo-ekonomia, implikimet zhvillimore*, (Pejë, Kolegji Dukagjini, 2016), fq. 213-214.
- 8 Dr. Fidan Mustafa, *Gjeopolitika e Ballkanit, e ardhmja e shqiptarëve në rajon*, (Tiranë, Alsar, 2022), fq. 180-181.
- 9 Po aty, fq. 181.
- 10 Po aty, fq. 182-183.

Msc. Drin Aliu

Gjendja e shqiptarëve (muhaxhirëve) të shpërngulur me dhunë nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878

Në këtë punim të shkurtër dhe përkujtues për vuajtjet e muhaxhirëve shqiptarë të Sanxhakut të Nishit, do t'i sjellim në pah disa prej momenteve më të vështira që përjetuan muhaxhirët gjatë shpërnguljes së viteve 1877-1878.

Gjysma e dytë e shekullit XIX u veçua me shumë ngjarje në territoret e administruara nga Perandoria Osmane në Gadishullin Ballkanik. Njëra ndër ngjarjet më tragjike ishte edhe Kriza Lindore 1875-1878. Kriza Lindore, që nga fillimi e deri në fund, ishte një skenar i përgatitur nga Rusia cariste, e cila përmes tensioneve dhe luftërave në Ballkan synonte dobësimin e Perandorisë Osmane dhe copëtimin e territoreve

që menaxhoheshin nga ajo. Për t'i arritur qëllimet e saj, Rusia, në maj të vitit 1876, shkaktoi trazira dhe kryengritje të armatosura kundër Perandorisë Osmane në Bosnjë, pastaj në Serbi dhe Mal të Zi.¹ Këtyre kryengritjeve, që morën përmasat e një lufte kundër osmane, Perandoria Osmane, meqenëse e kishte të pamundur që të dialogonte, iu kundërpërgjigj me luftë dhe i shuafti ato.

Pas shuarjes së kryengritjeve në Bosnjë, Serbi dhe Mal të Zi, Rusia e udhëhequr nga Aleksandri II, u indinjua shumë dhe vendosi t'i shpallte luftë të hapur Perandorisë Osmane. Më 24 prill 1877, Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane²



dhe më këtë akt filloi lufta e ashpër ruse-osmane. Rusia kishte hartuar gjeopolitika të kamotshme, të cilat tashmë kishte ardhur momenti që t'i realizonte. Duke shfrytëzuar situatën e brishtë politike në Evropë, ajo synonte që përmes një lloj protektorati të ndërhynte në Ballkan kinse për t'i mbrojtur të drejtat e sllavëve-ortodoksëve, ndërsa në realitet synonte realizimin e planeve të saj gjeopolitike për dalje në Mesdhe.

Lufta ruse-osmane ishte shumë e ashpër. Gjendja e Perandorisë Osmane gjatë kësaj periudhe ishte shumë e rëndë si rezultat i krizave të brendshme dhe të jashtme. Kjo gjë ndikoi që Perandoria Osmane të humbiste shpejt këtë luftë. Në anën tjetër Rusia qëndronte më mirë, kjo për faktin që ajo u ndihmua nga popujt sllavë dhe kishte armatime më të avancuara se Perandoria Osmane.

Luftimet u zhvilluan në dy fronte kryesore, në Ballkan dhe në Kaukaz. Në fillim të luftës, ushtria ruse me shpejtësi kaloi në Ballkan.³ Marshimi rus u ndal në Kështjellën e Plevenit (Bullgari), e cila u mbrojt nga Osman Pasha prej korrikut deri në dhjetor të vitit 1877. Rënia e Kështjellës së Plevenit, më 10 dhjetor 1877, i hapi rrugë ushtrisë ruse drejt Stambollit.⁴

Në këtë kohë, Britania për ta ruajtur balancimin, kishte kaluar në anën e Perandorisë Osmane. Flota britanike u dërgua në Stamboll me të vetmin qëllim, ruajtjen e tij nga pushtimi rus. Rusët nuk depërtuan deri në Stamboll, por afër tij bënë paqe me osmanët nëpërmjet Marrëveshjes së Shën Stefanit, të nënshkruar më 3 mars 1878.⁵ Me nënshkrimin e Traktatit të Shën Stefanit, Perandoria Osmane humbi pjesën më të madhe të territoreve në Gadishullin Ballkanik.

Si pasojë e ndryshimeve gjeopolitike pas Traktatit të Shën Stefanit (03.03.1878) dhe pak më vonë edhe pas Traktatit të Berlinit (13.06.1878), kemi një situatë mjaft të rëndë për popullin shqiptar, të cilëve ju copëtuan trojet e tyre dhe u dëbuan nga vendlindjet e tyre.

Me vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, gjysma e trojeve shqiptare ju dhanë shteteve ballkanike. Me vendimet e traktatit në fjalë u realizua një shtet i madh bullgar. Bullgaria e Madhe do të merrte krahinat shqiptare të Korçës, Bilishtit, Pogradecit, Strugës, Dibrës, Tetovës, Kërçovës, Gostivarit, Kaçanikut, Shkupit etj.. Në anën tjetër, Serbia, territoreve

Shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit filluan në fillim të luftës ruse-osmane në vitin 1877. Banorët myslimanë që përfshinin nacionalitetet shqiptar, osman, çerkez etj., të qyteteve Nish, Piro, Leskovc dhe Vranjë u dëbuan nga vendbanimet e tyre gjatë luftës, pas tërheqjes-humbjes së ushtrisë osmane.

jugperëndimore shqiptare (që përfshinin rreth 10.972 km²) do të aneksonte edhe viset veriore e verilindore të Kosovës, Sanxhakun e Nishit me rrethinë, deri në afërsi të Mitrovicës. Malit të Zi ju dhanë disa krahina shqiptare si ajo e Ulqinit, Krajës, Anamalit, Hotit, Grudës, Tuzit, Kelmendit, Plavës, Gucisë dhe të Rugovës.⁶ Trojet e tjera shqiptare do të mbeleshin në sundimin e Perandorisë Osmane deri në vitin 1912.


SHPËRNGULJET ME DHUNË TË SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT DHE GJENDJA E MUHAXHIRËVE

Si pasojë e luftës ruse-osmane, që në fakt ishte një luftë mes Rusisë e cila përkrahej nga popujt sllavë të Ballkanit (me theks të veçantë nga serbët, bullgarët dhe malazezët) dhe Perandorisë Osmane, dhe si pasojë e vendimeve kontroverse të Traktatit të Shën Stefanit dhe Traktatit të Berlinit, filloi shpërngulja me dhunë e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, që u pushtuan nga ushtria ruse, serbe, bullgare dhe malazeze.

Shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit filluan në fillim të luftës ruse-osmane në vitin 1877. Banorët myslimanë që përfshinin nacionalitetet shqiptar, osman, çerkez etj., të qyteteve Nish, Piro, Leskovc dhe Vranjë u dëbuan nga vendbanimet e tyre gjatë luftës, pas tërheqjes-humbjes së ushtrisë osmane. Ushtria ruse-serbo-malazeze dhe bullgare i dogjën shtëpitë e myslimanëve, kurse banorët e mbetur i vranë. Populli shqiptar i këtyre krahinave u dëbua me dhunë të ashpër.⁷ Gjatë luftës, nga fundi i vitit 1877 dhe në fillim të vitit 1878, ushtria serbe në Nish dhe rrethinë kishte vrarë 12.896

civilë shqiptarë të të gjitha moshave pa dallim, në Prokuplë me rrethinë ishin vrarë 1611 shqiptarë civilë dhe në Kurshumli me rrethinë, numri i të vrarëve shqiptarë kishte arritur në 3126 civilë.⁸ Ushtria serbe, pas vrasjes së shqiptarëve, filloi me grabitjen e shtëpive dhe stolive trupore të kufomave, kjo dëshmohej nga prerja e gishtërinjve të viktimave. Gjatë këtyre krimeve nuk mungoi as dhuna seksuale që ushtria serbe ushtroi ndaj femrave shqiptare.⁹ Të gjitha këto mizori të ushtrisë serbe i detyruan shqiptarët që të shpërnguleshin nga trojet e tyre.

Në një ditar lufte përshkruhen vuajtjet e muhaxhirëve (shqiptarëve) të shpërngulur gjatë stinës së dimrit të vitit



1877. Ndër të tjera, një ushtarak serb, në ditarin e tij pohonte se: “Kemi hasur kufoma të ngrira nëpër fshatrat e thella malore. Kudo në fshatin Mehanë, shihen kufoma që i kishin copëtuar granatat (bombardimet e ushtrisë serbe D.A.) e pastaj egërsirat i kishin bartur copat e mishit të njeriut afër shtrojerave për t’i shkrirë dielli, sepse natën bënte acar i madh. Ka ngjarë që afër rrugës që të hasim qerre të thyera, ndonjë rrotë prej tyre, por aty kishin mbetur edhe kufomat e ngrira. Kufoma të tilla kemi hasur sidomos në Luginën e Raçit, të Banjës, së Kurshumlisë dhe të Merdarës.”¹⁰ Pjesa tjetër e muhaxhirëve që arriti t’i ikte ushtrisë serbe dhe t’i shpëtonte dimrit të ashpër u vendosën fillimisht në vilajetin e Kosovës. “Sipas konsullit rus në Prizren, Jastrebov, si pasojë e luftës serbo-osmane, Serbia luftonte përkrah Rusisë në vitin 1877 vetëm në Vilajetin e Kosovës. Si rezultati i luftimeve që zhvilloheshin në territoret shqiptare ishin vendosur 73000 muhaxhirë (pjesa tjetër e tyre arrijnë më vonë D.A.) të pa strehë dhe të rrezikuar nga shfarosja masive për shkak se nuk kishin asnjë kusht jetese. Kjo popullsi, thotë Jastrebov, sidomos më 1879, kishte mbetur pa asgjë e mbi të gjitha ishte e rrezikuar nga sëmundjet ngjitëse. I mungonte edhe ushqimi elementar.”¹¹ Krahas rrezikut dhe vështirësive nga lufta, shpërnguljen e vështirësuan edhe kushtet klimatike. Muhaxhirët që u shpërngulën në fund të vitit 1877 mezi depërtuan në brendësi të Vilajetit të Kosovës për shkak të dimrit të ashpër. Kishte raste kur disa familje muhaxhirë, nga sulmet e shpejta të ushtrisë serbe, nuk mund t’i prisnin merrnin të gjithë anëtarët e familjes.¹²

SHPËRNGULJA DHE VUAJTJET E MUHAXHIRËVE SHQIPTARË

Pas këtyre ngjarjeve dhe padrejtësive, mllëfi i shqiptarëve kundër Traktatit të Shën Stefanit përfshiu të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare, që nga fshatarët e zejtarët e deri te qarqet çifligare e tregtare. Zemërim i shqiptarëve nuk drejtohej vetëm kundër Perandorisë Ruse dhe aleatëve të saj ballkanikë, por edhe kundër Perandorisë Osmane, e cila kishte nënshkruar një akt të tillë, që copëtonte atdheun e tyre.¹³ Si rezultat i këtyre vendimeve, trojet shqiptare u bënë viktimë e gjeopolitikave pansllaviste.

Popullsia e shpërngulur fillimisht u vendos në Vilajetin e Kosovës, pastaj gradualisht, një pjesë qëndroi aty, ndërsa pjesa tjetër u nisë për Stamboll dhe në vise të ndryshme të Azisë. Muhaxhirët që u vendos në Vilajetin e Kosovës, në veçanti ata që u vendosën në territorin e Llapit kishin shpresë që pas përfundimit të luftës do të ktheheshin në shtëpitë dhe tokat e tyre. Fatkeqësisht kjo shpresë e tyre mori fund pas vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit, i cili bëri një padrejtësi shumë të madhe ndaj muhaxhirëve dhe ndaj trojeve të tyre, duke ua njohur ato zyrtarisht Serbisë.

Pjesa tjetër e muhaxhirëve, pasi që nuk kishin më shpresë për t’u kthyer në trojet e tyre, u nisën drejt kontinentit aziatik me pikëllim, mall dhe shpresë që atje do të gjenin një jetë më të mirë.

Nga Ballkani për në Anadoll muhaxhirët u bartën me anije. Shpenzimet e transportit i kryente Perandoria Osmane. Për grumbullimin dhe transportimin e muhaxhirëve u krijuan disa stacione. Ato ishin: Edreneja, Stambolli, Çanakalaja,

Samsuni dhe Izmiri. Perandoria Osmane kishte marrë masa të duhura për plotësimin e nevojave të muhaxhirëve. Ishte formuar Komisioni për Vendosjen e Muhaxhirëve (Iskan-i Muhacirin Komisyonu). Sipas raporteve të konsullit francez në Edrene, në maj dhe në qershor të vitit 1878, në Edrene ishin 40.000 muhaxhirë, në prill të vitit 1879 numri i tyre arriti në 50.000, kurse në tërë vilajetin e Edrenesë gjatë vitit në fjalë numri ishte rritur në 140.000. Muhaxhirët ishin të rrezikuar nga sëmundje të ndryshme. Prej 40.000 – 45.000 muhaxhirëve, sa gjendeshin në Edrene, 16.000 ishin të sëmurë nga tifoja, prej të cilëve (62%) vdiqën. Muhaxhirët që vuanin nga sëmundjet ngjithëse vdisnin 4-5 në ditë, ndërsa më vonë ky numër u rrit 300 deri në 500 në ditë.¹⁴ Siç shihet, që nga fillimi i shpërnguljes e deri në fund, numri i muhaxhirëve vinte duke u zvogëluar, një pjesë u vranë nga serbët, pjesa tjetër vdiqën nga sëmundjet dhe uria.

Numri total i muhaxhirëve të shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit nuk dihet me saktësi sot e asaj dite për arsye se të gjithë muhaxhirët nuk ishin të regjistruar. Shifrat e muhaxhirëve të regjistruar nga autoritetet osmane dhe ato që janë dhëna nga korrespondentët dhe diplomatët evropianë pa dyshim se janë të larta. Nëse llogariten të gjitha shifrat së bashku, numri i muhaxhirëve të shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit është rreth 200.000 deri në 250.000,¹⁵ pa llogaritur muhaxhirët boshnjakë, osmanë (turq) dhe çerkezë, të cilët së bashku me muhaxhirët shqiptarë u dëbuan nga Sanxhaku i Nishit. Numri i muhaxhirëve të tjerë, krahas shqiptarëve varion nga 50.000 deri në 70.000.

Gjendja social-ekonomike dhe shëndetësore e muhaxhirëve ishte shumë e rëndë. Lidhur me këtë, profesor dr. Skender Rizaj, pohon se “Gjendja ekonomike, sociale dhe shëndetësore e muhaxhirëve ishte e tmerrshme. Ajo nuk mund të përshkruhet as me gojë e as me shkrim.”¹⁶ Si pasojë e mungesës së strehimit, një numër i madh muhaxhirësh të stacionuar në Stamboll u vendosën në xhaminë Aja Sofia, në shkollë të zbrazëta, në ndërtesa të mëdha, në pallate dhe në çifligje të braktisura. Në Stamboll, me iniciativën e sulltanit Abdyl Hamitit II (1876-1908) u formua Komisioni për Ndihma të Muhaxhirëve. Ky Komision kishte për detyrë që t’ju ndihmonte muhaxhirëve në çdo aspekt. Këta muhaxhirë të Ballkanit u vendosën si banorë të përhershëm në zonat periferike të Anadollit, Sirisë, Arabisë etj.. Pjesa e mbetur e muhaxhirëve, qëndruan në vilajetet shqiptare me theks të veçantë në Vilajetin e Kosovës. Numri më i madh u vendosën në trevën e Llapit dhe në Prishtinë. Muhaxhirët u vendosën edhe në Pejë, Gjakovë, Prizren etj.. Sipas valiut të Vilajetit të Kosovës, Rifat Pashës,

Shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e tyre nuk u përfunduan me shpërnguljet masive të viteve 1877-1878, fatkeqësisht ato vazhduan me episode edhe nga viti 1912 deri në vitin 1999.

në shkurt të vitit 1878, në Vilajetin e Kosovës kishte rreth 200.000 muhaxhirë, të dëbuar nga Nishi, Kurshumlia, Leskovci, Vranja etj..¹⁷ Edhe gjendja e muhaxhirëve në Vilajetin e Kosovës ishte e rëndë, por u ndihmuan nga shqiptarët vendas dhe u mirëpritën ngrohtësisht. Shqiptarët tentuan disa herë që të ktheheshin në trojet e tyre, por një gjë e tillë ishte e pamundur si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.

Për muhaxhirët, Perandoria Osmane ndër-mori disa masa lehtësuese si: ndihmat në tokë, në shtëpi, në mjete financiare, në mjekim etj.. Muhaxhirët u liruan dhjetë vjet nga tatimet, dy vjet lirimi nga tatimet dhe 6 vjet lirimi nga shërbimi ushtarak.¹⁸ Krahas këtyre masave lehtësuese, në vitet e para, gjendja e muhaxhirëve shqiptarë ishte shumë e rëndë, por me kalimin e kohës, si rezultat i punës së tyre gradualisht e përmirësuan gjendjen e tyre sociale dhe ekonomike.

Si pasojë e planeve gjeopolitike dhe gjeo-strategjike nga ana e armiqve të popullit shqiptar, trojet shqiptare u copëtuan disa herë përgjatë historisë dhe populli shqiptar u detyra të shpërngulet në vende dhe kontinente të ndryshme. Shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e tyre nuk u përfunduan me shpërnguljet masive të viteve 1877-1878, fatkeqësisht ato vazhduan me episode edhe nga viti 1912 deri në vitin 1999.

- 1 Më gjerësisht shih: Karl Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi II*, (Tiranë: Uegen, 2005), 96; Norman Rich, *Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914*, (Tiranë: Toena, 2006), 221; Gorges Castellan, *Historia e Ballkanit shek. XIV-XX*, (Tiranë: MCM, 1991), 338.
- 2 Ferdinand Schevill, *Ballkani, historia dhe qytetërimi*, (Tiranë: UEGEN, 2006), 325.
- 3 Gazmend S. Rizaj, *Shqipëria e sipërme 1800-1913: Në projektet dhe traktatet e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011), 124.
- 4 Castellan, *Historia e Ballkanit*, 339-340.
- 5 Rich, *Diplomacia*, 224.
- 6 Castellan, *Historia e Ballkanit*, 340.
- 7 Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, 79.
- 8 Më gjerësisht shih: Hakif Bajrami, *Shqiptarët dhe Kosova në rrjedhat tragjike të historisë (1878-1999)*, (Prishtinë: Faik Konica, 2019).
- 9 Jusuf Osmani, *Shqiptarët në Sanxhakun e Nishit: muhaxhirët, dokumente, dëshmi, rrëfime*, (Prishtinë: Qendra dokumentare Shkencore, 2021), 290-292.
- 10 Osmani, *Shqiptarët në Sanxhakun e Nishit*, 290.
- 11 Bujar Dugolli, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe: 1878-1912*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2011), 57.
- 12 Osmani, *Shqiptarët në Sanxhakun e Nishit*, 258.
- 13 Buda; et.al, *Historia*, 148.
- 14 Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, 81-85.
- 15 Osmani, *Shqiptarët në Sanxhakun e Nishit*, 260-265.
- 16 Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, 81.
- 17 Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, 81-85.
- 18 Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, 89-91.

Ramadan Gara

NJË JETË NË SHËRBIM TË ARSIMIT, BESIMIT DHE HUMANIZMIT

Ramadan Gara lindi më 10 maj 1943, në Kishnarekë të Drenasit, si fëmija i katërt i Nuredinit dhe Emines. Pas përfundimit të shkollës fillore, ai vazhdoi arsimin në Medresenë e Prishtinës. Në atë kohë, Medreseja ishte një shkollë profesionale për hoxhallarë, dhe diploma e saj nuk njihej për regjistrim në fakultet. Pavarësisht kësaj, edhe pse u detyrua të marrë rrugën e kurbetit, dëshira e Ramadanit për arsimim nuk u zbeh, andaj me avancimin e Medresesë në një shkollë të mesme të njohur nga sistemi arsimor, ai rifilloi studimet përmes provimeve private dhe e përfundoi me sukses brenda një afati optimal në Medresenë “Alaudin”.

Si mërgimtar në Zagreb të Kroacisë, Ramadanit punoi si mjeshtër ndërtimi, por aktiviteti i tij nuk u kufizua vetëm në profesion. Ai kontribuoi në ndihmën për komunitetin dhe bashkatdhetarët, ku gjatë Ramazanit, ofronte shërbime fetare dhe ndikonte pozitivisht në jetën fetare dhe kombëtare të bashkëkombësve.

Gjatë Luftës së Bosnjës, ai dha një kontribut të konsiderueshëm në ndihmë të refugjatëve boshnjakë që ishin shpërngulur në Zagreb. Përmes Bashkësisë Islame Kroate dhe si aktivist i Xhamisë së Zagrebit, ku kishte fituar besimin e bashkë praktikuesve dhe ishte radhitur si imam rezervë, Ramadanit ndihmoi në sigurimin e strehimit dhe ushqimit për të shpërngulurit, duke dëshmuar përkushtim të madh humanitar dhe fetar.

Lufta në Kosovë e gjeti në pension. Në vitin 1998, gjatë ofensivave serbe në rajonin e Drenicës, ndërmori një hap të guximshëm për të inkurajuar mësuesit për të improvizuar një shkollë në një tendë najloni, me qëllim që fëmijët të largoheshin nga tmerri i luftës dhe të fokusoheshin në arsimim. Për të mbështetur këtë nismë, ai sfidoi rrethanat e rënda dhe udhëtoi në Prishtinë, ku siguroi lapsa dhe fletore për nxënësit. Kontributi i tij në ngritjen dhe mbështetjen e



kësaj shkolle, e cila u bë simbol i shpresës dhe qëndresës, u vlerësua edhe nga gazetari Nuhi Bytyqi në dokumentarin “*Kthimi në tokën e djegur (1998)*”, ku ai e përmend Ramadanin si një nga akterët kryesorë në ngritjen e shkollës së najlonit.

Pas përfundimit të luftës, Ramadanit vazhdoi angazhimin e tij për komunitetin, duke ndihmuar në pastrimin dhe rindërtimin e shkollës dhe xhamisë së dëmtuar, si dhe duke organizuar ekskursione për fëmijët jetimë, me qëllim që të rikthenin normalitetin në jetën e tyre.

Angazhimi i tij nuk kufizohej vetëm në veprimet humanitare, por shtrihej edhe në promovimin e vlerave fetare dhe kombëtare, duke mbetur një figurë frymëzuese për komunitetin e tij.

Një nga kontributet më të vyera të Ramadanit në pasluftë ishte angazhimi në përkthimin dhe botimin e librit të veprimtarit të njohur islam, dr. Sulejman Mashoviq, “*Pikë-pamje Islame*”, që kishte për qëllim ofrimin e një perspektive të moderuar dhe të thelluar mbi Islamit në Kosovë, pas periudhës së luftës. Libri u përkthye falë kontributit të dr. Feti Mehdiut, i cili e kishte njohur Ramadanin që nga viti 1959, kur kishin takuar njëri-tjetrin në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë.

Ramadan Gara ndërroi jetë në moshën 82-vjeçare, duke lënë pas një familje të shëndoshë deri në brezin e katërt. Ai jetoi një jetë të përmbushur shpirtërisht, duke u gëzuar me lirinë dhe progresin e Kosovës. Kontributet e tij në komunitet, arsim dhe fe janë një testament i përkushtimit dhe dashurisë së tij për vendin dhe njerëzit.

Zoti i Gjithëmëshirshëm i dhuroftë Xhenetin Firdeus!

Të dhënat janë marrë nga djali i tij Luan Gara dhe nipi (djali i vëllait) të tij Hafiz Gara.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRI I HAXHIT DHE UMRES SË ARABISË SAUDITE, DR. TEVFIK RABIAH

Më 11 janar 2025, me ftesë të ministrit të Ministrisë së Haxhit dhe Umres së Arabisë Saudite, dr. Tefvik Rabiah, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë në Xhide të Arabisë Saudite.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, u prit në takim nga ministri Rabiah, ku të dy nënshkruan marrëveshjen e Haxhit për vitin 2025. Kjo marrëveshje rregullon organizimin dhe lehtësimin e shkuarjes së besimtarëve kosovarë për ta kryer haxhin.

Myftiu Tërnavë falënderoi autoritetet saudite për mbështetje ndaj besimtarëve kosovarë dhe shërbimet për haxhilerët dhe vizitorët e Umres. Po ashtu, ai diskutoi mundësinë e fluturimeve direkte mes Kosovës dhe Arabisë Saudite, që do të lehtësojnë lëvizjen e qytetarëve.

Myftiu theksoi angazhimin e Bashkësisë Islame për forcimin e bashkëpunimit me Ministrinë e Haxhit. Ministri Rabiah e vlerësoi Bashkësinë Islame të Kosovës si organizatorin zyrtar të Haxhit dhe shprehu mirënjohje për kontributin e saj. Gjatë ditëve të qëndrimit në Arabinë Saudite, Myftiu Tërnavë, zhvilloi takime të tjera me përfaqësues të institucioneve relevante për organizimin e Haxhit, për të thjeshtuar më tej procedurat për besimtarët kosovarë në Mekë, Xhide dhe Medinë.



Myftiun Tërnavë gjatë kësaj vizite u shoqërua nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, shefi i kabinetit të Myftiut, Besim ef. Mehmeti, zv.kryeimami Fatmir ef. Iljazi dhe z. Remzi Ejupi.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PRESIDENTIN E KËSHILLIT BOTËROR TË KOMUNITETEVE MYSLIMANE, DR. ALI RASHID AL NUAIMI

Më 23 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim presidentin e Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, dr. Ali Rashid al Nuaimi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Myftiu Tërnavë me këtë rast shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij të thellë për mbështetjen dhe ndihmat e vazhdueshme që ka dhënë Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe për Kosovën dhe Bashkësinë Islame të Kosovës, në veçanti në sektorin e zhvillimit dhe të humanitetit. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që



një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, dr. Ali Rashid al Nuaimi, theksoi angazhimin e Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane në mbështetje të iniciativave të paqes

dhe bashkëpunimit, duke shprehur gatishmërinë e tyre për mbështetjen e projekteve që promovojnë mirëqenien dhe tolerancën e besimtarëve në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PROFESORESHËN BESA ISMAILI

Më 7 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim profesreshën e Fakultetit të Studimeve Islame, znj. Besa Ismaili.

Myftiu Tërnavë, fillimisht uroi dr. Besa për përfundimin me sukses të doktoratës së saj, duke vlerësuar lart punën dhe përkushtimin e saj në fushën akademike. Ai tha se arritjet e saj duhet të shërbejnë si frymëzim për brezat e rinj dhe të jenë një shembull i përkushtimit ndaj dijes dhe komunitetit.

Nga ana e saj, dr. Besa Ismaili, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen



dhe për mbështetjen e vazhdueshme ndaj nismave arsimore dhe akademike.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E QENDRËS SË MBRETIT SELMAN TË ARABISË SAUDITE

Më 8 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Qendrës së Mbretit Selman të Arabisë Saudite, z. Alsaban Muhamed Abdullah, i cili njëherësh është edhe drejtues i projektit për shpërndarjen e ndihmave për vitin 2025, si dhe z. Faisal Muhamed Hamdi.

Myftiu Tërnavë i falënderoi përfaqësuesit e Qendrës për mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme që kjo qendër ka ofruar për shoqatën “Bereqeti”, duke kontribuar në projekte dhe aktivitete të shumta që kanë për qëllim mbështetjen sociale për kategoritë nevojtare. Myftiu Tërnavë e vlerësoi lart bashkëpunimin e ngushtë me Qendrën e Mbretit Selman, duke theksuar mirënjohjen për



ndihmën e vazhdueshme që kjo qendër ka ofruar në fushën humanitare.

Përfaqësuesit e Qendrës së Mbretit Selman e falënderuan Myftiun Tërnavë për pritjen dhe shprehën gatishmërinë

për të vazhduar mbështetjen e projekteve të ndryshme në Kosovë, veçanërisht të atyre që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës së besimtarëve në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E GJILANIT, Z. ALBAN HYSANI

Më 9 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Gjilanit, z. Alban Hyseni, me të cilin diskutoi për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës, e në veçanti të Këshillit të BI-së së Gjilanit dhe Komunës së Gjilanit.

Myftiu Tërnavë u shpreh i kënaqur për angazhimin e Komunës për mbështetjen e aktiviteteve fetare dhe



shoqërore, duke përmendur se vetëm kështu të bashkuar dhe të unifikuar mund ta zhvillojmë shoqërinë tonë dhe ta bëjmë atë edhe më të qëndrueshme përballë sfidave.

Nga ana e tij, kryetari Hyseni, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve, duke përmendur kështu rolin e institucioneve fetare në forcimin e solidaritetit dhe mirëqenies së qytetarëve.

Kryetari Hyseni në këtë takim shoqërohej nga kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu.

U MBAJT KONFERENCA DHE PANAIRI PËR SHËRBIMET E HAXHIT DHE UMRES

Më 14 janar 2025, në Xhide të Arabisë Saudite filloi punimet Konferenca dhe Panairi për Shërbimet e Haxhit dhe Umres. Në këtë Konferencë, me ftesë të ministrit të Haxhit dhe Umres, dr. Tefvik Rabiah, mori edhe delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, i kryesuar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Konferenca u hap nga zëvendësemiri i rajonit të Mekës, princi Saud bin Mishal, i cili lexoi fjalimin e mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud. Në fjalën e tij, mbreti theksoi përkushtimin e Arabisë Saudite për t'u shërbyer haxhilerëve në çdo aspekt.

Në fjalën e tij hapëse, ministri saudit i Haxhit dhe Umres, dr. Tefvik Rabiah, deklaroi se Arabia Saudite, duke u nisur nga porositë hyjnore dhe mësimet profetike, krenohet që është në shërbim të mysafirëve të Allahut. Ai nënvizoi përkushtimin e vendit për t'u ofruar haxhilerëve dhe umrexhive shërbime të nivelit më të lartë. Ai informoi të pranishmit se gjatë vitit 2024, dy vendet e shenjta janë vizituar nga mbi 18.5



milione besimtarë për të kryer haxhin dhe umren.

Ndërkohë, në hapjen e Konferencës foli edhe Abdulkërim el Isa, sekretari i përgjithshëm i RABITA-s, i cili vuri në dukje se e gjithë bota islame dëshmon për shërbimet e jashtëzakonshme që Arabia Saudite ofron për vizitorët e saj.

Në këtë Konferencë morën pjesë myftinj, ministra dhe drejtues të institucioneve përgjegjëse për organizimin e Haxhit nga më shumë se

95 vende. Konferenca vazhdoi punimet deri më 16 janar dhe trajtoi tema të rëndësishme, si produktet, shërbimet, projektet dhe investimet në sektorin e Haxhit dhe Umres.

Myftiun Naim ef. Tërnavë, në këtë Konferencë dhe Panair e shoqëruan kryeimami i Kosovës Vedat ef. Sahiti, shefi i kabinetit të Myftiut Besim ef. Mehmeti dhe zv.kryeimami Fatmir ef. Iljazi.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI ZËVENDËSMINISTRIN PËR ÇËSHTJE TË UMRES SË ARABISË SAUDITE, DR. ABDULAZIZ VEZAN

Më 14 janar 2025, në kuadër të takimeve me personalitetet që morën pjesë në Konferencën dhe Panairin për Shërbimet e Haxhit dhe Umres, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, takoi zëvendësministrin për Çështje të Umres së Arabisë Saudite, dr. Abdulaziz Vezan.

Gjatë këtij takimi u diskutua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për besimtarët kosovarë, të cilët shkojnë për ta kryer umren.

Myftiu Tërnavë falënderoi autoritetet e Arabisë Saudite, në krye me Kujdestarin e Dy Vendeve të Shenjta, mbretin Selman bin Abdulaziz dhe princin e kurorës, Muhamed bin Selman për shërbimet dhe lehtësitë e ofruara për vizitorët e dy vendeve të shenjta.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E KOALICIONIT PËR FAMILJEN

Më 27 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Koalicionit për Familje, të kryesuar nga z. Eman Rrahmani.

Gjatë takimit u diskutua për çështjet me rëndësi për qytetarët e Kosovës, përfshirë këtu promovimin e vlerave të tolerancës, harmonisë dhe bashkëpunimit, për çka Myftiu Tërnavë, kërkoi që të ketë unitet kombëtar dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve fetare dhe politike. Ai me këtë rast tha se vetëm të bashkuar mund të ecim para dhe mund t'i çojmë para proceset me rëndësi për vendin.



Nga ana e tyre, liderët e Koalicionit për Familjen, shprehën falënderime e tyre për punën e palodhshme të Bashkësisë Islame të Kosovës për ruajtjen e

traditës dhe kujdesit për familjen, duke theksuar se dialogu dhe mirëkuptimi janë themelore për të adresuar sfidat e sotme.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTRIN E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL, Z. ELBERT KRASNIQI

Më 28 janar 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi.

Gjatë këtij takimi u bisedua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, për çka Myftiu Tërnavë u shpreh i gatshëm për të përkrahur çdo iniciativë e cila kontribuon në mirëqenien e qytetarëve të vendit. Myftiu Tërnavë gjithashtu tha se si institucion mbesim të përkushtuar që të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet shtetërore, për t'i promovuar kështu vlerat e paqes dhe harmonisë sociale.



Nga ana e tij, ministri Krasniqi theksoi rëndësinë e angazhimit të përbashkët për të arritur rezultate konkrete dhe të qëndrueshme. Ai falënderoi Myftiun Tërnavë dhe institucionin e Bashkësisë

Islame të Kosovës për mbështetjen dhe për bashkëpunimin e deritanishëm, duke e vlerësuar këtë si një hap tejet të rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM REKTORIN E UNIVERSITETIT “NEXHMEDIN ERBAKAN” TË KONJËS, DR. CEM ZORLU

Më 29 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim rektorin e Universitetit “Nexhmedin Erbakan” të Konjës, prof. dr. Cem Zorlu.



Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Universitetit “Nexhmedin Erbakan”.

Myftiu Tërnavë theksoi me këtë rast rëndësinë e promovimit të arsimit të lartë dhe shkëmbimin e dijes, si mundësi për

zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën akademike. Ai falënderoi rektorin dr. Zorlu për mbështetjen dhe përkushtimin e tij për zhvillimin e arsimit dhe avancimin e studentëve tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION TË ORGANIZATËS HUMANITARE KUVAJTIANE “RAHMA INTERNATIONAL”

Më 31 janar 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion të organizatës humanitare kuvajtiane “Rahma International”, të kryesuar nga dr. Adnan al Haddadin.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që të falënderojë dr. Haddadin për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur me Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për të vazhduar një bashkëpunim të tillë edhe në të ardhmen. Ai tha se jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë edhe në fusha të tjera, që janë me interes për përmirësimin e mirëqenies së besimtarëve kosovarë.

Nga ana e tij, dr. Andan al Haddadi, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij që të vazhdojë



bashkëpunimin, duke vlerësuar kështu rolin e rëndësishëm që ka institucioni i BIK-ut në Kosovë. Ai tha se jemi të gatshëm për të avancuar partneritetin, sidomos në përmirësimin e kushteve të besimtarëve kosovarë.

Bashkësia Islame e Kosovës edhe në të kaluarën ka pasur një bashkëpunim të mirë me organizatën humanitare kuvajtiane “Rahma International”.

U NËNSHKROA MARRËVESHJE NDËRMJET BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS DHE QENDRËS SË MBRETTIT SELMAN

Më 8 janar 2025, Bashkësia Islame e Kosovës nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën për Humanizëm “Mbreti Selman” të Arabisë Saudite për realizimin e projektit “Pako ushqimore 2025”.

Kjo marrëveshje ka për qëllim realizimin e shpërndarjes së mbi 8100 pakove ushqimore në të gjitha qendrat e Kosovës. Nga ky projekt do të përfitojnë mbi 8100 familje. Projekti do të realizohet nëpërmjet Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, dhe pritet që të realizohet në prag të muajit të bekuar Ramazan.

Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, këtë marrëveshje e nënshkroi



shefi i kabinetit të Myftiut Tërnavë, Besim ef. Mehmeti dhe Behxhet Ajvazi, ndërsa në emër të Qendrës “Mbreti Selman”, marrëveshjen e nënshkroi z. Muhamed Abdullah Alsaban dhe Fejsal Hamdi.

Vlen të përmendet se kjo Qendër edhe përgjatë viteve të kaluara, përmes shoqatës “Bereqeti”, ka ndihmuar shumë familje nevojtare me gjëra ushqimore.


U PROMOVUA VEPRA “MUSLIMANI BASHKOHËS”



Më 18 janar 2025, në teatrin e qytetit të Gjilanit u mbajt ceremonia e promovimit të botimit të ri “Muslimani bashkohës”, një vepër e autorit të ndjerë, hفز. Avni ef. Aliu.

Aktiviteti u organizua nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan, duke mbledhur personalitete të shquara nga fusha fetare, akademike dhe publike.

Kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, vlerësoi këtë botim si një thesar të çmuar të trashëgimisë së përkushtimit ndaj Islamit dhe pasionit për edukimin islam.



Ndërsa Vedat ef. Sahiti, kryeimam i Kosovës dhe Ramadan ef. Shkodra, drejtor për Shtyp dhe Veprimtari Botuese në Bashkësinë Islame të Kosovës, theksuan rëndësinë e figurës së hفز. Avni ef. Aliut si një nga emrat më të ndritur të publicistikës islame në gjuhën shqipe.

Profesor Hysen Matoshi e cilësoi autorin si një veprimtar të shquar të çështjeve fetare dhe kombëtare, i cili la gjurmë të pashlyeshme me kontributin e tij në fushën e publicistikës.

Në emër të familjes, vajza e autorit, Albina Aliu-Idrizi, ndau momente personale, duke theksuar virtytet e larta të babait të saj dhe përkushtimin e tij ndaj fesë, kombit dhe dijes.

Hfz. Avni ef. Aliu mbetet një figurë e shquar e publicistikës islame dhe një shembull i denjë i përkushtimit për fe dhe atdhe, duke lënë një trashëgimi të vyer për brezat e ardhshëm.

KRYEIMAMI SAHITI MBAJTI LIGJËRATË NË XHAMINË “IMER MEHMETI” NË MITROVICË

Më 29 janar 2025, për nder të Natës së Israsë dhe Miraxhit, Këshilli i Bashkësisë Islame i Mitrovicës, organizoi mbrëmje ligjëratë kushtuar kësaj nate. Ligjëratat u mbajt në xhaminë “Imer Mehmeti”, ndërsa temën “Përsiatje Kurani mbi mrekullinë hyjnore të Israsë e Miraxhit”, e mbajti kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

Fillimisht një fjalë përshëndetëse e mbajti kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Ekrem ef. Avdiu, i cili përshëndeti të pranishmit.

Kryeimami Sahiti në fjalën e tij, vuri në pah disa nga mësimet madhore të Israsë dhe Miraxhit, duke u fokusuar kështu te mësimet madhore që përmban në vete kjo ngjarje e rëndësishme,



e cila si e tillë, bëri kthesë në vetë jetën e Resulullahut a.s. dhe të gjithë ymetit islam në përgjithësi.

Prej mësimëve të cilat i përmendi kryeimami Sahiti ishin edhe vlera e madhërimit të Allahut, nderi që iu dha

të Dërguarit a.s. me këtë udhëtim, më pastaj edhe lidhshmëria e Miraxhit me namazin dhe përfitime të tjera.

Programi vazhdoi me këndimin e disa ilahive.

VIZITAT E DREJTORIT SIMNICA NË DIASPORË GJATË MUAJIT JANAR

Më 28 janar 2025, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga imami Fadil ef. Musliu, mori pjesë në përrurimin e xhamisë shqiptare “Abdush Qizmolli e V” në Zulpich, Gjermani. Ai uroi kontribuesit dhe veçanërisht familjen e Abdulla Qizmolliut për dhurimin e objektit, duke theksuar rëndësinë e xhamisë si qendër shpirtërore dhe komunitare. Me këtë rast, në emër të BIK-ut, ai i dorëzoi Kryesisë së xhamisë një mirënjohje për kontributin e dhënë.

Më 30 janar 2025, drejtori Simnica vizitoi xhaminë e re të Bashkësisë Islame Shqiptare në Broshøj, në Danimarkë, ku u prit nga imami Basri ef. Kurtishi. Ai përcolli urimet e Myftiut Tërnavë dhe të BIK-ut për hapjen e kësaj xhamie, duke falënderuar komunitetin për investimin dhe përkushtimin e tyre. Objekti, me një hapësirë prej 2000 m²,



përfshin bibliotekë, restorant, zyra dhe hapësira për aktivitete fetare dhe sociale.

Më 31 janar 2025, drejtori Simnica vizitoi Qendrën Islame Shqiptare “Ardhmëria” në Helsingborg, Suedi, ku mbajti një fjalë rasti para namazit të xhumasë. Ai vlerësoi rolin e xhamive në diasporë si qendra jo vetëm adhurimi,

por edhe edukative. Po ashtu, njohu xhamatin me institucionet e BIK-ut dhe theksoi rëndësinë e unitetit dhe mbështetjes ndaj xhamive. Në fund, falënderoi autoritetet suedeze për përkrahjen ndaj komunitetit shqiptar-mysliman dhe rikonfirmoi gatishmërinë e BIK-ut për bashkëpunim me qendrat islame në diasporë.

DEPARTAMENTI I GRUAS MBAJTI TRIBUNËN E TITULLUAR “SHAMIA DHE LIRIA E ZGJEDHJES”

Në prag të Ditës Botërore të Mbulesës, Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame, dega në Prishtinë, organizoi tribunën me temën “Shamia dhe e Drejta e Zgjedhjes”.

Kadrije Dragusha, përgjegjëse e Departamentit të Gruas në Prishtinë, theksoi rëndësinë e lirisë për të manifestuar të drejtën e mbajtjes së mbulesës. Në fjalën e saj, udhëheqësja e Departamentit, Vaxhide Bunjaku, vuri në dukje se ligji i Allahut është për t’u zbatuar, si shprehje e bindjes dhe përkushtimit ndaj Tij.

Tema kryesore u trajtua nga Violeta Smajlaj, e cila foli për rolin e mbulesës si një element i zbulimit të femrës dhe ruajtjes së integritetit të saj. Një moment emocionues u soll nga Mir-linda Berisha, e cila ndau përvojën e saj personale në rrugëtimin drejt zbatimit të këtij urdhri kuranor, duke shprehur gëzimin e madh që përjetoi në këtë përkushtim shpirtëror.



Programi u pasurua gjithashtu me pjesë artistike dhe ilahi, duke krijuar një atmosferë reflektimi dhe frymëzimi për të pranishmit.

Dita Botërore e Mbulesës u themelua nga Nazma Khan, një aktiviste mysli-mane me prejardhje nga Bangladeshi, që jeton në SHBA. Ajo e nisi këtë nismë në vitin 2013, me qëllimin për të luftuar paragjykimet dhe keqkuptimet rreth

mbulesës islame, të cilat ajo vetë i kishte përjetuar gjatë jetës së saj.

Khan ftoi gratë nga të gjitha besimet dhe kulturat që më 1 shkurt të provonin të vendosnin shaminë për një ditë, në mënyrë që të kuptonin më mirë përvojën e grave mysli-mane dhe të ndjenin simbolikën dhe vlerën e saj shpirtërore.

3. Abundant / rare



В. Конаев

[illegible]

Shtëpia botuese "Dituria Islame" ka nxjerrë nga botimi doracakun "Namazi" të Hajrullah ef. Hoxhës. Në hyrje shpjegohet rëndësia e namazit si shtyllë e fesë islame. Pjesa e parë trajton kushtet dhe mënyrën e faljes, si dhe kategoritë e namazeve. Botuar në format xhepi, me ilustrime dhe botim kolor, doracaku përmban fotografi për marrjen e abdesit dhe faljen. Surret dhe duatë janë në arabisht e transkriptuara për ta lehtësuar mësimin. Me gjuhë të thjeshtë dhe shpjegime të qarta, ai është i dobishëm për filletarët dhe rekomandohet për çdo familje, mëjtep e xhami.

DITURIA ISLAME • Nr. 411 SHKURT 2025